

SIRI SULEJMANI


Në rrjedhën
tregime
e skica *e jetës*

314.52
596.

SIRI SULEJMANI

NË RRJEDHËN E JETËS

Tregime e skica



2718

Shtëpia Botuese «Naim Frashëri»

DHEMBJA E PLAGËS SË VJETËR

Taksia u ndal pranë klubit të fshatit. Përreth saj u mblodhën burra, gra dhe fëmijë. I pari doli nga vettura xha Vasili, pastaj e motra, Fotina, e pas saj doli një burrë i gjatë, me fytyrë të hequr, me sy të zes, flokë të rrallë e të thinjur. Kishte veshur një kostum gri, këmishë me vija, me jakë të gjatë, një kravatë të shkurtër, tepër të gjerë. Kapelen borsalino e mban-te në dorë. Ky ishte Mitro Çaka, i vëllai i xha Vasilit. Shumëkush nuk e kishte besuar kthimin e tij në vendlindje, megjithëse në letrën e fundit Mitroja i shkruante të vëllait se do të vinte të vdiste aty. Po ja, tani e kishin përpëra syve të gjallë, e prapë u dukej çudi.

Sa shkeli në tokë, Mitroja ndali për të mblodhur veten. Hodhi shikimin mbi njerëzit, hapi duart dhe, me një zë të mbytur nga mallëngjimi e me sy të për-lotur, tha:

— Ku jeni, o motra e vëllezër?

Fjalët e tij në heshtjen e njerëzve i ngjanin një pëshpërimë të dhimbshme. U përqaftua me të gjithë. Një plak, shok i fëmijërisë së tij, po vinte që tej me një shkop në dorë.

— E njeh atë? — e pyeti Mitron i vëllai.

Kurbetliu picërroi sytë. Hodhi shikimin e mendjes në honin e pesëdhjetë vjetëve dhe mermëriti:

— Mos është Pavlo Leka?

— Të lumtë, vëlla, i shtrydhe të pesëdhjetë vjetët! — i tha xha Vasili.

Pavloja iu hodh Mitro Çakës në qafë dhe u për-qafuan gjatë.

Ashtu në mes të njerëzve, ai ecte tërë emocione. Diku ndaloi, mori frymë thellë, hodhi shikimin nëpër fshat dhe pyeti të vëllanë:

— Kush e ka bërë tërë atë konak atje?

— Ne, i gjithë fshati. Është shtëpia e kulturës, — iu përgjigj me buzë në gaz i vëllai.

Mitro Çakës i bënte përshtypje çdo gjë: i bënin përshtypje njerëzit, shtëpitë, rrugët, pastërtia e fshatit.

Kur u fut në shtëpinë e të vëllait, mbeti shtangur. Asgjë, asnjë shenjë nuk kishte mbetur që t'i kujtonte fëmijërinë. Shtëpitë ishin ngritur të reja, dykatëshe. Avllia mbulohej e tëra nga një hardhi e shëndetshme, e ngarkuar me rrush.

Në dhomën e pritjes hynin e dilnin njerëz. Çmallëshin, njiheshin ose rinjiheshin me bashkëfshatarin e tyre. Aty nga mbasditja, pasi u çlodh nja dy orë, Mitro Çaka kërkoi të dilte lart, te burimi në krye të fshatit.

— Është burimi i Pilos? — pyeti xha Vasilin.

— Është, por jo si i pari. Tashti nxjerr shumë ujë. E kemi ftisur me mur, — i tha i vëllai.

Xha Vasili ishte i zënë me punë. Kishte darkë të madhe atë natë. Pas dyzet e pesë vjetësh iu kthye nga fundi i botës i vëllai, të cilit ia kishin hequr disa herë fillin e jetës. Prandaj ai i tha të vëllait:

— Unë kam ca punë tashti. Dil me mësuesin, — dhe ai bëri me kokë nga unë, — dhe me Lekon. (Lekojka ishte nipi i tyre, djali i motrës, teknik veteriner i kooperativës.)

— Mirë, Vaso, dal me këta unë, po shiko, mos e vur veten në kasavet, unë jam mësuar me pak...

— Mos ki merak hiç për atë punë, — i tha i vëllai me dashamirësi të madhe.

U ngjitëm te burimi i Pilon. Mitro Çaka ndaloi dhe shikoi përreth një copë herë të gjatë.

— Sa mirë e paski bërë!

— U afrua, piu ujë në dorë dhe prapë tha:

— Sa mirë!... Këtu mbushja dikur bucelën me sapllak. Atëhere ishte një koritë druri. Përpara se të dilte ky burim, shkonim përtej në rrëzë të malit e mbushnim ujë. Këtë e ka hapur Pilo Leka, disa vjet përpara se të lindja unë. Eh, ç'nuk ndodh në jetë me njerinë! Kur nxirrte gurët për të rregulluar burimin, Pilon e nduku një gjarpër i zi në qafë të këmbës. E vrau gjarpurin, por vdiq edhe vetë aty nga mesi i natës. I mbeti burimi përgjysmë, të ziut Pilo... E mbaroi pastaj fshati dhe burimit i la emrin e Pilon... Besoj e ke dëgjuar këtë histori?

— Po. Ma kanë treguar që kur erdha mësues në Boran.

— Sa vjet ke këtu?

— Pesë vjet. Që në fillim më dha një dhomë xha Vasili dhe jam bërë aty si i shtëpisë.

— Bukuri!... Sa mirë!... Puna e mësuesit është punë fisnike, shumë fisnike. Shikoje që në emër. Të mësosh njerëzit... Tamam prind i dytë. Atëherë kur isha i ri unë, në Boran nuk e njihnim mësuesin. Ishin dy a tre vetë të kënduar, me gjithë priftin, a s'ishin. Ej Borani me shkollë, me dije!..

Dolëm në një kodrinë përpara burimit dhe u ulëm mbi një pllakë guri. Përpara shtrihej fshati. Përposh në fushë vete e vjen traktori në një parcelë të

madhe. Pranë nesh kalojnë dy të rinj. Kthehen nga arat. Takohen me ne dhe ikin. Mitro Çaka më pyet për ta. I them se djali është i biri i Pilo Lekës, kurse vajza është e Gjokëve. (Këta të dy fise për shumë vite përpara Çlirimit kanë qenë në hasmëri.) Mitro Çaka bie në mendime. Rri një copë herë ashtu dhe më thotë:

— Eh, mor bir, ç'qenka bërë këtu! ... Qenka përmbysur nga rrënjët jeta që lashë unë. ... Djali i Lekëve e çupa e Gjokëve punojnë bashkë! Shkojnë bashkë nëpër pyll e nëpër fshat! Çudi! ... Në ato kohëra nuk kishte vend varri kjo punë. ... Eh, Boran! ... Djali i Lekëve me gjyslykë dielli! ... Çupa e Gjokëve. ... traktori, makina në Boran, — fliste Mitro Çaka si në kllapi.

Zbritëm nga kodra. E shpura Mitron në muzeun e fshatit. Atje, ai pa tablonë e jetës së vjetër, njohu në fotografi shokë të fëminisë, që kishin rënë në luftë për lirinë. Kur unë i thashë se gjaku i tyre lindi jetën e re, bëri që djemtë e vajzat të punojnë bashkë, që traktori të vinte në Boran, Mitro Çakës nuk iu mbajtën lotët. Ai më hodhi dorën në sup dhe më tha:

— Ti e ke ngritur këtë muze?

— Bashkë me gjithë fshatin, — i thashë.

— Eh, ju lumshin duart! Sa mirë! Eh, ta dish, mor mësues, se ç'djem kanë qenë këta që janë vrarë! ... Ç'djem kemi qenë të gjithë në atë kohë, po ç'e do, nuk kishim sy! ... E ç'mund të bëjë njeriu pa sy? Eh, ç'jetë ka qenë ajo! Po do llafosemi, do llafosemi, këtu jemi, dhe heshti.

E shpura Mitro Çakën në shkollë, në shtëpinë e kulturës. E shpura në banjot e fshatit e në furrën e bukës. Ai shikonte, habitej, mendohej e mërmëriste: «Sa mirë! Sa çudi!» Ai habitej, jo ngaqë s'kishte parë



andej nga kish qenë të tilla gjëra, por ngaqë këto nuk ia kishte marrë mendja kurrë se do të zbrisnin në Boran. U ulëm një copë herë mbi një gur për t'u prehur. Atë e kishte pushtuar një ngazëllim i thellë. Hodhi sytë nga shtëpitë e fshatit dhe më tha:

— Ty, mësues, mund të të çudisë gëzimi ose habia ime për këto që shikoj në Boran. Unë kisha dëgjuar për këto ndryshime, më kishte shkruar Vasili, i dëgjonim nga Radio Tirana; vinte zëri deri atje. U hap lajmi njëherë në të gjithë shqiptarët që ishin atje, se Shqipëria u bë e tëra me drita. U hap lajmi se nuk ka më taksa, se mjekimi është falas. Po si të besonim ne, që kishim lënë prapa një Shqipëri të mjerë? E që në ato vende, aq të mëdha e të zhvilluara, ku jetonim, shtrimi në spítale dhe vendi i varrit paguheshin me flori?! Pale, pastaj, përpjekjet e armiqve të Shqipërisë për t'i bërë këto të pabesuarat!...

...Eh, ç'është jeta larg atdheut, ç'është kurbeti! Sa të merr malli edhe për gurët, edhe për drurët e vendit tënd!... More, edhe e keqja në vendin tënd të duket më e mirë se mirësia e vendit të huaj, që mund të fitohet me aq mundim e poshtërim!... Sikur malli e dhembja e kurbetlinjve, kudo që janë, të kthehej në ujë, do të formonte një lumë të harbuar që do të mbyste të gjitha padrejtësitë e ligësitë e kësaj bote.

Në mbrëmje shtëpia e Vasil Çakës ziente nga gëzimi.

— Të pimë për Mitron, që i ra botës përreth dhe u kthye prapë te gurët e vendit të tij!

— E pi për ju, që kini ndërtuar një jetë të bardhë... që djali i Lekëve... që vajza e Gjokëve... që djemtë... që vajzat...

Mitro Çakën e mbyti mallëngjimi dhe gota i dridhej në duar. I kishte bërë përshtypje të madhe ta-

kimi me dy të rinjtë te kodra e burimit. Ata iu dukën më të çuditshëm, sesa traktori, shtëpia e kulturës, banjoja, furra, shtëpitë e reja. Këtë e vura re që atje te kodra e burimit, po nga ta dija unë se ata dy të rinj i kishin shpalosur Mitro Çakës përpara syve dramën e jetës së tij?..

*
* *
*

Shkolla e fshatit Boran është ngritur në një shesh të gjerë. Përtej sheshit është një luginë e thellë, e pyllëzuar. Në krye të luginës ngrihet Shkëmbi i Pëllumbave ose Shkëmbi i Vitos, i lartë gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë metra. Nga dritarja e klasës shikoj shpesh Mitro Çakën, që kalon nëpër shkurre, humbet nëpër pemë dhe del mbi Shkëmbin e Pëllumbave. Ulet atje në një hije dhe rri një copë herë të gjatë. Kjo gjë më bëri përshtypje. Një ditë i shkova pranë. Ai e kishte humbur shikimin poshtë në luginën e thellë.

— Mos të shqetësoj gjë, xha Mitro? — i thashë.
— Jo... jo, jo aspak. Eja të bëjmë një çikë muhabet, — më tha.

Pas ndonjë copë here i thashë se më kishte bërë përshtypje qëndrimi i tij te ai vend. Ndoshta do të ishte më bukur nga ana tjetër e fshatit, nga dukej gjithë horizonti. Ai ra në mendime. Shikimin e lëshoi poshtë, në greminën e thellë. Heshtëm një copë herë e atë heshtje e prishi ai vetë.

— Dëgjo, bir... Vajtën tre muaj që jemi njohur... Kemi bërë goxha muhabet bashkë... Të kam folur për atë botë që njoha gjatë pesëdhjetë vjetëve, të kam

folur për këtë që njoha këtu, edhe për atë që lashë mbrapa kur ika. Edhe ti më ke folur për ato që ke në zemër. . . Mirë kemi bërë, se njeriu ka nevojë të ndërrojë muhabet, të ndërrojë kujtime e përshtypje. Ndryshe të duket sikur të ndryshket shpirti. . . Me pyetjen që më bëre më ke hapur dregëzën e një plage të vjetër. Këtë do të ta them ty, por të mbetet këtu te Shkëmbi i Vitos. Të mbetet këtu, pasi deri më sot nuk e di njeri në fshat, përveç një të gjalli dhe një të vdekuri.

Unë mbeta me shikim të ngulur në sytë e tij. Më dukej sikur në ata sy po vërtitej një re që do të lëshonte stuhinë.

— Unë të kam folur për rininë time e të shokëve të mi, të kam folur për ato vite të egra. Mua më habit sot liria e njerëzve, pasi në ato kohëra kjo nuk mund të merrej me mend. Edhe të qeshurit, edhe shakatë atëherë kishin një lloj ashpërsie. Shoqëria e djemve me vajza ishte atëherë e pamundur. Pa lëre t'i prisje udhën një vajze, t'i flisje një fjalë në burim, ose të flisje për dashuri me të! Dashuria atëherë dënohej me vdekje. . .

Po do të thuash ti: fare pa një çikë dashuri ndërroheshin motet, nuk gjenin asnjë shteg ndjenjat e njerëzve? Po atëherë, nga kanë dalë këngët? Kujt i këndonte ai bariu kur thoshte:

Shokë më bini longarë,
Do t'ja marr me të qarë,
për atë miken e parë.

Po. Ke të drejtë të më thuash. . . Dashuria gjente ndonjë shteg. . . Ndjenjën e lirisë dhe të dashurisë nuk i vret dot plumbi, more bir. Këtë të pamundur unë

e kam gjetur kudo në botë, të bardhë, të zes apo të verdhë të ishin njerëzit.

Mitro Çaka ndaloi një çast. E hodhi shikimin një herë poshtë në greminë, mori frymë thellë e, pasi më nguli sytë, tha:

— Ja... unë, në ato kohë që kërciste plumbi për një të qeshur me një vajzë, në këtë luginë të egër kam dashuruar.

Ai i shqiptoi këto fjalë me një ton të habitshëm, të pakrahasueshëm. Sikur përpara tij, në vendin tim, të kishte të gjithë brezat e shkuar e t'u fliste me kërcënim. Nga gufalla e gjoksit gjashtëdhjetepesëvjeçar dukej se do të shpërthente dufi i një dashurie të lemerishme.

— Po, bir, ja, kjo luginë e egër, ky pyll, këta gurë na fshehën dashurinë mua dhe Vitos... Në këto shkrepë u dashuruam... Unë ruaja dhitë e zotit Gaço, pasanikut të fshatit, ajo bënte dru... Këtu e fshehëm përqaftimin e parë, nga i cili dridheshim si qengji i lindur në breshër... Këtu, në këtë luginë, takoheshim me frikë në zemër, por me një zjarr që mbulonte çdo gjë. Zjarr të atillë shpirti im nuk ka njohur më... megjithëqë brodha botën... Nuk them se nuk kam njohur tjetër grua, por zjarri i kësaj lugine nuk u ndez më. Ai këtu lindi dhe këtu u shua. Unë varrit do t'i vete me fjalët e Vitos, me ato fjalë që, për mua, ishin më të sinqertat e më të ngrohtat në botë.

— Ishim atje përposh, te ato harcat, kur m'u hodh për qafe dhe më pëshpëriti pranë veshit: «Mitro, të dua me zemër, më vdekshin të gjithë!» Edhe unë e doja përmbi të gjithë, por frika e «kriminalit» që po bënim na rrinte mbi kokë si ajo reja me vetëtima. Dy fiset tona ruanin një hasmëri të vjetër, që një shkëndijë donte të ndizej për vdekje. Ne po bënim një gjë

të padëgjuar në fshat; fiset në gjak, ne në dashuri. Ku di unë si ndodhi ashtu e u dashuruam, pa u menduar se ku na shpinte mushka.

Nuk kishin kaluar tre muaj, kur Vitoja më tha duke u dridhur e tëra:

— Mitro! Si do bëj?.. Unë kam mbetur me barrë. Fëmija po më rritet. Do më kuptojnë njerëzit... Do më branitin nëpër fshat. Do më vrasin, do më varin te arra e Gjokëve... Do pëlcasë ndonjë hasmëri... Kush e duron turpin?»

Tronditje të atillë nuk kisha provuar deri atëherë. E ç't'i thosha Vitos, ku të futeshim? Unë çoban te zoti Gaço, dhe ajo po aq e varfër sa unë. Ajo priste me lotë në sy, priste një fjalë nga unë. Po ç't'i thosha, ku të shkonim në atë kohë?

— S'kemi rrugëdalje, veç vdekjes... Të vdesim bashkë, mu këtu te Shkëmbi i Pëllumbave, — i thashë.

— Po si të vdesim? — më pyeti dhe, pasi m'u mbështet në gjoks, mërmëriti me të qarë: — Jo, Mitro! Ti nuk duhet të vdesësh. Unë po, unë nuk kam nga ia mbaj... Nuk kam kujt t'i them të më ndihmojë, fjala do hapet menjëherë, dhe babai me vëllezërit do më vrasin me turp. (Vitoja kishte katër vëllezër.)

Ty mund të të duket e çuditshme, mësues, por ja që ne flisnim atë ditë për vdekjen sikur ajo të ishte kurora më e bukur e martesës sonë.

— Unë do të gjej hapje dhensh. Ato janë helm, — i thashë. — Do t'i pimë të dy e t'i japim fund me kaq jetës.

— Jo, — më tha. — Ti nuk duhet të vdesësh. Ma gjej mua atë helm.

Tërë atë natë e gdhiva pa gjumë. Të nesërmen shkova te një mik në fshatin fqinj të gjeja helm.

Nuk e gjeta. Kur u ktheva mbasdite, dëgjova një kuje që ma vrau shpirtin për jetë: Vitoja ishte hedhur nga buza e këtij shkëmbi, që turpi i saj të mos merrej vesh, që ajo të mos i shikonte në familje pasojat e turpit të saj, e, me sa dukej, të mos pija edhe unë helmin bashkë me të. Te buza e shkëmbit kishte lënë një krah dru të prera. Kjo bëri që aty për aty vdekja e saj të merrej si e rastit. Kjo luginë rënkonte atë ditë nga ulurimat. Gratë e veshura në të zeza, që zbritën përposh me ulurima, trembën dhe pullumbat që këtu kishin foletë e tyre. Që atë ditë ky shkëmb u quajt Shkëmbi i Vitos. Atë ditë unë isha njeriu më fatkeq në fshat. Dhembjen time të rëndë askush nuk e dinte. Keqardhja dhe faji ma ndrydhnin shpirtin e më nxitnin ndjenjën e vetëvrasjes. Një zë më dilte nga zemra: «Vraje veten, Mitro!» E kundër këtij zëri ngrihej ai i Vitos: «Jo, Mitro, ti nuk duhet të vdesësh!» Dhembjen e asaj dite nuk e kam provuar më as më vonë, megjithëqë jam ndodhur shpesh i vetmuar, i arratisur, i uritur... lypës nëpër udhët e Greqisë, të Amerikës, Kanadasë e Gjermanisë. Nuk kaluan as dy-tri ditë nga vdekja e Vitos, dhe në fshat filluan të dilnin fjalë. Një mbrëmje vonë më erdhi në shtëpi një shoku im. Ishim të dy barinj te zoti Gaqo.

— Nëpër fshat ka dalë fjala se Vito Çipa ka qenë me barrë. Prandaj është vrarë. Thonë se fëmijën e kishte me ty.

Fjalët e tij më ranë si thika në trup.

— Kush e ka hapur këtë fjalë? — e pyeta duke u munduar të ruaja gjakftohtësinë.

— E kushërira e zotit Gaqo. Ajo e kishte kuptuar edhe barrën. Thonë se dikush edhe të ka parë me Viton, prandaj duhet menduar mirë për këtë punë, Mitro. Ju jeni në hasmëri. Zoti Gaqo e ka në hundë

inatën që ditën që u grind me tët atë përpara pleqësisë së fshatit. Do ndezë urët. Do të të vrasin ty dhe babanë. Çipajt janë shumë. Ju jeni vetëm dy vëllezër.

Mbeta një çast i heshtur. Ç't'i thosha shokut tim? T'ia fshihja të vërtetën, më dukej sikur Vitoja do të ngrihej nga varri dhe do të më thoshte: «Pse e fsheh dashurinë tonë? Thuaje hapët!» Megjithatë, shokut nuk iu hapa.

— Këto janë fjalë që i shpif zoti Gaqo, por nuk do t'i dalin mbroth, — i thashë.

— Mirë, mirë, ti ki kujdes. Fjala është hapur e do të marrë dhenë. Do flasin fshati, e aty ku pësh-tyn një fshat, bluan një mulli, i kanë thënë të parët!

Shoku iku. Unë mbeta në atë hall të madh. Ç'të bëja? Isha atëherë nja njëzet vjeç djalë. Babanë e kisha gjysmak, të sëmurë. Vasili ishte i vogël. Tërë atë natë mendoja e thurja mënyra. Pa u gdhirë ika nga shtëpia, ika natën, si ai që ngrihet e ikën në gjumë. Ika pa e marrë vesh njeri. Ika ta shkarkoja nga faji familjen. Hasmët le të më kërkonin... Eh!... Nga ajo ditë kanë kaluar gati pesëdhjetë vjet. Eh, ç'vuajtje kam parë nëpër udhët e kurbetit! Vuajtja është kudo vuajtje, por kur e heq në vend të huaj, mes njerëzve të huaj, ajo është e dyfishtë.

Kjo është, o mësues. Ky kujtim i këtij shkëmbi më ngjallet përsëri sikur të ketë ndodhur dje. Ky kujtim më erdhi para syve te kodra e burimit, atë ditë që takuam djalin e Lekëve me vajzën e Gjokëve. Edhe gjyshërit e tyre kanë qenë dikur në hasmëri. Eh!... Sot kjo e keqe e madhe, që mbillte zinë nëpër fshat, është zhdukur. Vetëm kjo do të ishte një çudi më vete për të gjithë kurbetlinjtë që jetojnë nëpër botë, ku koburja pëlçet në mes të rrugës, në mes të ditës.

JETA E NJË HEROI

— Tashti që u njoha disi me njerëzit, mund të lëviz vetë nëpër kantier. Ju vazhdoni punën tuaj, inxhinier, të mos ju pengoj. Do të takohemi prapë, — i thashë.

— Mirë, si të doni.

U ndamë.

Ndenja pranë një montatori. U njoha më mirë me një murator. Një copë herë e kalova me ekskavatoristin, e pastaj në kabinën e buldozerit. U njoha dhe u miqësova me shumë vetë. Kaluan pesë a gjashtë orë pa u ndier. Aty nga ora tre, ndjeva uri dhe dëshirë të ulesha e të shkruaja për njerëzit që njoha. Ato biseda, kujtime dhe episode që vola nga njerëzit më përziheshin e më dukej sikur s'do t'ua gjeja fillin.

U largova nga kantieri B.

Me heroin e punës socialiste inxhinier Rako Nasin e lashë të takoheshim në mbrëmje në sallën e hotel turizmit të qytetit. Autobusi urban ecte nën hijen e plepave të lartë që përzierin degët mbi xhadenë e asfaltuar e krijonin shembëlltyrën e një tuneli të gjelbërt. Unë bluaja mendime nga përshtypjet e ditës: «Biografia e montatorëve është e hekur».

«Inxhinier Rakoja është njeri i vërtetë. I ka hije heroizmi».

«Kalemi gërmon më thellë se thika e buldozerit».

Këto fjalë të njerëzve me hekura, me tulla e leva nëpër duar, më përziheshin në mendje e, nuk di pse, ndieja frikë se mos më humbisnin. Në bllok kisha fare pak shënime.

Pasi hëngra drekë u futa në ashensor dhe u ngjita në katin e nëntë të hotelit. U shtriva në krevat. Mendimet s'më linin rehat. U ngrita dhe u ula pranë tavolinës. Sapo vura penën mbi letër, mbresat e kantierit vërshuan: Biografia... Njeriu i punës... heroi... Mendja... grafikët... Kalemi gërmon... jeta lëviz...

Njerëzit që kisha njohur atë ditë më rrethuan tavolinën e vogël. Bela, nga t'ia nisja? Mendimet s'po i rendisja dot. Grindje për titullin. E lashë fare. Nisa të shkruaja. «Titullin po e vë në fund, a kur të dalë», thashë me vete. Kur dola nga faqja e dytë, i hodha sytë orës. Gjashtë pa dhjetë. Në gjashtë duhet të prisja poshtë në sallë inxhinier Rakon. Zbrita. Inxhinieri kishte ardhur më parë dhe ishte ulur në qoshe të sallës, në të majtë të banakut. Sapo u ula, kamarierja u afrua dhe pyeti inxhinierin, që, me sa dukej, e njihte.

— Kafe?

— Një minutë, të lutem. Ç'do të marrim? — më pyeti inxhinieri.

— Ç'të doni ju.

— T'i qëndrojmë zakonit, — më tha me buzë në gaz dhe shtoi:

— Marrim nga një raki?

— E marrim.

Për pak minuta kamarierja solli rakinë dhe dy pjata meze. Biseda nisi të rridhte shtruar. Mësova se inxhinieri kishte dy fëmijë: djalin në universitet, kurse vajzën në pedagogjiken e qytetit.

Ndërkohë në sallë u fut një plak i mbajtur, i veshur pastër. Inxhinieri e pa dhe i bëri shenjë. Ai erdhi, i shtrëngoi dorën me dashamirësi inxhinierit dhe e pyeti për njerëzit e shtëpisë. Plaku u njoh edhe me mua.

— Rrini, u bëftë mirë! Po rri më tej, — tha plaku dhe bëri të largohej. Inxhinieri nuk e la. E uli në tavolinën tonë.

— Është mësuesi dhe miku im, — më tha inxhinieri.

Sytë e vegjël gri të plakut, që u ul përballë meje, lëshuan mbi inxhinierin një shikim të ëmbël. Inxhinieri porositi raki edhe për mësuesin e tij.

— Paskeni një punë të bukur, — më tha mësuesi pasi më njohu.

— Eh, çdo punë ka bukurinë e saj, mësues, — i thashë.

— Ashtu, po ka detyra që dallohen disi nga të tjerat, jo nga rehati, po nga qëllimi, — ma ktheu ai me një ton që të linte të kuptoje se përgjigjja ime ishte disi zyrtare. Mësuesi ngriti gotën, na uroi, e, pasi hoqi një gllënjë, më tha:

— Detyra e mësuesit dhe e gazetarit kanë një farë ngjashmërie. Mësuesi vërtet komunikon me njerëzit, por me ata që mëson gjatë jetës së tij. Kurse gazetari komunikon njëherësh me mijëra njerëz, bile edhe me botën e jashtme. Këtu qëndron bukuria e zanatit tuaj, por edhe përgjegjësia.

Fjalët e mësuesit ishin të sinqerta, pa qëllim komplimenti. Pastaj unë e pyeta inxhinierin se si i vinin fëmijët me shkollë.

— Shkojnë mirë... Që në fillim unë dhe gruaja u kushtuam vëmendje. E nisën me pasion mësimin dhe kanë dalë gjithmonë me dhjeta. Djali xheku bin-



te nga dhjeta, por jo më poshtë se nënta, — tha inxhinieri i kënaqur.

— Hëm... tek ka rrjedhur, do të pikojë, — tha mësuesi e si më pa me ngulm, vazhdoi:

— I shkëlqyer ka qenë edhe ky në mësim. Ma merrte njëshin nga duart. Por... ishte ajo kohë që e ardhmja e nxënësit të shkëlqyer varej nga shtresa që i takonte. Ndoshta jeni llafosur me Rakon?

— Jo, — thashë dhe prita, kureshtar, që mësuesi ta shtirte më tej lëmshin e kujtimeve të vjetra me inxhinierin. Inxhinierin — hero e kisha personazh të tregimit që do të shkruaja. Për të më kishin folur shumë fjalë të mira njerëzit e kantierit, por nga jeta e tij përtej kantierit nuk dija gjë. Mësuesi i tij më doli në shteg. Unë bëra gati pyetjen. Mësuesi tha:

— Eh, pleqëri e keqe, si i nxiton punët!... Unë nuk pyeta njëherë se që kur jeni njohur ju!

— Sot jemi njohur. Kemi si të thuash pesë-gjash-të orë miqësi, — i thashë.

— Oo... ju sapo i kini thënë njëri-tjetrit...

— Gëzohem, që u njohëm, — e ndërpreva padashur.

— Jo. Sapo kini thënë «mirëmëngjes». Shprehja «gëzohem që u njoha» nuk është fort e saktë. Ka mbetur disi standart. Kënaqësia e njohjes me një njeri vjen pasi ke njohur në fakt karakterin e tij në jetë e ndaj shoqërisë...

Mësuesi po më dukej mjaft i këndshëm në bisedë. Në fjalët e tij ndihej kultura e jetës dhe e librit.

Mendja më shkoi përsëri te reportazhi. Heronjtë e mi m'u gjendën aty përreth. Në mes tyre u fut edhe mësuesi plak.

«Ato dy faqe që shkrova duhen parë... Ndoshta

duhet ta filloj nga e para, ose të shkruaj diçka tjetër»,
— mendova me vete.

— Me sa duket, inxhinierin e paskeni pasur nxënës para Çlirimit? — e pyeta për të kthyer rrëkenë në mullirin tim.

— Po, po... Na lidhin rrënjë të thella me Rakon,
— tha mësuesi.

Në sytë e tij lexohej lehtë dëshira për t'u futur në ato kujtime.

— More, po ju kishit bisedën tuaj! Ju largova, më duket.

— Jo, aspak. Ne po bënim atë që thatë ju: po njëheshim, për të mos thënë pa vend: «gëzohemi që u njohëm».

Qeshëm të tre. Mësuesi vazhdoi bisedën:

— Me Rakon jam njohur që në vitin 1937. Në atë vit unë hapa shkollën, ose më drejt më dërguan atje, në Xhuarë të Lushnjës si mësues. Po ç'shkollë ishte ajo? Një thark me drunj të lyer me baltë, me dy dritare të vogla. Sa të varfër ishin njerëzit, sa i varfër qe vendi!... Myzeqeja atëherë ka qenë ndoshta vendi më i varfër në botë. Kisha njëzet nxënës; nëntëmbëdhjetë ishin të varfër, fëmijë bujqish. Tërë jetën më kanë dalë para syve, ashtu të verdhë, malarikë, të grisur. Shpesh më vinin edhe zbathur në klasë, me këmbët me baltë e të mufatura nga të ftohtit... Sa të drejtë ka patur i shkreti Migjen, kur shkruante për dhembjet e mësuesit përpara nxënësve të mjerë! Rakoja ishte një nga të nëntëmbëdhjetët. I veshur, i shëndetshëm e i mbathur ishte vetëm djali i Lipes, agait të fshatit.

Ditën që shkova në Xhuarë, agai më thirri e më tha:

— Kjo shkollë është hapur me pëlqimin tim, e ndaj

për çdo gjë do më pyesësh mua. Kam djalin, që dua t'i jap gramë. Do ma kesh në kujdes. Do ma vesh në bango më vete. Dëgjove?

— Po, aga, — i thashë.

Agai ishte injorant këmbë e kokë, po ç't'i bëje?

E vura djalin e beut më vete. Po ç'e do? Nuk bënte efekt as banga, as rrobat e mira e as shëndeti. I biri i Lipe agait kishte kokën e të atit. Në mësim ishte nga më të dobëtit. Me mendje, them, se me nota ishte me të mirët. Po, po, notë të dobët nuk i vija dot të birin të agait. Njëherë i thashë Lipes për të birin, po ai m'u hodh në kokë:

— Për atë punë të kemi sjellë këtu, ta mësosh, ndryshe e mësoj vetë! Dëgjove? Ajo shkollë është hapur më tepër për atë djalë, o mësonjës.

Kjo ishte e kuptueshme: po të mos kalonte djali i Lipe agait, shkolla mund të mbyllej, dhe mësuesi të ikte me trastë në krahë. Ç'të bëja? U gjenda përpara një gdhëri që kishte në dorë gjithë fshatin. Unë, jo vetëm nuk mund t'i vija notë të dobët agait të vogël, por duhej as të mos i hiqja vërejtjen, të mos e fyeja përpara të tjerëve, prindërit e të cilëve ishin bujqër të agait. Në vitin e tretë më ikën dy nxënës, nisën jetën e rëndë të hyzmeqarit. Rakoja ishte nxënësi më i mirë i klasës. Por edhe nga më fukarenjtë. Sa herë takohem sot me të, mendja më shkon në ato vite, dhe Rakoja më vjen para syve i pakët, i verdhë, i zbatthur e gjithnjë i menduar.

E doja shumë Rakon, megjithëqë rrihte i druajtur.

Kur ngrija në mësim djalin e Lipe agait, nuk ngrija nxënës të mirë, pasi kjo do ta poshtëronte aganë e vogël përpara bujqve të tij të ardhëm. Mirëpo një ditë, aty nga fillimi i vitit të katërt, unë ngrita në mësim Rakon. Ky m'u përgjigj si gjithnjë shumë mi-

rë. Pas tij ngrita Mitin, agan e vogël. Ai përtypej e ngecte në përgjigjet. Dikush qeshi nga klasa. Qeshën dhe të tjerë. Agai i vogël i hodhi sytë si egërsirë mbi shokët e tij. U hoqa vërejtjen nxënësve, kurse agait të vogël i bëra nja dy pyetje të lehta dhe e ula.

Notat nuk ua tregova as Rakos, as atij. Në pushimin e orës së dytë Rakoja nuk doli jashtë. Kur u futëm orën tjetër, ky rrinte i mërzitur. Nga sytë dukej se kishte qarë. Në pushim i vajta pranë dhe e pyeta:

— Ç'ke, more Rako, që rri kështu?

Ky u mendua, u skuq dhe më tha.

— Ç'të kem, zotni... Ju e shihni vetë.

— Çfarë të shoh, mor Rako?

Po ja, atë... që... jo vetëm unë, por edhe ju... jeni hyzmeqar i agait.

Mbeta ngushtë. Nxënësi im më i mirë më tha një fjalë të rëndë, por të vërtetë. Më habiti guximi i tij. Ajo heshtje që ndrydhte pakënaqësitë, plasi më në fund përpara meje.

— E pse qenkam edhe unë hyzmeqar? — e pyeta.

— Poo... kështu jeni, kështu do zoti, zotni... Miti i Lipe agait mezi i bëri dy llafe bashkë, po ju i vutë një notë me mua.

— Pse, paske kontrolluar regjistrin ti? — thashë me inat.

— Jo... Ju e kishit lënë hapët, dhe unë hodha sytë.

— E pse të hidhje sytë? — i thashë sa për të mos e dhënë veten.

Ishim vetëm në bangën e tij. Ky më hodhi një shikim keqardhës dhe më tha:

— Më falni, zoti mësues, për këtë... por ajo që ju thashë, ashtu është. Ne jemi të gjithë bujq të Lipe agait.

Më tha kështu dhe u ngrit e iku, për të mos qarë

në sy tim. Unë mbeta në klasë, i plagasur rëndë. Të nesërmen Rakoja nuk erdhi në shkollë. Pasdite i shko-
va në shtëpi. Prindërit e tij më pritën me zemër të
bardhë në atë koluben e zezë... Jëtonin keq... ishin
shumë të varfër... Aman, or shokëni, si i shtynin vitet
njerëzit në atë mënxyrë jete! Rakoja më dha fjalën
se do të vinte në shkollë. Nga mezi i vitit të katërt,
unë e lëvdova përpara klasës si nxënës shembullor.
Mirëpo kjo doli për keq. I biri i Lipe agait u revoltua
aq shumë, sa që në pushimin e orës u grind me mua.
Më vinte plasja kur shikoja brutalitetin e agait të
ardhshëm te një fëmijë trembëdhjetë-katërbëdhjetë
vjeç. Ç'të bëja? I fola rëndë atë ditë, por kuptohet edhe
me kujdes, që të mos cenoja të atin. Ç'e do! Punët
shkuan keq. Të nesërmen Lipe agai kaloi me kalë afër
shkollës më thirri dhe, pa zbritur nga kali, më tha:

— Dje i ke folur rëndë tim biri!

— Jo. I fola si mësues për t'u sjellë mirë, aga, —
i thashë.

— I ke folur për hatër të bujkt të tij, për qejf
të djalit të Thoma Nasit.

— Jo, aga. Djali i Thomait nuk ka asnjë faj. Ai
mëson dhe sillet shumë mirë.

— Mësoka mirë! Po nuk e di ti se unë nuk kam
nevojë për terxhumanë këtu? Nuk e di se fëmijët e
bujqve të mi më duhen bujq e jo kalemxhinj?

— Shkolla për të mësuar u hap, më duket, aga, —
i thashë.

— Atë pse u hap, e di qeveria! — më tha me inat.

— Unë jam mësues dhe nxënësit të mirë do t'i
jap atë që i takon, aga.

— Nuk më duhet mua se ç'jep ti. Nesër të birin e
Thoma Nasit mos e prano në shkollë. Të shkojë në
punë.



— Këtë gjë nuk mund ta bëj, aga... Nuk mund t'i them ik nga shkolla, se je nxënësi më i mirë.

— Këtë do ta bësh, zoti mësonjës, në qoftë se nuk do të të ikin të gjithë nxënësit. Unë djalin tim e dërgoj edhe në Lushnjë a në Fier, po të jetë nevoja. Dëgjove?

I ra kalit dhe iku. Mbeta si i ngrirë. Më dukej sikur kali i tij po shkelte mbi mua. I thashë Rakos. Nxënësi im i mirë mbeti si i ngrirë. Atë ditë nuk iku. Të nesërmen erdhi në shkollë me të atin. Sa pa bërë dy fjalë me ne, erdhi agai, që ishte lajmëruar nga i biri.

— Ti, Thoma, ç'do këtu? — i tha babait të Rakos.

— Erdha... Kisha punë me mësuesin, aga.

— Po plehun e lopëve kush e heq atje? Ç'punë ke këtu ti?

— Po... ja, aga.... djalin... pse ta heq nga shkolla?

— Unë nuk dua dhaskalë! Merre atje në haur të lopëve që sot.

— Aman, Lipe aga, lëre dhe katër muaj ta mbarojë të katërtën, t'u shtoftë dita!

— Dërgoje atje ku të thashë, e lëre ditën time, se e shtoj vetë unë, ndryshe rrini këtu në shkollë të gjeni bukë, — tha Lipe agai, dhe u largua.

Nxënësit e tjerë rrinin sikur t'u kishe prerë kokat. Agai i vogël rrinte përtej, si ai ujku që lëpin buzët pasi e ka bërë gjëmën. Rakoja më dha dorën e më tha:

— Po iki, zoti mësues.... Ne jemi bujq të agait.

Ato fjalë m'u ngulën thikë. Me zor i mbajta lotët. Nxënësi im i mirë e i dashur iku.

E shikoja hyzmeqar e më dhimbte zemra. Herë

pas here e takoja. U bëmë si shokë, qanim halle. Atëherë Rakoja ishte në të katërmbëdhjetat.

— Këtu, më fal, se do të të ndërpres, zoti mësues, — ndërhyri inxhinieri, që gjatë gjithë kohës kishte dëgjuar, herë duke lëvizur gotën mbi tavolinë, herë duke shikuar mësuesin e tij të vjetër.

— Urdhëro, Rako, — i tha mësuesi me atë ëmbëlsi me të cilën i kishte folur shumë vite më parë.

— Këtu thuaje edhe atë që bisedonim bashkë kur qanim halle. Ti më jepje guxim, më flisje keq gjithmonë për agallarët. E një ditë më the se do të vijë një kohë që ferrat në jetë do të shkulen e Lipe aganë do ta hedhim në gjol.

— Ee... kështu, më duket, — tha i menduar mësuesi.

— Po, po, pikërisht kështu, — i tha inxhinieri. — Bile mua më shtyje që këto t'ua thosha dhe shokëve të mi.

— Eh... jetë, jetë! — tha plaku duke fërkuar ngadalë duart dhe vazhdoi:

— Në fund të vitit ia dhashë dëftesën fshehurazi edhe Rakos. Ia dhashë shkëlqyer, me ato nota që kish lënë shkollën. Mirëpo ky sekret na doli e më erdhi radha mua. Lipe agai, i egërsuar për këtë gjë, i luajti gurët dhe më pushoi nga puna. Vitin tjetër u futa mësues me anë të një miku në Dibër.

Vitet ecën. Gjatë Luftës u mora me organizimin e këshillave nacionalçlirimtare. Pas Çlirimit u takova fare papritur me nxënësin tim të Xhuarës. U takuam në Durrës. Unë drejtoja kurset kundër analfabetizmit, kurse Rakoja ishte në shtabin e ndërtimit të hekurudhës së parë. Ishte lidhur me Luftën që në fillim të saj dhe kishte qëndruar në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare gjer në Çlirim.

E pyeta atëherë për Lipe aganë.

— Lan borxhet. E kemi hedhur në gjol, — më tha Rakoja.

Jeta eci. Nxënësi im i dikurshëm, vazhdoi studimet, u bë inxhinier, ndërtoi fabrika kudo, në të katër anët e vendit. Kështu është ngjitur deri në shkallën e heroit. Pse të mos ngjitet?... Njerëzve u është dashur dija dhe udha e lirë. Por nuk duhet harruar kurrë udha që u bë deri këtu...

— Po tashti këtu banoni? — i thashë mësuesit.

— Po, po. Kam ardhur këtu, vite më parë. Jam marrë me punët në pushtet. Tashti jam në pension. Herë pas here takohem e shkëmbej vizita me nxënësin tim. Futemi në ato kujtime që i japin bukuri jetës. Se në të vërtetë jeta pa kujtime nuk do të kishte kuptim. Bile, ajo nuk duhet matur me vite, por me veprime, me kujtime të mira... Kështu, or shok, që nuk u lashë radhë të flisnit, — e mbylli fjalën mësuesi me buzën në gaz dhe ktheu gotën.

Ora po shkante nëntë. U ngritëm. Te porta e sallonit u ndamë.

— Gëzohem, që u njoha, — thashë në kohën që po tokesha me mësuesin plak.

Qeshëm të tre. Ata zbritën shkallët bri njëri-tjetrit. Unë nuk u futa në ashensor. U nisa lart shkallëve, i menduat. Bashkë me mua ngjiteshin njerëzit e asaj dite. Më dukej sikur dëgjoja rreth vetes edhe lëvizjet, edhe zërat e tyre. Nuk di, nga ç'hon i errët, zbriti në qenien time një zë i mekur, i çjerrë: «Pse, nuk e di ti që mua më duhen bujq e jo kalemxhinj?» E pastaj zëra të gjallë: «Lan borxhet... E kemi hedhur në gjol... Njerëzve udha e lirë u duhej... Biografi e hekurt... Kalem i gërryen... U ka hije heroizmi...»

KOMITI TARE BAKIRI

Hazbi agai e kishte lëshuar kalin në revan për-
mes tokave të çiflikut të tij. Kur doli në qafë të një
kodrine të mbuluar nga gjeshtrat plot lule të verdha,
e ndali vrapin e kalit. E derdhi shikimin tutje, nëpër
arat ku ishin shpërndarë bujqit e tij. I mbushi mush-
këritë me ajrin e mermë të pranverës dhe në shpirt
ndjeu një kënaqësi të thellë.

«Eh, të qofsha falë, o zot! Ma ke shtrirë dorën
si birit tënd të vetëm!» mërmëriti me vete. Hazbi agai
i kishte lënë të dyzetepesat, por në pamje nuk tregon-
te as dyzet vjeç. Kishte një trup të ngjeshur e të
zhdërvjellët, që nuk e linte të plakej. Shpeshherë pu-
nonte me bel, me kazmë ose lopatë në kopshtin e
madh e plot pemë, që rrethonte shtëpinë e tij dy-
katëshe. Kur i mërzitej puna, i hipte kalit, hidhte
çiften në krahë, ndillte prapa dy langojtë dhe u ngji-
tej kodrave për gjueti. Ngandonjëherë zbriste në qy-
tet ose shkante te ndonjë mik i tij dhe kalonte andej
dy-tri ditë me dëfrime. Zoti i tij, i madh me të vërtetë,
nuk ia kishte kursyer fatin Hazbi agait. I ati, që kish
vdekur dhjetë vjet më parë, kishte qenë një batakçi
e neqez i madh. Me atë karakter të poshtër ai e ki-
shte shtuar pasurinë dhe, kur po ndahej nga kjo botë,
i kishte thënë të birit, që i rrinte pranë shtratit:

— Dëgjo, bir! Unë po vdes... E ndiej se nuk e kam të gjatë... Ti do të jesh zot i çiflikut tim... Do të jesh zot i gjashtëdhjetë shtëpive të bujqve të mi. Ki kujdes: në këtë botë duhet të jesh gjarpër e shushunjë... Kujdesu edhe për dy motrat e martuara, por ruaju që dhëndurët të mos të futin në kthetra dhe të të rrëmbejnë ndonjë llokmë të çiflikut...

Gani agai, që pas tri-katër orëve do të mbetej pa frymë, i kishte thënë këto fjalë duke u dridhur i tëri. Në fund kishte zgjatur gishtërinjtë, që sëmundja e gjatë e kancerit i kishte lënë koska, kishte mbërthyer të birin për dore, dhe, me sy të çakërritur e me një shikim plot zili të tërbuar, i kishte thënë duke iu marrë fryma:

— Shushunjë e gjarpër në këtë jetë!

Dhe këtë porosi të neveritshme të plakut, Hazbi agai nuk e harroi asnjë ditë. Tashti gëzonte shëndet të plotë, gjallëri të pashtershme e një pasuri të mirë. Ai e urrente lojën e bixhozit, për të vetmen arsye se ajo mund ta hidhte një ditë në buzën e fukarallëkut. Prandaj, sa herë ndodhej në shoqëri me agallarë të tjerë ose me tregtarë nga qyteti, i shmangej ngasjes së bixhozit. Kur vente në qytet, orët më shumë i kalonte në ndonjë kafene ose në shtëpinë publike. Pasioni ndaj grave ishte pika më e dobët e Hazbi agait. Këtë dobësi ia dinin mirë bujqërit e tij e shpesh në mes tyre thoshin: «Hazbi agai, është pusht i madh». E shoqja, zonja Fehime, ishte e kundërta e tij, sidomos në fushën e pasionit. Dikur ajo pat qenë e bukur e plot gjallëri, por lindja e fëmijës së dytë e la me një anemi, prej së cilës nuk e mori dot veten më. Në mes saj dhe të shoqit ishte formuar një përrua i akullt. Zonja Fehime mbyllej brenda. Të vetmen kënaqësi e gjente te e bija, që po rritej e shkathët e tërë trille, dhe te i

biri, që i kishte kaluar të dymbëdhjetat. Hazbi agai harbonte pa pyetur fare se ç'bëhej në shpirtin e gruas. Zaten, edhe atë ai e shikonte si një pjesë të çiflikut të tij....

Pasi shijoi thellë kënaqësinë që i sollën arat e punuara, era e këndshme e ajrit dhe ngrohtësia e diellit të prillit, u ra mamuzeve. Kali i bardhë turfulloi dhe u lëshua nëpër gjeshtirat e dendura. Pas një copë udhe, në mes të gjeshtirave që të kujtonin një jorgan të verdhë, iu shfaq papritur një vajzë. Ishte vajza më e bukur e çiflikut të tij. Për bukurinë e saj kishte dëgjuar të flitej Hazbi agai. I kishte zënë bile veshi edhe një këngë që dikush, ndoshta ndonjë bari malesh, ia pat thurur bukurisë së saj:

Delina e Godo Bakirit
si lastoma e ullirit
të verbon dritat e syrit.

Por rasti nuk ia kishte sjellë agait ta sodiste nga afër fshataren shtatëmbëdhjetvjeçare. E ja, si për çudi, ajo kishte shtangur atje përpara tij. «Edhe bufit që nuk shikon, zoti ia shpie herë pas here një zog në gojë...», kujtoi Hazbi agai fjalët e një përralle të vjetër.

Vajza bëri të lironte rrugën. Hazbi agait ia përshkoi të gjithë trupin një valë e nxehtë dhe në tru iu ngulit një vendim i tërbuar. U hodh nga kali, si të ishte njëzet vjeç, dhe në kohën që vajza u nis të ikte, e mbërtheu për krahu. Ajo u tmerrua. Ai nisi të fliste me rrëmbim e duke e tërhequr pranë vetes:

— Ç'ke kështu, Delina?... Pse u trembe? Unë nuk ha njerëz.... Oh, ç'bukuri të paska falur zoti, si s'të paskam parë!

— Lëshoma dorën, aga... Lërmë të kaloj... Lërmë, se do bërtas! — i tha ajo, e tmerruar.

— Delina pse ma preve udhën, Delina?...

(«Pse ma turbullove ujin ti, qengj?» — pat thënë ujku).

— Mos u tremb, sorkadhe... Më lër të shikoj një çikë bukurinë tënde... Më lër të të puth një herë e pastaj kalo mbi mua... Pusho, mos fol... mos, — iu lut agai duke dihatur.

— Lëshoma dorën! — bërtiti vajza dhe lëshoi një ulurimë, por Hazbi agai e përfshiu për beli, i zuri gojën dhe e ngriti përpara duarve. Egërsia e ujkut nuk do të ishte më e madhe në rrëmbimin e qengjit.

Kali trufulloi dhe ia nguli sytë si me habi të zot, që u fut poshtë në gjeshtat e dendura, me vajzën e lemerisur në duar. Në kohën që agai e lëshoi mbi bargin e dendur, vajza mblodhi të gjitha forcat, rrëshqiti nga kthetrat e tij dhe ia dha vrapit duke uluritur nëpër gjeshtira.

Më tej nga pylli i gjeshtave u dëgjua një zë gruaje: — Kush je ti, moj, që ulërin? Ç'të gjeti?

Por zëri nuk mori përgjigje. Atë zë vajza e tronditur nuk e dëgjoi, kurse Hazbi agai, që ishte bërë si bisha kur i kanë nxjerrë nga thonjtë qengjin, as që e çau kokën për të. Iu afrua kalit, u hodh mbi të si tigër dhe e nisi me revan të tërbuar.

Duke vrapuar nëpër gjeshtira, si të ndiqej nga një qen i tërbuar, Delina zbriti kodrën dhe u gjend në fushë të hapët. Kur u fut në shtëpi, nuk ia fshehu dot s'ëmës tronditjen dhe shqetësimin. Bile, ajo as që kish pasur kohë të mendonte për atë gjë.

Sanije Bakirit, fjalët e së bijës, të thëna me lotë, i derdhën në shpirt një hidhërim të thellë. Mendimi se në një mënyrë a në një tjetër ato do të shkonin në

vesh të djalit të saj të vetëm, e bënte të dridhej nga frika. Ajo kishte dy fëmijë: Delinën dhe Taren njëzet-vjeçar, bari me dhentë e Hazbi agait. Këta dy fëmijë ishin i vetmi gëzim i jetës së saj. Përveç kësaj, e keqja tjetër do të vinte nga krushqit. Një vit e gjysmë më parë e bija ishte fejuar. Në atë kohë ishte gjallë edhe i shoqi, Godo Bakiri. Ishin lidhur Bakirajt me një familje të mirë, të ndershme, familje barinjsh, një mal përtej fshatit të tyre. Mirëpo, sapo të hapeshin fjalët e poshtërimit nga Hazbi agai, krushqit barinj do ta llinin Delinën. Shumë rrallë ndodhte në ato kohëra, në atë krahinë, që një vajze të fejuar t'i dilnin fjalë, dhe krushqia të mos prishej. Si humbi një copë herë të gjatë në mendime të hidhura e në mallkime për Hazbi aganë, i tha së bijës:

— Mbase nuk të ka parë njeri... Do zoti, nuk i ka dëgjuar njeri britmat e tua... Këtë gjë nuk do t'ia tregosh as varrit. Duhet të ruhemi të mos e marrë vesh djali, ndryshe do ta humbasim Taren e vetëm.

Kështu, Sanije Bakiri me të bijën i kalonin orët me zemër të ngrirë e me vesh të ngrehur: a flitej gjë në fshat? Shqetësimi i tyre nuk qe e thënë të shuhej. Pas ca ditësh hijet e së keqes po derdheshin mbi shtëpinë e tyre. «Hazbi agai, ka zënë në Hundën e Verdhë Delinën e bukur të Bakirajve...» thoshin në fshat. E këto fjalë u ngjitën shumë shpejt deri në mal, ku Tare Bakiri, i vëllai i Delinës, ruante me shokë të tjerë kopënë e Hazbi agait.

— Unë isha në Hundë të Keqos, po korrja gjesh-tër, kur dëgjova një ulurimë gruaje. Bërtita kush ishte, por nuk m'u përgjigj njeri. Pas pak, shikoj tèt motër që zbriti nga Hunda e Verdhë me vrap, sikur e ndiqnin qentë. Në atë kohë kaloi dhe agai nëpër gje-

shtra. E ngiste kalin si i tërbuar, — i tregoi gruaja e një bariu Tare Bakirit.

Ai e dëgjoi të shoqen e bariut kokulur e i menduar. Kur ajo mbaroi, ai e ngriti kokën dhe e pa në sy. Iu duk se nga ata sy buronte një shikim pyetës e keqardhës.

— Je e sigurt për këto që më the? — e pyeti.

— Aq sa jam e sigurt që përpara kam të birin e Godo Bakirit, — ia ktheu e shoqja e bariut.

Mbas dite Tare Bakiri zbriti në fshat. Zbriti me ditë, sepse donte të takohej me sa më shumë bashkëfshatarë të tij, që të mund të nxirrte prej tyre një fjalë ose një shikim të dyshimtë. Rasti nuk e solli të takonte nëpër fshat shumë njerëz. Ata pak që takoi i folën natyrshëm, sikur të mos kish ndodhur gjë.

Në shtëpi gjeti të motrën. E ëma kishte zbritur në krua të mbushte bucelën.

Delina s'e duroi dot vështrimin e mprehtë të të vëllait dhe u turbullua.

— Ç'të ka ndodhur përpara dhjetë ditësh, Delina? — e pyeti ai prerë.

Ajo mbeti si e ngrirë. Nuk dinte ç'përgjigje t'i jepte. Sa e ndiente në atë çast nevojën e s'ëmës! Tarja e shikonte me ngulm. Në fytyrën e saj të bukur ndjeu dhembjen e një shqetësimi të thellë.

— S'më ka ndodhur gjë, Tare, — i tha ajo me zë të dredhur.

— Mos më fshih të vërtetën, motër!... Ma thuaj një më një, siç të ka ndodhur. Unë e kam dëgjuar çështjen nga të tjerët... Vetëm ky është gabimi yt: pse nuk më lajmërove menjëherë?

Delina mbeti ngushtë, por e pa se ishte e kotë t'ia fshihte më të vëllait atë që i kishte ngjarë. Dhe ia tregoi të gjitha. Në fund theksoi me bindje:

— Unë i shpëtova nga duart atij maskarai, e shpëtova nderin tim, për këtë mos ki asgjë dyshim, vëlla.

Tare Bakiri ra në mendime. Një ndjenjë urrejtje ia mpiu të gjithë trupin. E pyeti të motrën edhe një herë:

— Nga vije, që kalove në Hundën e Verdhë?

— Të thashë: isha në Sherroj, shpura sitën e miellit.

Ndërkohë Sanije Bakiri shkarkoi bucelën në shkallë dhe u fut në dhomën e djalit. Kishte gati pesëmbëdhjetë ditë pa u takuar me të, prandaj e përqafoi dhe e pyeti për shëndetin.

— Mirë kam qenë, — iu përgjigj ai ftohtë dhe shtoi: — Pse nuk më kini lajmëruar, nënë, për poshtërimin që na ka bërë Hazbi agai?

Sanija shikoi të bijën, por në fytyrën e saj çdo gjë kishte ngrirë.

— E ç'të të thoshim, mor bir! Përse të të lajmëronim? Ç'të mirë do të na sillte kjo?... Delina e shpëtoi nderin e saj dhe tonin.

— Jo, nëno, — e ndërpreu i biri nervoz. — Për nderin tonë, të shtëpisë Bakiri, unë do t'i kërkoj hesap Hazbi agait. Ne jemi në varësi të tij, se jetojmë në çiflikun e tij. Por i kemi dhënë djersën e jo nderin. Njeriu mund të jetojë edhe pa bukë, mund të jetojë me lakrat e barin e maleve, por jo pa nder. Këtë shtëpi nuk e ka pështyrë njeri, e kjo nuk i ka pështyrë kurrë të tjerët. Prandaj këtë pështymë që na ka hedhur Hazbi agai, unë do t'ia kthej në gjak, në qofsha gjallë.

Sanije Bakiri e dinte se i biri nuk i lëshonte ato fjalë në erë. Ai ishte bir i një familjeje që ishte mbajtur në gojë e në këngë për ndershmeri e për trimëri. Thellë në shpirt ndjeu gëzim nga guximi e krenaria e

njeriut të ndershëm. Por ndjeu njëkohësisht edhe frikë deri në dridhje, për pasojat e rënda që mund të sillte guximi për djalin e saj të vetëm. Hazbi agai ishte zot i vendit, i rrethuar nga shokë e miq agallarë. Me aganë ishin ligjet e forca e qeverisë. E kush do ta ndihmonte, kush do ta merrte në mbrojtje djalin e saj të vetëm? Kujtoi këto Sanije Bakiri e iu hodh të birit në qafë me të lutura.

— Të kegen nëna, lëre këtë punë! Mos u ngatërro me aganë... Ai do të të vrasë, ose do paguajë njeri të të vrasë pas krahëve... Do na lësh si qyqe mua dhe tët motër... Biri i nënës, mos na pleks me Hazbi aganë! Ai këto ligësi ka bërë gjithë jetën... lëre, zoti do t'ia bjerë ditën nga ndonjë tjetër!...

— Mos u tremb, nëno, — ia preu i biri fjalën. — Nuk do të mbeteni qyqe... Dhe po mbetët, do mbeteni me nder, e jo të përbuzura. Dita për të larë ligësitë që ka bërë agai nuk vjen me të lutur. Për borxhin tonë do t'ia bie unë ditën, por më duhet njëherë të pregatitem.

Pa u gdhirë mirë, Tare Bakiri zbriti në qytet e nga qyteti, pa u kthyer në shtëpi, u ngjit në mal. Ditët kalonin në rrjedhën e tyre të vjetër. Sanije Bakiri me të bijën prisnin me zemër të ngrirë. Tarja ruante në mal dhentë e agait e hiqej sikur për poshtërimin nuk dinte gjë, ose nuk interesohet fare. Asnjë nga barinjët nuk i hidhte ndonjë fjalë. Vetëm shikimet e tyre fshihnin keqardhjen e një qortim të heshtur.

Në fshat fjalët bëheshin tërkuzë:

— More, pse e shiti dhinë me kec Tarja, ç'hall i shtrëngoi?

— Kush ua di hallin njerëzve, ku u pikon, a derëbardhë! Mos kanë mbetur pa bukë.

— More, Tarja nuk di gjë fare se ç'ka ngjarë. Mbeti në mal me dhen!

— E di që ç'ke me të ai, po ç'do të bëjë? Agai është aga.

— Hë, a derëzi, se dhe aganë e ha plumbi. Një çopë kobure një dhi bën!

— Jo, ore!! Thua ta këtë shitur dhinë për këtë gjë?

— Joo... kot them, xhanëm, ku nuk i shkon mendja njeriut!

— Bakirajt më plumbin janë marrë.

— Delina e shpëtoi nderin, ia la ushkurin në dorë agait.

— Kush e di atë punë, or ti! Veç ata të dy dhe perëndia e dinë.

Delinën e Bakirit e la i fejuari.

Ky lajm u përhap menjëherë në tërë fshatin dhe ishte i vërtetë. Një ditë prej ditësh, në shtëpinë e Bakirajve kishte ardhur lajmësi dhe e kishte njoftuar Sanijen për prishjen e krushqisë. Krushqit kishin dëgjuar se nderin e nuses së tyre e kishte marrë Hazbi agai.

Sanije Bakiri e thirri të birin në shtëpi dhe i tregoi prishjen e krushqisë. Tarja e dëgjoi t'ëmën i heshtur e i menduar. Urrejtja për Hazbi aganë po rrokulliste gurë në shpirtin e tij.

— Si ta shtroi lajmësi arsyen e prishjes së krushqisë? — e pyeti t'ëmën.

— Në fillim e solli rrotull fjalën, pastaj më tha se nëpër gojë të njerëzve ka dalë fjala për përdhunimin nga Hazbi agai. Unë ia tregova se si qëndron puna në të vërtetë, por ai më tha se ata, krushqit, i kishin

thënë që, me gjithë respektin që kanë për ne, me gjithë kujtimin e mirë që ruanin për Godon, nuk mund të marrin një nuse me fjalë të tilla.

Tare Bakiri mbushi gjoksin me ajër, shfryu gjatë dhe i tha s'ëmës, si të fliste me vete:

— Mirë, nënë... Ngjarjet po rrokullisen vetë për keq e mua më kujtojnë dyfekun... Të bëhet si të jetë thënë. Nesër nuk do ngjitem në mal.

— Ç'ke ndër mend të bësh, biri i nënës? — i tha ajo me zë të dredhur.

— Do t'u tregoj njerëzve se shtëpia e Bakirajve ka akoma zot për të ruajtur nderin e saj. Hazbi agait do tia kërkoj borxhin në gjak. Që ditën që e mora vesh poshtërimin që na bëri, unë jam përgatitur, nënë, për t'i dalë në krye qëllimit tim.

— E ëma po ia mbante dorën e rëndë në duart e saja të flashkura nga puna. Si u mendua një çast, i tha:

— Ç'të të them, o bir! Të të them të heshtësh, ta lësh këtë punë në heshtje e të të kemi ty shëndoshë, zemra ma do, por edhe turpin që na ra mbi shtëpi nuk mund ta përtyp dot. Lënia e vjazës nga i fejuari e mahisi plagën edhe më shumë... Bëj si ta shikosh të udhës, të keqen nëna... por... me mend në kokë... Jo të humbasësh edhe jetën tënde, e Hazbi agai të kapardiset mbi kalë. Ki mendjen se ai nuk është pa mend, që të mos ruhet fare.


— Nëno, unë nuk kam ç'pres më. Do t'i zë pusinë Hazbi agait. Dua ta vras në ballë e jo pas krahëve. Dua të më shikojë kur ta qëlloj. Sido që të ndodhë, unë dua që ti të jesh trimëreshë. Këto ditë bashkë me Delinën shkoni në Sinoricë, te vëllezërit e tu. Për mua mos kini asnjë merak, se atje do t'ju gjej.

Sanije Bakri kishte kaluar një jetë të vështirë. E kishte lodhur jeta. E tashti, që priste ndonjë ditë gëzimi, të martonte djalin e të gëzohej me nuse, po bisedonte me të birin për të nesërmen, që mund të vinte plot halle të tjera, bile edhe me humbjen e të vetmit gëzim të saj. Kishte mbështetur kokën në supin e të birit, e, duke nuhatur me etje erën e trupit të tij, nuk i mbajti dot dy pika lot që iu rrokullisën faqeve të thara e humbën në buzën e mjekrës.

— Nuk e di, or bir... nuk e di ç'të them... ç'ditë do të na sjellë fati! — tha me zë të mekur.

— Mbaju e fortë, nëno!.. Unë i nisem një rrugë të ndershme, s'ka pse fati të mos jetë me mua, — i tha ai dhe i puthi dorën.

Lajmin e ndarjes nga i fejuari, Delina e priti me dhembje. Fjalët e s'ëmës i ranë si një ngacmim ashkle në plagën e mahisur. Kjo nuk ishte dhembje dashurie. Jo. Në shpirtin e saj, muaj me radhë, ishte vërtitur si nëpër mjegull një ndjenjë gëzimi, krenarie se ishte e fejuar, se diku, përtej një mali, një njeri mendonte për të, quhej i fejuari i saj e nesër do të bëhej shoku i jetës. Këto mendime ia përkëdhelte një ndjenjë e vagëlluar, kur ajo sillte përpara syve fytyrën e të fejuarit, që e kishte parë vetëm një herë. Por të gjitha këto përbënin vetëm një pjesë të vogël të helmit që i mbushi shpirtin tani. Pjesën më të madhe ia derdhi aty prekja e rëndë e dinjitetit. Si do t'i duronte shikimet e njerëzve? Si do t'u thoshte shoqëve kur ta pyesninin me keqardhje në burim ose në arë? Si do ta duronte ironinë e atyre që e kishin aq shumë zili bukurinë e saj? Me këtë dhembje në zemër i shkoi në dhomë të vëllait.



Tare Bakiri e kishte humbur mendjen në pjesët e një kobureje të zbërthyer, që i kishte vendosur mbi një shami përpara gjunjëve. Ngriti kokën dhe e pyeti të motrën, që i ishte futur në dhomë befas.

— Ç'ke Delina?

— Kisha një fjalë me ty, — i tha ajo, si e zënë në faj!

— Po, mirë, hajde.

Ajo i shkoi pranë dhe, si i mbështeti dorën në sup, i tha:

— Tare, unë nuk mund të jetoj dot në këtë gjendje... Nuk mund ta duroj poshtërimin që më solli Hazbi agai... Të keqen motra, ndihmomë! Më jep armë... më mëso si qëllohet... dhe unë do ta vras aganë.

Delina i lutej të vëllait duke iu dridhur buza, por në ato që thoshte kishte besim të plotë. I vëllai e shikonte në sy, e në shpirt ndiente dhembje e krenari. Si u mendua një çast, i tha:

— Kaq e lehtë, të duket ty vrasja e Hazbi agait?

— Më mëso koburen e do të shikosh ç'do të bëj. Do ta duroj edhe një të qeshurën e pështirë të agait, sa të më afrohet e t'ia derdh plumbat në gojë.

Tare Bakiri nuk e kishte besuar kurrë se nga sytë aq të bukur të së motrës, në atë fytyrë aq të ëmbël, mund të shkrepse një urrejtje aq e papërmbajtur. Guximi i saj e mbushi me besim për sigurinë e vendimit që kishte marrë. Dhe, pa ia shqitur sytë hetues së motrës, i tha:

— Mos u nxito, Delina. Mos u mërzhit për këtë punë. Ti ke vëlla gjallë.

— Tare, t'u bëftë motra, jo ti! Ty të kemi të vetëm! Ti na lë të shkreta mua dhe nënën. Unë dua që agai të ma paguajë mua poshtërimin që më bëri. Unë do...

— Mirë, mirë, mos ki keq. Qetësohu, do të menjohet unë për këtë punë. Në qoftë se do që ta shohësh me sy aganë duke na larë borxhin, të marr unë me vete. Ik tani e fli e qetë, — i tha ai dhe i lëmoi gërshetat e zeza që i derdheshin supeve.

Delina u ngrit e doli nga dhoma e të vëllait me shpirt të lehtësuar. Kurse ai nisi të mbërthente koburen e pastruar me kujdes të rrallë.

Fjalët që qarkullonin nëpër fshat për familjen Bakiri, nuk mbetën pa i rënë në vesh edhe Hazbi agait. Një mbrëmje, agai kishte thirrur qehajanë e tij, që t'i jepte shpjegime rreth punëve të pranverës në çiflig. Ishte një mbrëmje e ngrohtë maji. Ata ishin ulur në verandë dhe po bisedonin shtruar, duke pirë raki. Qehajai i fliste të zotit me zell për punët e mira që ishin bërë e do të bëheshin. Punët shkonin përbukuri. Agai ndihej i kënaqur. Qehajai i tij, Velo Aliu, herë pas here, e shpinte fjalën te përpjekjet e tij, duke e siguruar të zotin se sa të kishte qehaja Velon, të mos e mbante kokën prapa, ngado që të ish e kudo që t'i shkruhej të shkonte. Veloja, në biseda me aganë, përfitonte edhe nga afërsia si kushëri i tij i parë, si dhe nga moshë e shkuar.

Disa vjet më parë, kur i ati i Hazbiut ishte gjallë, Veloja jetonte me pronën e vet. Në buzë të lûmit që kalon në fund të fshatit Zallkusar, Veloja kishte një arë të madhe. Kjo ishte e vetmja tokë që kishte mbetur jashtë gardhit të çiflikut të Gani agait. Ara e Velos ishte njëkohësisht edhe më pjellorja në fshat. Sa herë që Gani agai kalonte aty pari, e shikonte me zili misrin osë grurin e harlisur në arën e të nipit.

Një ditë, Gani agai, në muhabet e sipër, ia pat

kërkuar Velos arën. I pat thënë ta ndërronte me një arë zallishte, me një kopsht pemësh dhe dymbëdhjetë napolona flori. Mirëpo Veloja nuk ishte dhënë. Zilia iu shtua Gani agait, e, me kalimin e kohës, me shumë kujdes e zemërgjerësi, e fuste në borxhe të nipin. Borxhi u trash kur Velo Aliu martoi të birin. Bëri dasmë të madhe Veloja, e tundi dynjanë, siç thoshin fshati. Gëzimi nuk e la të kujtohej, se huaja që i mori xhaxhait ishte e rëndë për koskën e tij. Nejse, djali u trashëgua, por koha kalonte e një ditë Gani agai e thirri të nipin e i kërkoi borxhin. Të nipit iu tha pëshlytyma në fyt. S'kish nga t'ia mbante dhe u detyrua të pranonte kushtet e të ungjit.

Pasi humbi arën e lumit, Velo Aliu iu vu më shumë rakisë. Për arën zallishte nuk derdhi djersë. Ra edhe më poshtë ekonomikisht, e një ditë, kur e pa keq, i nderi përsëri dorën xhaxhait «zemërmirë» dhe u bë qehaja i tij.

Këto ngjarje sepse iu fanitën rrëmbimthi përpara syve qehajait Velo Aliu tani që po pinte raki në verandën e Hazbi agait, kushëririt dhe zotit të tij. Pasi i largoi këto kujtime, i tha të zot me atë konfidencë që e përdorte rrallë:

— Ca llafe të dyshimta hidhen e priten nëpër fshat, kushëri.

— Ç'janë këto llafe, more Velo? — e pyeti Hazbi agai, duke ia ngulur sytë.

Qehajai e nuhati interesimin e të zot.

— Poo.. ku di unë se nga dreqin dalin!... Flasin sikur ti paske zënë Delinën e Bakirajve në gjeshtira, në Hundën e Verdhë.

— Kush e ka nxjerrë fjalën? — pyeti rrëmbyer agai.

— Nuk e di, për zotin e vërtetë, por që e ka marrë

dhenë, e ka marrë. Vajzën e Bakirajve e la i fejuari nga Sheromina. Bile fjala ka dalë sikur Tare Bakiri do të kërkojë kokë për poshtërimin.

Hazbi agai rrinte i mbështetur në shpinën e karriges me shikimin mbërthyer në fytyrën e qehajait. Mundohej të mbante krenarinë si zot absolut i fshatit Zallkusar. Qehajai dinak ia lexoi në sy hijen e shqetësimit që i sollën fjalët e tij kushëririt fodull.

Papritur, Hazbi agai qeshi me zë të tërë ironi. Ngriti gotën dhe i tha qehajait:

— Hajde ta kthejmë, kushëri. Të paça shëndoshë! ...Më the se punët shkojnë mirë, por, me sa duket, njerëzit nuk punojnë aq sa duhet, përdërisa kanë kohë të merren me llafe. Hajde, gëzuar!

— Gëzuar, aga! — ia ktheu Veloja pa ia hequr sytë. Qehajai kërkonte të zbulonte se ç'mendime fshiheshin në fjalët e të zotit.

Kur Veloja u nda me të dhe po zbriste shkallët, agai e kujtoi dhe një herë që lart:

— Pa shikoji me kujdes këto fjalë që fliten. Pa shtrëngoju pak më tej rripat. Mos i lër të harrojnë se agai ua mbush barkun me bukë e, po ta dojë puna, ua pret fare edhe bukën...

— Zoti të dhëntë shëndet, kushëri! Mos ki merak, se i ndreq unë, — iu përgjegj që poshtë qehajai.

Si mbeti vetëm, Hazbi agai ngriti një gotë dhe e shkundi në gurmaz. U mbështet në karrigen prej kashte dhe e treti shikimin tej në majat e maleve, që ishin akoma me diell. Mbi çiflikun e tij po binte muzgu. Fjalët e qehajait i kishin ngulur një shigjetë qetësisë së tij. Padashur nisi të shikonte në shpirtin e vet. Gjatë viteve të pjekurisë ai e kishte ndier veten zot të fshatit Zallkusar. Asnjëherë nuk kishte menduar se zemra e tij një ditë mund të tre-

mbej. Për vite me radhë familja e tij kishte qenë zot i atij fshati. Rrënjën e agallëkut të familjes e pat mbjellë Zaçe agai, i ati i Gani agait, pra, gjyshi i Hazbiut. Ai, Zaça, ishte futur në shërbim të push-tuesve turq, dhe ata, për shpërblim, e kishin caktuar aga të fshatit, me të drejta qeverimi mbi të. Vitet ecën dhe ja, tashti, pushtetin mbi fshatin e kishte në duar Hazbi agai. Në kohën e tij nuk kishte më turq, por ai e kishte pranë ndihmën e qeverisë së mbretit Zog. Kjo siguri nuk e kishte lënë të dyshonte se një ditë mund t'i shkisnin gurët nën këmbë. Po atëherë ç'ishte kjo drejt frike që po e kruante diku thellë në shpirt, tek rrinte vetëm në verandë?

«Thonë se Tare Bakiri do të kërkojë kokë për postërimin» i erdhën prapë në tru fjalët e qehajit.

«Hëm!... Kulishi i Bakirajve do të kërkojë gjak të unë?!»

Sulmi mbi Delinën nuk ishte aventura e parë e Hazbi agait. Kishte pasur raste të tjera, por ja që njerëzit, ca nga frika, ca nga hallet, nuk i kishin nxjerrë fjalë. Urrejtja, fjalët e hidhërimit ishin shkrirë bashkë me vitet e varfërisë.

«Kushedi ç'mund të ketë ndër mend çunaku! Do parë kjo punë. Këta Bakirajt i ka hequr plumbi», mendoi me vete Hazbi agai dhe fare instinktivisht shpuri dorën mbi një pistoletë «Parabel», të ngjeshur në gërbën e majtë.

Nja dy ditë pas bisedës që kishte pasur me Velo Alinë, Hazbi agai po kthehej me kalë nga fshati Shërominë. Kishte qenë atje për të lidhur fjalë me një mik për blerjen e një kullote verorë. Puna i kishte shkuar mbarë, dhe ai po kthehej me qejf në Zallkular. Kur iu afrua fshatit, e ndaloi revanin e kalit të bardhë dhe e la të ecte më nge.

Dielli po zbriste në perëndim. Hijet e kodrave e kishin zënë gjysmën e fshatit. Hazbi agai qëllonte lehtë-lehtë lëkurën e çizmeve të verdha me një shufër të hollë thane. Mushkëritë e tij të shëndetshme thithnin ajër të pastër, të mbushur me aromë lulësh, e s'gjenin të ngopur. I kishte lezet jeta. Ecte agai e vërshëllente me vete. Mirëpo, në kohën që kali u fut poshtë degëve të rënda të një lisi të tharë përgjysmë nga vetëtimat, një zë e bëri të dridhej e të dilte nga mendimet e këndshme që i gëlonin në kokë.

— Bëni të fala tyt eti në atë botë, Hazbi agai!

Agai ngriti kokën dhe pa mbi shpatullën e një dege që shtrihej mbi rrugë Tare Bakirin, me kobure drejtuar nga ai. Me shpejtësi të rrallë e nxori koburen nga brezi, por Tare Bakiri shtiu i pari. Hazbi agai pati kohë të dëgjonte dy të shtëna, të ndiente një dhimbje therëse në qafë dhe t'i përgjigjej kundërshtarit me një krismë. Plumbi i tij goditi në shpatull të lisit. Sytë iu errësuan. U shkëput nga shala e kalit, rrëshqiti mbi zverkun e tij e, si i la në lelet e bardha një njollë gjaku, ra përpara mbi një thirimi plot kokrra të pabëra. Dhembja i theri në zemër, por koburen nuk e lëshoi nga dora. E mblodhi gishtin në këmbëzë dhe i derdhi kot edhe katër plumba. Atje i mbaroi fuqia. Zemra e shëndetshme nuk pati më forcë t'i dërgonte gjak dorës. Ndërkohë Tare Bakiri u hodh nga kosherja e lisit, i vajti pranë dhe i tha me urrejtje të pamatur:

— Kështu përdhunohet Delina e Bakirajve, Hazbi aga!

Kali i bardhë, ashtu i përgjakur, mori vrapin drejt fshatit me hingëllima. Tare Bakiri iu ngjit kodrës që ngrihej si vetull mbi fshatin Zallkusar. Në krye të kodrës u gjend ballë për ballë me një bari

bashkëfshatar të tij. Tarja e kishte akoma në dorë koburen. Bariu ishte mbështetur mbi kërrabë. E kish parë ngjarjen që aty ku ishte.

— E vrave aganë? — e pyeti bariu si i hutuar.

— Po. Ua hoqa qafe.

— Mirë bëre... Njeriu për një nder rron... Por do të të djegin me gjithë shtëpi, o i mjerë, do ta pataksin gjithë fshatin.

— Le ta djegin shtëpinë, aty e kanë. Nëna dhe motra kanë ikur që pardje nga fshati. Me fshatin s'kanë punë. Ik e thuaju se aganë e vrava unë. Qofsh mirë, Nezir! — i tha shokut të tij bari dhe humbi në për pyll.

— Hajde, të ndih të zoti! — i tha bariu i menduar.

Kali i bardhë, i përgjakur, qe lajmi i parë në fshat për vrasjen e Hazbi agait. Njerëzit ndoqën udhën e kalit dhe e gjetën aganë të larë në gjak nga mesi e lart. Velo Aliu erdhi me një frymë pranë agait të vdekur. Çirrej, bërtiste e mallëkonte Veloja. Pastaj urdhëroi të pregatisnin një vig.

Katër-pesë fshatarë e pregatitën vigun shpejt e shpejt. Qehajai jepte urdhra, ata i bindeshin në heshtje. Velo Aliu e ndjeu për herë të parë se në fshatin Zallkusar tani e tutje do të bëhej ai i parë. I nipi, i biri i Hazbi agait, ishte vetëm dymbëdhjetë vjeç. U shkëput nga ato mendime, që duheshin rrahur hollë, i vuri supin vigut, ku shtrinë të kushërinë aga dhe u nis drejt fshatit.

Disa fshatarë, që Velo Aliu i kishte vënë në ndjek të Tare Bakirit, vinin vërdallë nëpër kodra, sa për të thënë që kërkuan e s'gjetën gjë. Fshati Zallkusar priste në rrëmujë aganë e vrarë. «Tare Bakiri e vrau aganë» «Ju kam thënë unë se edhe aganë e ha plumbi, veç duhet ngritur pushka», bisedonin me zë të ulët njerëzit.

Në shtëpinë e agait që ngritur ulërima. Lajmi i vdekjes së tij shkoi me të shpejtë në prefekturë. Mbi fusha, kodra e male, kishte rënë nata. Ishte një natë e kthjellët, me yje të rralla, të ndezura.

Tare Bakiri ishte ngjitur në malin e Sheronimës. Ishte ulur në buzën e një shkëmbi. Dëgjonte zërin e çjerrë të bulkthit, një krakërimë shpendi diku në fole a një shushërimë në pyll dhe mendohej. Mendohej për ditët që do të vinin, për motrën dhe nënën e tij, që i kishte dërguar larg te dajallarët. Ajo ishte nata e parë që do të fillonte jetën e maleve. Pas një copë here të gjatë, në fshatin Zallkusar u ngrit një shtëllungë tymi e përzier në flakë. Ai e kuptoi se ç'bëhej. Po digjej shtëpia e tij. Xhandarët kishin mbërritur në Zallkusar dhe i kishin djegur shtëpinë. Ishte masa e parë që morën për Tare Bakirin. Do të vinin ditët tjera, bile edhe vite, dhe emri i tij do të shkruhej në urdhëresa qeveritare. Ai do të quhej «komiti Tare Bakiri» do të dënohej me burg e me vdekje dhe do t'u fuste tmerrin xhandarëve e bejlerëve. E do të mbetej bir i njerëzve të thjeshtë, që do ta fshihnin, do ta strehonin e do ta ndanin me të bukën e fëmijëve. Ai do t'i nxiste të ngriheshin me guxim kundër shtypjes e do t'u bëhej krah në raste hallesh. Kështu qëndroi vite me radhë me shqipet e malit Tare Bakiri, derisa aty u ngjiten partizanët e lirisë, e ai u bashkua me ta. Dhe atëherë nisi të luftonte më me trimëri, por jo për të hequr qafe një aga, por për të sjellë lirinë e për të bërë që agallarët të binin nga kali. !.

DUKE KTHYER KOKËN MBRAPA

U njoha me të në shtëpinë e kulturës të qytetit. E gjeta në sallën e lojërave, tek lozte shah me një minator të ri në moshë. Pasi lëvizi dhe dy-tre gurët e fundit, u ngrit:

— E mundët! — i thashë me buzë në gaz.

— E nxita... e nxita të luftojë më mirë nesër e të më mundë, — ma ktheu i qeshur e duke më shikuar me ngulm.

— Në mos gabohem, ju jeni Feti Abazi?

— Unë i tëri, — ma ktheu pa m'i hequr sytë.

Kur po dilnim nga salla e lojërave, më pyeti:

— Mos vini gjë nga gazeta?

— Po.

— E kush ju solli te unë?

— Pyeta një shok te derë e klubit. Më thanë se ju jeni veteran i kësaj miniere dhe, si ju, s'e di askush historinë e saj. Ato që do të më thoni ju, do të më vlejné shumë për shkrimin që do të bëj.

— Mirë të kanë thënë, mor shok, — ma ktheu Feti me buzë në gaz. — Unë gjysmën e jetës këtu, në këtë minierë, e kam shkuar. Edhe për atë shkrimin mirë do bësh, se këto kohët e fundit na ndodhën ca gjëra jo të mira. Por i rregulluam paq, i vumë në vijë punët tani!..

Zbritëm pesë-gjashtë shkallët e klubit të kulturës. E ftova të bënim një shëtitje dhe të vazhdonim bisedën.

— Jo. Më mirë zbresim në shtëpi. Ja, ku e kemi përpara, ai ballkoni i gjerë. Dhe plaka po u hedh ujë luleve. Është meraklie e madhe për lulet.

Ecim ngadalë e bisedojmë. Ndodh shpesh që edhe në mes dy njerëzve të porsanjohur lind një komunikim i brendshëm. Nga fjalët, nga sytë, nga gjestet buron singëritet, mirësi. Kështu më ndodhi dhe mua me Feti Abazin. Te porta e shtëpisë na priti e shoqja, një grua e shkurtër, rreth të pesëdhjetave, e shëndetshme, e thinjur. U ulëm në kuzhinë e ia shtrëngova dorën edhe një herë Fetiut. Ia shtrëngova për ato mirësi që më zuri syri në shtëpinë e tij.

— Nazo, përpara kafesë na bjer nga një raki, — i tha së shoqes Feti.

E shoqja na solli rakitë.

— Epo, gëzuar e mirë se erdhe! Shëndet e pena pas mendjes! — më thotë i qeshur i zoti i shtëpisë dhe ngre gotën.

Fetiu u ngjitet tashti të gjashtëdhjetave. Ka një trup të mbajtur, të fortë. Bisedën e shoqëron me lëvizje të lehta të duarve, të trupit, të fytyrës. Në çdo fjalë të tij ka një mendim të prerë, të hapët, të sinqertë. Flet e të shikon në sy. Kur unë largoj shikimin, ai ndërpret bisedën. E ndiej se kam të bëj me një njeri tepër korrekt.

Ai më shpreh disa mendime. Unë miratoj me këmbë e i them: «Ashtu, ashtu». Ai përziën vetullat, pircërron sytë e, pasi mendohet pak, më thotë:

— Mos më thuaj «Ashtu, ashtu», të lutem. S'ka si të jenë këto që them unë «ashtu» edhe për ty. Në gjithë këto fjalë çoj do të ketë që nuk shkon. Se, të

kam rixha, fol unë e ti thuaj «ashtu», fol ti dhe unë «ashtu», mbyllet muhabeti dhe ndahemi nga njëri-tjetri. Ç'u kuptua, ç'gjë të keqe më korrigjove ti mua apo unë ty?

Ndaloi një hop, ndezi një cigare e, pasi më shikoi drejt në sy, më tha:

— Mos ma merr për keq. Unë kështu e kam. Nuk mund të rri pa e thënë atë që mendoj e që më duket e drejtë. Më duket sikur ai tjetri do të ma këndojë mendimin në ballë. Mendimin, po e mbajte brenda, sëmur veten, sëmur edhe tjetrin. Kështu ndodh të dëgjojmë tjetrin që flet ose diskuton, nuk jemi në një mendje me të dhe nuk ia themi «Hë, mo, ç't'ia prishim?» mendojmë. Mirëpo kjo nuk është prishje. Mendimi duhet rrahur midis shokësh, se atëherë del për të qenë.

E falënderoia për vërejtjen dhe e pyeta për kuptimin e atij urimit që më bëri në fillim: «pena pas mendjes».

— E keni ndonjë fjalë të kësaj zone? — i thashë.


— Jo, po mua më duket se çdo gjë e thënë ose e bërë para mendjes, është e kotë, e keqe. Prandaj të urova që pena të të shkojë pas mendimit të pjekur, — ma ktheu duke më shikuar në sy.

Ndalon, mendohet një çast, duke lëvizur lehtë tavllën e cigares, e shton:

— Fjala është puna më e mirë që kanë bërë njerëzit për t'u lidhur, por, ama, kur fjala nuk thuhet drejt, prerë e për të mirë, ajo e prish njeriun. Ky mendim më është ngulitur qëkur erdha këtu, në minierë, qysh në kohën që miniera u bë jona. Jam përpjekur që fjalën ta them copë, ashtu siç ka qenë puna. Nga kjo më kanë dashur njerëzit, por jo të gjithë, bile ngandonjëherë kam përballuar dhe telashe. Ja,

kështu ndodhi edhe në atë mbledhjen e djeshme kundër burokratizmit, për të cilën ju njoftuam në gazetë. Më kërkove të të flas për përshtypjet e mia si minator i vjetër. Do të flas për çdo gjë që na duhet, por do të më falësh, se do ta filloj njëherë nga e vjetra:

Për herë të parë në këtë vend kam ardhur në ato kohë që jeta e njeriut ishte më e zezë se qymyri. Erdha me një kushëririn tim. Në atë kohë këtu ishin hapur një tri-katër galeri. Bëhej një punë për të qarë hallin. Unë e kushëririn im punonim vetëm, përtej kodrës, në një galeri një pesë-gjashtë metra të thellë. E nxirrnim me dhëmbë atë të shkretë qymyr, e ngarkonim në dy mushkat tona dhe e nxirrnim në xhade, ku e merrnin makinat. Punë e ibret, ç'pyet! Flinim në një kasolle fshatari. Pasi bëmë nga një lekë, vendosëm të shkonim një herë te fëmijët. Tri ditë duhe-shin të shkoje me kafshë. Një ditë përpara se të niseshim, ndodhi një fatkeqësi që nuk do ta harroj deri në buzë të varrit. Unë po arnoja pantallonat, që të mos veja me gjunjë zbuluar në shtëpi, kushëririn po gërryente qymyr brenda. Fare papritur ndodhi një shembje dhe u dëgjua një britmë e mbytur. Ç'ngjau? Galeria ra dhe e zuri brenda tim kushëri. Mushka e tij, që priste te dera për t'u ngarkuar, hingëlliti. E ore, për fjalë të nderit, çudi e madhé! Sikur ta ndiente edhe ajo gjëmën që ndodhi! Ç'të bëja? Kushëririn, shoku i halleve, po vdiste atje nën peshën e dheut. Rrëmbeva kazmën dhe nisa të gërmoja si i çmendur. Po ç'do të bëja? Hiqej gjithë ai dhe? Priste fryma e atij që kish mbetur brenda? Mbahej ajo peshë? S'kaloi pak dhe nga dheu doli një si rënkim i çjerrë, që s'ido të më harrohet kurrë. Ajo ishte gërhimja e tij e fundit, pasi më vonë nuk pipëtiu më. Eh, ç'nuk shikon i ziu njeri në jetë! Shoku me të cilin pak



minuta më parë pija duhan e qaja halle, nuk ishte më i gjallë. Ai shpëtoi nga vuajtjet, por vdiq hidhur. Gruaja, dy pleq e një fëmijë prisnin prej tij bukën e gojës, kurse ai vdiq aty në qymyr, pa i parë me sy. I shkreti Bedo! E lashë kazmën dhe vajta të kërkoja ndihmën e pronarit të minierës. E gjeta përpara vilës së tij. Ishte ulur në një karrige prej kashte dhe lozte me një lingua të larmë. I tregova për Bedon. Ai herë më shikonte mua, herë qenin, që i llastohej te këmbët. Pasi më peshoi njëherë me sy, më tha: «E ç'kërkon nga unë? Të paguaj punëtorë të heqin gjithë atë dhé? Mos të duket se unë i pres paratë me gërshërë? Hëm... Pastaj, përse ta nxjerrësh? Nuk është edhe atje toka e zotit? Ç'të bësh! Aty ia pat caktuar fati fundin. Ç'e do? Të shkosh në fshatin tuaj do katër ditë me kalë».

— Të paktën t'i jepnit ndonjë ndihmë, zotni, i ka fëmijët pa bukë!

— Keq më vjen, po ku t'i gjej paratë? Pak se m'u mbyll tashti dhe një galeri, që kushedi sa kam harxhuar për të!

— Ne ju kishim thënë se duhej veshur me dru.

— Unë do ta vishja? Ta vishnit, po të donit këkën, pyllin aty e kishit.

Çudi e madhe! Të sillet kështu njeriu me njerinë! Ia kish zënë sytë kamja. Është gjë e mirë që njeriu të ketë, të jetojë mirë, ta bëjë sa më të mirë të shkretën jetë, që një herë jepet, por, ama, kur pasuria, kur mjetet për të jetuar nuk janë të ndara drejt për të gjithë njerëzit, atëherë ai që ka bëhet ujk për atë që ka vetëm shpatullat. I tillë ishte edhe ai pronari i minierës. Kështu që ta pata fjalën.

Ishte e kotë. Ika prapë te galeria, ku mbeti Bedoja. Iu vura punës. Më ndihmuan edhe dy-tre vetë

që e njihnin Bedon. . . I shkreti Bedo, ishte tip i hedhur! Menjëherë, sa erdhëm në minierë, zuri të njohur. Çoç bisedonte me punëtorët dhe i shtynte të ngriheshin kundër pronarit të minierës.

Të tretën ditë e nxorëm nga dheu. Mbi fytyrë i ishte nderë vuajtja e gjithë jetës. I ndenja pranë e lëshova lot mbi të. M'u duk sikur dëgjova prapë fjalët që më kish thënë një natë kur po mbartnim qymyr nëpër shi. Pronari zbriste nga pylli, kish qenë për gjueti, siç dukej. Rrugës kish gjetur ca kokrra qymyri, që kishin rënë nga mushkat. Na mori erzin. Na ndaloi nga rroga edhe nga një gjysmë leku.

— E more, Feti, durohet ky turp? — më thotë Bedoja. — Do ngritur t'i thyejmë turinjtë ndonjë ditë këtu në mes të pyllit!

— Ç'do të fitosh, o Bedoziu? — i thashë. — Se mos është vetëm ky e hajde, hallall dhe plumbi që do të marrësh!

— Epo, dhe të jetosh kështu në këtë botë të egër është e kotë, — më tha.

Në xhep i gjetëm ato pak lekë që kish mbledhur për shtëpi. E morëm dhe e varrosëm tutje galerisë. Të nesërmen u nisa për në fshat. Si më shpunë këmbët, si e shpura në shtëpi gjëmën e Bedos! . . . Njeriu qenka i fortë. Për mua nisën mundime të tjera, pasi e mora në kujdesin tim edhe familjen e Bedos. Nja dy a tre vjet pas Çlirimit u ngrita dhe erdha përsëri këtu. Miniera ishte tani e popullit, në qendër po ngriheshin ndërtesa të reja. Fillova punën. I vështirë ishte fillimi, por punonim me shpirt. E dinim tani përse punonim e, kur njeriu di pse lufton e pse punon, nuk mbahet. Ja, tashti, pas njëzet e ca vjetëve në minierë, jam me shtëpi të re, me fëmijë të rritur, me djalin inxhinier. Këtu ku dje ishin dy a tri baraka të zeza,

sot është një qytet i tërë. Atje ku mbeti i shkreti Bedo, sot nuk njihet vendi. T'i tregoj këto gjëra, more bir, se njeriu, duke ecur përpara, duhet të kthejë kokën mbrapa, ta shikojë mirë jetën, të kuptojë se ç'është bërë nga hiçi e si është bërë. Ato kujtime të dhembura nuk i kam harruar asnjëherë. Prandaj dhe e duam kaq shumë jetën që bëjmë tani, punën, të gjitha. Ja, të them edhe diçka tjetër: Kur më thanë se do të më bënin brigadier, unë u thashë: «Le të jem brigadier, meqë menduaki ju, por këtu në prodhim, të bëj normën time». E pse jo? Në kohën e pronarit punonim për një copë bukë, i ziu Bedo la koskat atëherë, kurse mua të më rëndohej puna në galeri, se më zgjidhnin brigadier! Jo, or bir, jo! Kur u pranova në Parti, kur u dekorova dhe vetë presidenti më puthi si mik të vjetër, ai i gjori Bedo më erdhi në mendje. M'u fut në sallë të mbledhjes e m'u duk sikur më tha: More Feti vëllai, ku qenke ngjitur, mor ditëbardhë!». Ee, kështu... Kjo më bën që edhe të grindem me njerëz që i rrinë mënjanë punës, me ca që, bashkë me dheun, hedhin poshtë edhe copa qymyri. Këta nuk ia dinë dhembjen e djeshme qymyrit. Sot, në galeritë tona, futu po deshe dhe me kostum e s'të bie sipër një copë dhé. Po si u bënë këto?

Kam katër vjet që kam dalë në pension, jo se më lanë forcat por zbatova ligjin. Forcat nuk më kanë lënë, prandaj edhe sot e këtë ditë nuk jam ndarë nga galeritë. Çdo ditë kaloj nëpër to tri-katër orë. Ka mikrobën e saj dhe puna e minatorit, ore! Për fjalë të nderit, të them, më dhemb zemra kur shikoj që më ndonjë rast punët nuk shkojnë mirë. Kur shoh se qymyri që del me gjak e djersë lihet nëpër rrugë. Këto kohët e fundit punët nuk kanë ecur si duhet. Gjithë puna është te gripi i rehatit. Po, po! Disa drejtues i

ka mbërthyer rehati, e mikrobi i rehatit është më i fortë se ai i gripit. Sesi e frynë sektorin dhe e bënë kantier. Përgjegjësi i sektorit u ngjit më lart, jo vetëm si shkallë, por edhe në pará. Kuptohet, merr më shumë. Pa nisi të kërkojë edhe një makinë. Helbete, drejtor! Në kantier u hapën krahë e degë të reja. Degë furnizimi, kontrolli, cilësie, degë, degë... ç'të të them, si degët e lisit! «Duhet forcuar administrimi, se ka ngarkesë detyrash», thonë. Tashti secili e heq veten kaposh në degën e tij. Kështu u fut burokracia edhe këtu, që prodhimi del me djersë e gjak.

Mirëpo, të këqijat këtu në minierë nuk e kanë jetën të gjatë. Minatori nuk ta përton shumë. Ai të flet nga balli i galerisë, nga zemra e dheut, siç i thonë këtu. Kështu ndodhi përpara dy javësh. Minatorët vunë te klubi i kulturës një fletërrufe. Ngritën çështjen e ndezjes së qymyrit dhe të shpërdorimeve të tjera. U ngritën kundër sorollatjeve, goditën burokracinë që po krijohet në kantier. Grupi i kontrollit punëtor, që u krijua menjëherë, iu vu punës, mbështeti kritikën e minatorëve dhe doli me masa konkrete.

Në mbledhjen e administratës me grupin e kontrollit u ndez flaka. Përgjegjësi i kantierit u ngrit e foli i pari. Pasi lëndoi me marifet kontrollin punëtor, tha: «Epo, t'i hedhim në votë propozimet. Mua më duket se shkrirja e tri magazinave të furnizimit nuk është e arsyeshme. Nuk mund ta quajmë çdo zyrë hallkë të tepërt».

Mirëpo një minator u hodh dhe e ndërpreu:

— Ne nuk i quajmë zyrat të tepërta, shoku Polo, por ato që janë krijuar sa për t'u dhënë një rrogë të mirë njerëzve, duhet të shkrihen.

— Mos u nxito, djalë, — e preu përgjegjësi, — duhen parë gjërat më thellë, jo propozime në erë. Ju

mund të thoni se edhe për përgjegjës nuk ka nevojë, e hajde, pastaj, bjeri t'i biem!

Këtu nuk u përmbajta dot, u ngrita dhe i thashë përgjegjësit:

— Or shok i dashur, ju po nxitoheni shumë, më duket. I kini shtrirë këmbët jashtë jorganit e tashti ju vjen rëndë t'i mblidhni. Ky kantier, që përpara dy vjetësh quhej «Sektori numër dy» dhe që nga volumi i punës ka ndryshuar fare pak, të shkrihet me sektorin tre. Pra, drejtori të ketë që ç'ke me të, por jo kjo që është krijuar më shumë për t'u gjetur qoshe njerëzve. Bile, edhe ju, shoku Polo, duhet ta shihni veten më mirë.

Ho, u ndez puna! Shefi i kontrollit të cilësisë u hodh përpjetë; «Ky është qëndrim i padrejtë, bile ka qëllim tendencioz. Ti, xha Feti, i nxit dhe këta shokët më tepër. Ne të respektojmë, por, ama, ti ke dalë në pension, nuk duhet të përzihesh në punët e kantierit».

— Ashtu, or bir, — i thashë. — Kam dalë në pension, por nuk kam dalë nga jeta, as nga galeritë. Unë, si më i moshuar, ju këshilloj që të shikoni më tej se vetja...

Ndërsa po flisja unë me të qetë, u hodh një minator komunist:

— Xha Feti, më fal. — Pastaj iu drejtua burokratëve: — Këtu nuk është fjala për një gabim të thjeshtë. Jo. Çështja është që të ndahet shapi. Kontrolli punëtor drejtohet nga parimet e Partisë. Parimet e Partisë zbatohen e nuk hidhen në votë sipas qejfit. Këtë desha të them, — tha ai dhe u ul. Fjalët e tij ranë të rënda. Burokratët mbetën ngushtë. E ç'ta zgjas, ndoshta të kanë treguar dhe të tjerët. Diskutimet e gja-

lla e çanë shtegun, u shkurtuan degët. Çdo gur, si i thonë fjalës, zuri vendin e duhur.

E ja, tashti punët rrjedhin përbukuri. Për këto punë të mira duhet shkruar, që të merren vesh, që të mësojmë nga njëri-tjetri. Të mirat t'i marrim, se na duhen, por edhe të këqijat që ndodhin në një vend t'i dimë, që të mos i lëmë të na mbijnë gjetkë. Me një fjalë, pësimi të na bëhet mësim për tjetër herë. Apo e kam gabim?...

... dhe e kam qajmë...
një fjalë pësimi të na bëhet mësim për jetën herë.
E ja tashti çunë njerëzishin për këto
qunë të mira duhet shkruar që të merren vesh, që
të mësojmë nga njerëzit. Të mirat t'i marrim, se
na duhen, por edhe të këqijat që ndodhin në një vend
t'i dimë, që të kërkojmë të ndodhin më mirë.
BIRI I MURATORIT

Në orën gjashtë e gjysmë të mbrëmjes mbaroi mbledhja.

Ai u ndërrua shpejt e shpejt në garderobë dhe doli nga porta e oborrit të uzinës. Nuk priti në stationin e autobusit. Mori lart trotuarit, ku njerëzit shtoheshin me kalimin e kohës. Në orën shtatë do të takonte Anilën. Duhej nxituar për të arritur në kohë. Një zë i brendshëm nisi ta ngacmonte e t'i përziente mendimet.

«U nxitove kot, kush të linte ty të largoheshe?! Shef reparti, tornitor i njohur. Pale si do ta presë ajo këtë lajm! Si do ta presin prindërit e saj? I ati ka qenë i ftohtë me këtë krushqi. E ja, tashti del dhe kjo! Pa bërë celebrimin me të bijën!... Ah... entuziazmi, nxitimi!...»

«Jo entuziazmi, por detyra ndaj kohës. Ajo do ta presë mirë lajmin. Ajo është vajzë e pjekur... Prindërit do të binden, ... do të mësohen... Dashuria do të qëndrojë mbi këto shqetësime të vogla... Fundja, jeta nuk duhet të jetë vaj, dreqi ta hajë!» i thoshte ai zërit të dobët, që kushdi nga ç'skutë e ndërgjegjes ngrihej.

«E ore e, dashuria!... Dashuria është si puna

e zjarrit. Po nuk i ndenje pranë t'i hedhësh dru, ajo shuhet», e ngaçmoi prapë zëri i brendshëm.

Shikoi orën. Koha e takimit kishte kaluar. Nxitoi hapat. I duhej akoma një copë udhë e gjatë për të mbërritur në vendin e takimit.

Ajo nuk ishte atje, poshtë degëve të blirit. Gjatë pesë muajve që ishin njohur, ishin takuar (vazhdimisht atje. Ai copë vend dhe një llambë e gjatë neoni, që ngrihej mbi degët e blirit, ishin përzier në kujtimet e tyre të ëmbla. Sa herë binte rasti të kalonin aty pa njëri-tjetrin, ndienin praninë e kujtimeve e ngrohtësinë e mallit, të dashurisë.

Kurse atë çast Petrit Begës ai vend iu duk i ftohtë; një ndjenjë boshllëku ia ngushtoi gjoksin. Ishte i pari rast që takimi dështonte.

«Kushedi ç'do të ketë menduar Anila!» tha me vete dhe u kthye në të majtë, për të dalë në qendër të qytetit.

Ai ishte njohur me Anila Tërpinin pesë muaj më parë, në një takim të racionalizatorëve të kryeqytetit. Ajo merrte pjesë në atë mbledhje si teknologe e dalluar, kurse Petriti ishte tornitor e frezator i njohur. Diskutimet e tyre përkonin. Ky që shkaku që biseda vazhdoi edhe në pushime, edhe në mbrëmjen e dëfrimit që u organizua pas konferencës. Miqësia e tyre lindi nga metalet, pasi për ato folën në fillim, e pastaj, nga metalet, zbritën në jetën, në zemrat e tyre. Duke u futur në zemrat e në jetën e njëri-tjetrit, krijuan dhe bindjen se vitet që do të vinin mund t'i ndërtonin së bashku të bukura.

U treguan prindërve.

Në familjen Tërpini dashuria e vajzës së tyre të

vetme u prit me zhurmë, shqetësime e pyetje. I ati i Anilës gjatë gjithë jetës kishte qenë nëpunës finance. Tashti punonte në një dikaster. Për fatin e vajzës së vetme kishte menduar shumë herë, bile atë e quante kyçin e shqetësimeve të tij. Herë vetë, herë nëpërmjet të së shoqes (shefe administrate në një ndërmarrje) i kishte kujtuar së bijës fatin e së ardhmes. Njëherë i kishte propozuar për një ekonomist, një herë tjetër për një pedagog dhe më vonë për një inxhinier a mjek. Ia donte zemra që vajzës së tij të vetme t'i siguronte një jetë të qetë, pa telashe. Kështu që, kur e bija i tregoi dashurinë e saj, në prani të mamasë, Spiro Tërpini u zu ngushtë. Ato që i tha e bija, nuk pugeshin me ato çka kishte menduar ai, prandaj e kundërshtoi me nervozizëm mendimin e saj.

Pas dy-tri ditësh, Spiro Tërpini e pyeti përsëri të bijën:

— Domethënë paske vendosur të na marrësh tor-nitorin?

— Ne e biseduam një herë këtë çështje, baba, — i tha e bija.

— E, e... e biseduam, por më duket sikur unë të thashë të mendoheshe dhe një herë më mirë.

Agllaia, e shoqja e Spiros, e ngriti mbi mbështetëse hekurin e korentit dhe i hodhi një shikim së bijës. Pas një heshtjeje të shkurtër, Anila iu përgjigj:

— S'kam ç'të them, baba. Unë jam menduar mirë që në fillim, përpara se t'ju thosha për këtë çështje.

Spiro Tërpinit i kërceu damari. Atij nuk ia donte zemra atë krushqi, por ja që e bija ngulte këmbë si mushka e sertë.

— S'paske gjë të na thuash? E paske menduar mirë, ë? A ç'të bukur mendim!... Po pse, moj, të dalësh ti nga radha e shoqeve të tua? Ç'të mungon?

Pa shikoje të bijën e Sotirit: ia futi krahun pedagogut të elektronikës! Shikoje Leonorën me kë e lidhi fatin! Jurist në Ministrinë e Jashtme biri i botës, nesër i shkon dhe ambasador në Vjenë! As me të bijën e Pandit nuk u hëngre! Vetëm me shkollë të mesme, po prite këto ditë kur të shpallë fejesën me një mjek. . . Kam thënë unë, nuk je ti nga ato lule, jo!

Fjalët e të atit Anilës i rënduan në shpirt. Iu duk sikur dikush i shtrëngoi gjoksin e nuk e linte të merrte frymë lirisht. Ajo e njihte mirë babanë e saj. Ia njihte huqet dhe mendimet, por nuk e kishte besuar se, kur të vinte dita të diskutohej e ardhmja e saj, babai do të ngulte këmbë në atë logjikë të çuditshme. Njëherë mendoj të heshte, të mos e nxiste më tej nervozizmin e të atit, por nuk e la sedra.

— Baba, më fal, por më duket se po arsyeton mjaft shtrembër.

— Si, po arsyetokam shtrembër? Ashtu? Ha-ha-ha! . . . Pa dëgjoje, moj grua, vajzën tonë të vetme! . . . Arsyetokam shtrembër! Ha-ha-ha! . . .

— Baba, të lutem mos qesh kështu, — e ndërpreu Anila.

— Si të mos qesh? — ia ktheu nervoz Spiroja dhe luajti nga kolltuku.

— Spiro! Ç'është kështu me ju, xhanëm? Nuk ndërroni dot një fjalë pa inat! Lëreni tashti këtë muhabet. Oj, na gjeti një punë! Çdo darkë grindje. Pusho Anila! — ndërhyri Agllaia.

— Jo, mama. Babai më pyeti, unë iu përgjigja. Unë nuk jam më e vogël tashti, të më marrin për dore e të më tregojnë udhën e jetës. Sot jam në gjendje të kuptoj se gëzimin e jetës nuk do të ma sjellë diploma ose profesioni i atij me të cilin do të jetoj.

— Pa na thuaj, moj bijë, nga do të burojë gëzimi

yt, ta dimë edhe ne? — tha Spiro Tërpini tashti me zë të ulët, por jo pa ironi.

— Nga njeriu, baba.

— Oj... po ku e ngrite këtë laborator psikologjik ti? Kur na e njohe këtë njeri të kulluar për katër-pesë muaj?!... Nuk e marr vesh këtë logjikë! Ç'mjegull jua errëson arsyen, xhanëm? Jeta është kontratë e jo llafe, jo ndjenjë që avullohet për një muaj a një vit. Secili shikon anët e mira ekonomike, morale, politike dhe pastaj projektton jetën. Kështu bëhen këto punë, e jo kuturu.

— Ju e shikoni çdo gjë me ekonomizëm, baba.

— Ashtu?! Po ti nga ç'kënd e shikon? Nga këndi i spontanitetit, nga «dashuria e kulluar» që zbret nga qielli, apo...?

— Jo. Unë e shikoj nga realiteti i jetës. Unë vlerësoj sinqeritetin e njeriut, thjeshtësinë e tij, forcën e vullnetit për të mbajtur mbi supë jetën, për të ecur pranë meje me optimizëm, me besim. Të më shikojë e t'i shikoj shpirtin, e jo diplomën ose pozitën. Me këtë sy e kam parë Petritin gjatë gati gjashtë muajve që jam njohur me të.

— Ashtu?... Mirë atëherë... Ec me optimizmin tënd... por mos kthehesh nesër e na ankohesh, na kërkon mendimin tonë! — tha i ati.

— Jo. Mos kini dyshim për këtë; nuk do t'ju ankohem. Çdo pasojë do ta heq vetë... Unë dhe Petriti dëshirojmë që në gëzimin tonë të marrin pjesë prindërit, ashtu siç e kërkon logjika. Petriti u ka thënë prindërve, dhe ata presin të njihen me ju. Është mirë ta bëni këtë... Unë nuk po ju lidh me ndonjë familje të keqe, përkundrazi.

Pas fjalëve të saj ra heshtja. Secili bluante mendime më vete. Spiro Tërpini nuk mund të mësohej

me faktin që e bija do të merrte një tornitor, birin e një muratori të thjeshtë. «Po ç'do të bisedoj unë me këtë krushk, ç'mendime do të këmbëjmë me njëri-tjetrin? E ç'mund t'i them, e ç'mund të më thotë një murator që gjithë jetën ka ngritur shtëpi dhe oxhaqe fabrikash? Palë, kur të më pyesin Sotiri, Pandi ose Aristidhi: «Ç'punë bën dhëndri? Ç'familje është? Me se merret krushku? Murator? Hë më të lumtë, o Spiro! Qenke lidhur me klasën e bazamentit!» Hej, bela, ku nuk të shpie vajza!»

E bija u ngrit dhe hapi televizorin. E shoqja, Agllaia, shtroi tavolinën. Darka atë natë kaloi në heshtje. Kur kaluan në dhomën e gjumit, Spiro Tërpini i tha së shpejtë:

— Hë, moj grua, si do të bëjmë?

— Ç'të bëjmë, ajo nuk tundet nga e saja! E do atë djalë. Edhe ti sa të madhe e bën këtë punë, o Spiro, e mërzit kot vajzën! Unë të thashë që dje se e pashë djalin: është si div, nuk ke ç'i shan.

— Mirë, moj grua, por është jetë kjo. Njeriu jeton për vete, por jeton edhe për opinionin e të tjerëve. Ne këtë vajzë kemi. Ndryshë kisha menduar unë, tjetër jetë më donte zemra për të, por ja, fati të heq për hunde. Ç'të bëjmë! Do t'i shkojmë mbrapa.

Anila ishte shtrirë në krevat. Përsëriti me mendje bisedën e bërë me të atin. Solli përpara syve Petritin, ndjeu ngrohtësinë e tij, i dëgjoi zërin: «Mos u mërzit, Anila, dashuria ka kapërcyer male e jo pengesa të tilla. Edhe prindërit tanë do të merren vesh».

Kështu i pat thënë ai, kur ajo i pat treguar kundërshtimin e parë të babait. Gjumi e zuri me mendimin se jeza do t'i sillte gëzime.

Në familjen Bega, lajmi i Petritit u prit me gëzim e rrallë që sjell për prindërit fejesa e djalit të

vetëm. I ati i Petritit, Tafil Bega, kishte punuar murator qysh në moshën katërmbëdhjetëvjeçare. Fëmijëria dhe rinia e tij ishin mbushur me kujtime të hidhura. Tashti i ndodhte shpesh që, pasi ulej në shtëpinë e tij të ngrohtë, atje në divan përballë televizorit, e shikonte veten e tij në vitet e rinisë, duke bredhur me çekanin, plumçin me spango e mistrinë në trastë, për të siguruar bukën e gojës. Vitet e socializmit Tafil Begën e bënë usta, e bënë mjeshtër të nderuar. Duart e tij kishin lidhur miliona tulla të shumë oxhaqeve të larta, në shumë uzina të vendit. Tashti xha Tafili ishte në pension, por duart e tij të mësuara me tulla e gurë nuk rrinin të qeta. Shpesh ndodhte që përpara shtëpisë së tij të ndalonte një makinë. Kërkonin mjeshterin e vjetër, që të jepte një mendim për ngritjen e ndonjë oxhaku të vështirë.

— Po pa na thuaj, mor bir, është vajzë e mirë, e ke njohur thellë? — e pyeti të birin kur ai i dha lajmin e gëzuar.

— Është vajzë e mirë, baba.

— Ç'familje ka, është në rregull me udhën tonë? (Xha Tafili me «udhën tonë» kuptonte udhën e mirë të gjithë shoqërisë.)

— Familje e mirë është, baba. I ati punon në një ministri, ekonomist, edhe e ëma nëpunëse në një ndërmarje.

— Domethënë, qenkan nëpunës! — tha Tafili si i menduar. — Po vajza ç'punë bën?

— Është teknologe. Ka dy vjet që ka mbaruar për inxhinieri.

— Shiko, shiko, moj grua, sa thellë qenka futur i biri i muratorit! Por a i ke parë thellë punët, or Petrit? — i tha të birit duke e shikuar në sy.

— I kam parë mirë, baba. Ajo është vajzë e mirë,

e thjeshtë, është punëtore. Pasi ka mbaruar shkollën e mesme teknike, ka punuar një vit në uzinë, pra, di të punojë në torno ashtu si unë. Ka dy vjet që ka mbaruar universitetin dhe punon në një byro teknologjike.

— Ashtu? Domethënë e nxjerrka jetën edhe me duar? Bukuri!

— Sa vjeç qenka kështu, mor të keqen nëna? — e pyeti Petritin e ëma, e merakosur.

— Nuk ia kam parë letërnjoftimin akoma, po duhet të jetë nja njëzetekatërvjeçe, — iu përgjigj së ëmës me të geshur.

— Të na e sjellësh nesër të njihemi! Uh, ia marr të nëna! — kuturisi plaka.

— Po ata prindërit e saj ç'thonë? Je njohur me ta?

— Jam takuar një herë. E ç'do të thonë? Me kundërshtime e pritën, por ajo i vuri përpara vendimit të saj të prerë. Tashti e kemi lënë të njihemi familjarisht.

— Pse, ç'kërkonin më mirë ata? — tha xha Tafili, i pakënaqur. Por i biri ia preu fjalën.

— Jo, baba, çdo prind e shikon të mirën sipas mënyrës së tij për fëmijën e vet.

— Epo mirë, bukuri, të njihemi. Të përgatitemi. Do të njihemi me krushq intelektualë, plakë, mos më turpëro! — i tha së shoqes me shaka e tërë gaz.

— Mos ki merak, se me shqiptarë do të takohemi, a derëbardhë, — ia ktheu plaka.

— Eh... për hair na qoftë! Ishallah më qëlloftë dhe krushku pas midesë sime, — e mbylli bisedën Tafil Bega.

Njohja familjare u bë. Petriti dhe Anila e ndien veten të lumtur atje në sallën e ndritshme të ka-

fesë «Tirana». Prindërit e tyre herë pas here zgjidhnin lëmshin e bisedës. Kërkonin te njëri-tjetri atë çka do të lidhte krushqinë e tyre. Me gjithë përpjekjet që bënin të dyja palët, nuk mund të mos vihej re një farë stonimi, jo vetëm në këndin e shikimit të gjërave, por edhe në qëndrimin e tyre në atë banket të vogël. Spiro Tërpini nuk mund t'i largohej formës zyrtare të qëndrimit. Fatimeja, e ëma e Petritit, shikonte djalin e nusen, e lumturuar. Për të tjerat nuk interesohej. Me krushkën ndërronte nga një bisedë. Tafil Bega lëvizte, mbështetej e u fliste kamarierëve si të ishte në shtëpinë e tij. Nëpunësit Spiro Tërpini i bënte përshtypje shkujdesja e krushkut murator.

Herë pas here Tafil Bega e merrte krushkun në telefon. E ftonte në kafe «Tirana», e priste në Pallatin e Kulturës, ose i shkonte në shtëpi.

Një mbrëmje i tha të birit:

— Nusen e kemi siç na e do zemra, kurse ai krushku nuk më kruan fare.

— Pse kështu, baba? — e pyeti me buzën në gaz i biri.

— Jam ulur kaq herë në kafe me të. Do të marrësh një raki? i them, — Jo, të falemnderit, — më thotë, — nuk i kam përdorur pijet». Po mirë, merr një kafe, i them. «Jo, se më ngacmon zemrën», më thotë dhe merr një shurup ose një pastë. Epo hajde, gjeje muhabetin me atë burrë që ha pasta, të kam rixha!...

I biri qeshi me të madhe. I ati shtoi:

— Ke parë kështu ti? Unë kam dërrmuar e lidhur kushedi sa tonelata gurë e tulla dhe nuk kam pirë asnjë aspirinë, kurse krushku im, në zyra të ngrohta gjithë jetën, pa iu lagur këmba as dora, më

ankohet nga zemra, nga nervat, nga pagjumësia!.. Hej, dreq! Mua më janë ndërruar gjysmat e thonjve, të shtypur nga gurët, e prapë duart më hanë për gurë. Ai më thotë: «Eh, ç'jemi lodhur sot! Na mbytn punët, katër orë mbledhje bëmë sot». Epo, merr një pastë, i them.

— E mjaft tashti, se e dëgjuam një herë punën e pastës. Ta ka qejfi ty t'i hedhësh grykës nga një gotë e do që të gjithë të dalin në shtegun tënd, — i tha e shoqja duke i bërë shenjë se mos djalit i mbe-tej qejfi. Por Tafili ia ktheu:

— Mos u mërzit, ti, se i njeh dallëndyshja zogitë e saj. — I shkeli syrin të birit dhe ngriti gotën: — Hajde, gëzuar, bir i babait, jetë të lumtur!

Petriti ecte i menduar në bulevardin plot drita. Vendimi i asaj nate ishte prova e parë e dashurisë së tyre. Ai nuk trembej se mos kjo ndodhi do të trondiste dashurinë e saj. Jo, për këtë ai kishte bindje, por edhe fare pa rëndësi nuk e quante largimin e tij në ato rrethana. Ftohtësinë në mes prindërve të tyre Anila dhe Petriti e kuptonin. E sa herë që bisedonin të dy për atë çështje, Petriti i thoshte: «Krushqia është si puna e shokëve që i vë të rrinë në një bangë në shkollë. Në qoftë se mendimet e tyre nuk do të hyjnë te njëri-tjetri, ata i bashkon vetëm banga. Kështu ndodh dhe me prindët tanë».

Në qendër të qytetit, në buzë të trotuarit, përbri monumentit të Skënderbeut, Petriti qëndroi me mëdyshje. Të shkonte në shtëpi të njoftonte prindërit, apo të shkonte te Anila?

Njerëzit vërshonin nga të katër anët, përziheshin në qendër si vorbullat e një lumi të qetë e derdheshin

në dy degët e bulevardit kryesor. Ishte natë e bukur qershori. Pas një copë here Petriti çau në mes njerëzve dhe mori lart nga sheshi «Avni Rustemi» që të vente në shtëpinë e Anilës.

Spiro Tërpini ishte mbështetur në kolltuk dhe ndiqte ekranin e televizorit. Anila rrinte e heshtur në divan. Mungesa e Petritit në takim e kishte vënë në mendime. E ëma po qëndiste me ngjyra të ndezura në një copë stofi të zi. Në ekranin e televizorit u shfaq spikeri dhe njoftoi programin e lajmeve. Pas tre-katër lajmeve nga rrethet, në ekran doli një repart uzine plot zhurmë. Një kronist i radiotelevizionit po merrte në intervistë Petrit Degën. Pasi Petriti dha disa nga rezultatet e repartit që drejtonte, kuadri kaloi në sallën e mbledhjes. Punëtorët e repartit ishin mbledhur e po dëgjonin një thirrje të Komitetit të Partisë. Familja Tërpini ndiqte me kureshtje ngjarjet në ekran. «Qenka në mbledhje, prandaj s'erdhi», mendoi me vete Anila. Reportazhi televiziv vazhdonte rrjedhën e ngjarjeve. Familja Tërpini ra në një heshtje ndrydhëse. Në ekranin e televizorit dhëndri i tyre fliste krejt i qetë: «Atdheu është yni, ne jemi zotërit e tij. Unë jam gati të nisem ku të më caktojnë, në Fierzë, në Ballsh, Elbasan, kudo ku ka nevojë Atdheu, që nesër...»

Spiro Tërpini ktheu sytë me habi nga e bija. Ajo rrinte e menduar. Vendimi i Petritit e zuri në befasi. Ai nuk i kishte thënë asgjë për ato që deklaroi në ekranin e televizorit. Agllaisë i ngriu qëndizma në dorë.

— Ç'janë këto, moj bijë? — pyeti Spiroja me ton nervoz dhe ironik.



Anila e mblodhi veten dhe iu përgjigj të atit, duke u përpjekur të fshihte shqetësimin e saj:

— Ti e shikon vetë, baba... U bëri thirrje Partia dhe ai, si komunist e përgjegjës reparti, iu përgjigj thirrjes...

— Ashtu, ë? Po tashti ai nuk është vetëm, nuk është më beqar, që të bëjë si t'i teket. Ka të bëjë me shqetësimet, me fatin e njerëzve, me fatin e të tjerëve... Ç'jemi ne këtu, gurë? Nuk duhemi pyetur ne?... Epo, nuk e marr vesh! Të fluturojë tjetri katuru... Akoma pa u fejuar në bazë të rregullave, vete e na merr iniciativa dhëndri!... — shfryu Spiro Tërpini dhe i hodhi sytë në ekran të televizorit.

— Ndoshta nuk do të shkojë me të vërtetë. Ia donte puna të fliste i pari për të nxitur të tjerët. — tha e shoqja.

— Aa... e nuhate ti! Për të nxitur të tjerët!.. — vazhdoi me ironi. — S'ka më profka tashti! Lëshove fjalën, merr udhën... —

— Edhe ti, baba, e bën sikur do të shkojë në fund të botës! Si gjithë të tjerët, nëpër Shqipëri.

— Ashtu, ë? Ç'të tjerë? S'ka njeri që të lërë prindërit vetëm, të lërë punët e jetës në mes e të kërcasë në Fierzë, e sa? Tre vjet, pesë, dhjetë... për jetë. Pse, mos do të ngrihet vetëm një digë mbi Drin? — tha Spiro Tërpini duke e shikuar të bijën me inat.

Spikeri i televizorit kishte kaluar në hallet e botës së madhe. Nga korridori u dëgjua tringu i ziles. Anila u ngrit dhe doli në korridor, duke mbyllur pas vetes derën e kuzhinës. Hapi derën.

— Oh, Petrit, erdhe? — Sytë e tyre u ngulën shtizë te njëri-tjetri. Pak sekonda, fare pak. Një shikim i thellë, serioz. Ai buzëqeshi i pari.

— U mërzhite që s'erdha në takim?... Kishim mbledhje.

— E di.

— Ku e more vesh?

— Më tha televizori.

— Prandaj qenke me re? — i tha ai i qeshur dhe i hodhi dorën në qafë.

— Jo, Petrit... retë e mia janë pa shi, shiun e kemi brenda, — i tha ajo duke bërë me kokë nga kuzhina.

— Pse?

— Babai është bërë tym.

— Po ti ç'mendon? — i tha ai me ngulm.

— Ç'të them unë?.. Ti duhej të jepje shembullin...

— Jo, — e ndërpreu ai. — Nuk ishte shembulli qëllimi, fjalët e mia ishin bindje.

— Po... ashtu... unë jam me ty, — i tha ajo me zë fare të ulët dhe iu afrua në gjoks. Ai rrëshqiti lehtë faqen e tij në të sajën dhe i pëshpëriti afër veshit: «Të kam të mirë shumë». Në ato pak sekonda Anilës iu shpërnda shqetësimi. Atë fjalën e tij aq të ëmbël, të singërtë «të kam të mirë shumë», e përsëriti me mendje dhe e rrëkëlëu thellë në zemër.

Atë zërin e keq të brendshëm Petriti e kishte lënë jashtë. Në shtëpinë e së dashurës ai u fut me atë vullnet e kurajo me të cilat kishte folur atje përpara shokëve. Me atë vullnet u fut në kuzhinë dhe përsëndeti vjehrrin e vjehrrën.

— Mirëmbërëma, — iu përgjigj me vonesë dhe indiferencë i vjehrrit.

Heshtje. Një heshtje e ftohtë, që pristë një fjalë për të mos u bërë e padurueshme.

— Si u ngrysët? — pyëti Petriti.

— Dëgjuam atë zotimin tënd, — tha Spiroja duke rrokullisur fjalët.

— Ku e dëgjuat?

— Në televizor, de.

— Po. Ishte një mbledhje e gjallë, — tha Petriti, duke parë në sy të vjehrrin.

— Ne na çuditi gjallëria e dhëndrit tonë, — tha Spiroja me ironi.

— Po më flisni me faqe më duket, vjehërr.

— Ashtu është, me sa duket.

— E pse të jetë kështu?

— Po si të jetë, sipas teje? U miqësove me vajzën tonë...

— U miqësua, duhet thënë.

— E de... u miqësua... i thurët ëndrrat... dhe ne ju uruam, pra, përkrahëm qëllimet tuaja... Tashti ekzistojmë ne apo jo? Ka respekt për ne si prindër apo s'ka?

— Unë nuk kujtoj ndonjë rast që të më ketë munguar respekti.

— Pse, nuk është mungesë respekti ky, bile mos-përfillje edhe për shoqen e jetës? — Këtu ai ia hodhi sytë së bijës. — Akoma nuk jeni celebruar... akoma nuk keni përpiluar të ardhmen, e ti shkon e merr zotim të largohesh... nga njerëzit. Pse, a nuk kemi të drejtë në të pyetemi për këtë gjë?

Shqetësimi i Spiro Tërpinut nuk qëndronte te vështirësitë që mund të kishte dhëndri, as te shqetësimet e së bijës. Frika e tij ishte se mos ai, dhëndri, mbetej andej dhe e bija ikte nga Tirana. Ose se mos largimi bëhej prishje, ndarje, dhe kush do t'i duronte thashethemet, shikimet ironike të kolegëve të punës! Padashur dëgjoi një zë që pëshpëriti në qenien e tij. «Ndoshta me këtë rast priset krushqia e ftohtë».

Mendimet e të vjehrrit Petriti i dinte tanimë, prandaj iu përgjigj me gjakftohtësi.

— Në qoftë se fjalët e mia i dëgjuat nga televizori, gjërat e vogla duhet t'i lini mënjanë. Unë nuk besoj se ju, prindërit tanë, të mos dëshironi që ne, bijtë tuaj, të mos u përgjigjemi kërkesave të kohës sonë.

— Këtë nuk ta thashë, — e ndërpreu i vjehrrin.

— Po atëherë? Mos duhet t'u thosha shokëve, të prisnin një orë, sa të vija të pyesja prindërit, të fejuarën, vjehrrin? Jo. Partia bëri thirrje, dhe unë iu përgjigja i pari, jo për t'u bërë hero, por për të përgjigjur emrin e komunistit. Nuk shikoj këtu as mun-

gesë respekti, as ndonjë arsye alarmante. Do të shkoj dy-tre vjet në Fierzë, ku punojnë mijëra të tjerë nga të katër anët e vendit. Pastaj do të kthehem më i fortë për jetën e më i gëzuar, se edhe unë bëra diçka për digën më të lartë në Ballkan...

— Pse, kjo që bën këtu nuk është diçka që të gëzon? — e ndërpreu i vjehrrri.

Kjo ndërhyrje nuk i pëlqeu Petritit. Prandaj në fjalët e tij nisi të ndihej nervozizmi.

— Ju e dini se çdo punë ka gëzimin e saj, por ka gëzim e gëzim. Ka gëzim për vete, ka dhe gëzim që u takon më shumë të gjithëve. Nga Metalurgjia dhe Fierza janë kthyer sytë e gjithë Shqipërisë. Këtë gjë e dini mirë ju në ministri...

— Mos do të më bësh agjitacion tashti? — e ndërpreu prapë Spiroja.

— Jo. Por dua t'ju them se, meqë ju, i dini shqetësimet e kohës mirë, si punonjës dikasteri, nuk duhet të më flisni me këtë gjuhë. Më duket sikur bini në interesa të ngushta.

— Mos u nxito!. Entuziazmin përdore atje në mbledhje; këtu po flasim në familje, për hallin e përbashkët. Ne jemi prindër e për fëmijët që kemi rritur, kemi shqetësimet tona. Interesi shoqëror është i lidhur me interesat personale të familjes.

— Po. Por këto që thatë ju e ndajnë familjen nga shoqëria.

— Më duket, po e tepron shumë, — e ndërpreu të dhëndrin Spiro Tërpini, i nxehur.

— Spiro! Lëreni këtë çështje tashti. Me nervozizëm nuk zgjidhen punët, — ndërhyri e shoqja.

Anila i bëri shenjë Petritit, por ai vazhdoi:

— Teprimet po i shkaktoni ju. Unë nuk e prisja një qëndrim të tillë. Megjithatë, unë kam vend-

sur të nisem ku të më caktojnë. Bile mund të punoj an-
dej për shumë kohë. Anila është tashti në moshë të pje-
kur. Ka krijuar botëkuptimin e saj mbi jetën. Ajo le
të vendosë vetë, si ta shikojë më mirë.

Pa mbaruar mirë fjalën, ai u ngrit të dilte. E
vjehrra kundërshtoi.

— Atëherë bëni si t'ju dojë qejfi, — tha Spiro
Tërpini, pa e mbajtur dot nervozizmin. Sipas tij dhën-
ndri fliste kaluar, pasi zemrën e së bijës e kishte në
duar.

— Do të bëjmë si të shkojnë punët më mirë, — ia
ktheu Petriti dhe u tha: «Mirupafshim!» Vjehrra e
kundërshtoi përsëri, por ai doli nga shtëpia. Anila e
përcolli. Ajo ishte më e qetë se Petriti, bile replikat
nervoze në mes tij dhe të atit, asaj iu dukën të nxi-
tuara, të tepërta. Kur dolën nga oborri i shtëpisë së
vogël përdhese, Petriti i hodhi dorën krahëve dhe e
pyeti:

— U mërzite?

— Jo aq sa ti. U grindët kot me babanë. Ai vërtet
u nxitua, por deri në një farë mase duhet kuptuar,
se edhe ai ka shqetësimin e tij si prind.

— Nuk e mohoj këtë, por këndi nga e shikon ai
shqetësimin, është i ngushtë.

— Uf... kush e rregullon me këndet Titi! — i tha
ajo me të qeshur e, pasi i zuri dorën, shtoi:

— Do të na marrë malli...

— Obobo... vite të tëra, sa të kthehem nga Aus-
tralia!... Ja ku është, një pëllëmbë, Shqipëria jonë...
Për tetë orë vij nga Fierza, — i tha ai dhe e shtrën-
goi në gjoks.

— Do të na marrë malli, — i pëshpëriti ajo së-
rish.

— Do të duhemi më shumë. Malli e shton dashurinë, — tha ai.

Ecën ashtu pranë njëri-tjetrit deri në rrugicën kryesore. Atje u ndanë.

— Nesër do të jem nga Komiteti i Partisë i Rajonit. Pasi të marr vesh se ku do të më caktojnë, do të të lajmëroj. Sot të pres në orën pesë.

— Ku?

— Te bliri edhe sot.

Tafil Bega, kur pa të birin në televizor, kur dëgjoi fjalën e tij, u ngrit nga tavolina dhe e trokiti gotën me ekranin e televizorit. Qëndrimi i të birit i kujtoi udhët e tij nëpër Shqipëri.

Kur i biri u fut në kuzhinë, e priti me krahët hapur.

— Hë, më të lumtë, or bir i babës! Ja kështu bëjnë burrat! Të kam thënë unë, moj plakë, se im bir nuk do t'i fshihet jetës, do t'i ndjekë uzinat, si unë oxhakët e lartë, — thoshte xha Tafili dhe shtrëngonte të birin me ato duart e rënda e të shkurtra.

— Posi, ore, të bredhë si ti, që më ikje për dy javë e më ktheheshe pas tre muajsh! — ia ktheu e shoqja me mëdyshje.

— E pra, prandaj nuk i bëre katër ti, — ia ktheu së shoqes dhe zgjati dorën e i rrahu shpatullat. (Xha Tafili ka edhe tri vajza. I ka të martuara. Një e ka në Rubik, një në Elbasan dhe një në Durrës. I ka martuar gjatë udhëve të oxhaqeve).

— Rri tashti, — i tha e shoqja dhe përqafoi Petritin.

— Hajde, plakë, silli gotën djalit... Sillna dhe një

çikë meze. Hë më të lumtë.. Ja kështu, de! — tha tërë qejf Tafil Bega dhe ngriti gotën. — Gëzuar, bir, të bardha i paç udhët!

Gëzimi që ndiente Petriti për qëndrimin e të atit ishte i pamasë. «Me prindër të tillë njeriu fluturon», mendoi me vete dhe e toku me të atin:

— Gëzuar, baba, gëzuar mama, ju paça shëndoshë!.. Më gëzuat shumë. — Dhe mendimi i fluturoi te Anila, te prindërit e saj dhe, për të mos humbur në krahasime, tha:

— Isha te vjehrri.

— Hë... pa hë, ç'tha krushku im? Si dukej me zemrën? — e pyeti xha Tafili me shaka.

— U grinda me të. Ata e pritën me shqetësim këtë punë.

— S'ka gjë, se zbuten. Rëndësi ka thëllëza, si qëndroi ajo?

— E fortë, me mua.

— Hë më ju lumtë!

— Të nesërmen, të gjithë mbasditen, Petriti dhe Anila e kaluan bashkë. Për ta ajo mbasdite ishte nga më të bukurat. Vetëm se orët qenë të shkurtra. Në mbrëmje, familja Tërpini ishte e ftuar për darkë nga xha Tafili. Ai bënte darkë. I biri do të nisej të nesërmen për në Hidrocentralin e Fierzës.

Sapo Anila u fut në kuzhinë, e ëma e pyeti:

— Hë, ç'lajm solle, ku e caktuan?

— Në Fierzë.

— Qyqja, nuk paska mundur ta rregullonte të paktën në Ballsh!

— Njësoj është, mama, — iu përgjigj e bija.

— Hëm, — bëri Spiro Tërpini dhe shtoi me kast:

— Ja ku është Fierza, dy ditë me makinë!

E bija nuk i dha përgjigje, por u tha:

— Sonte jemi të ftuar për darkë nga prindërit e Petritit.

Agllaia, pasi i hodhi një bisht syri të shoqit, i tha së bijës si me çudi:

— Qyqja, e ç'ne kjo darkë?!

— Aman dhe ju, mama, çdo gjë u çudit! Atyre u shkon djali në aksion dhe festojnë një natë së bashku... Ne një televizor morëm parvjet dhe na erdhën miq e të njohur, bile dhe me torta, si në ditë-lindje!

— Hëm... Ka filluar vajza të na korrigjojë, moj grua, — tha Spiroja duke rrokullisur fjalët.

— Po ta krahasosh këtë me rastin e atyre, për të korrigjuar është, baba.

Ra një heshtje e shkurtër. Anila u tha:

— Ata na presin në orën shtatë.

— Unë nuk vij dot... Shkoni ju të dyja, — u përgjigj indiferent Spiro Tërpini.

— Këtë nuk duhet ta bësh, baba, — tha Anila e shqetësuar.

— Unë jam dezurn në kabinetin e ministrit. Sonte nuk mund të vij.

— Dezurnin mund ta zëvendësosh, baba. Sonte duhet të vish. Ata janë njerëz të thjeshtë, por zakonet dhe mirësjelljen i njohin mirë. Mosardhja jote do t'i fyejë, — i tha Anila, duke shikuar sa të atin, t'ëmën.

— Spiro, rregulloje dezurnin sonte; duhet të vemi te krushqit. Nuk është mirë kështu, — i tha e shoqja, kur pa tronditjen e së bijës.

— Ju thashë se nuk vij. Dezurnin nuk mund ta ndërroj. Kështu u thoni atyre, — tha prerë Spiro Tërpini.

Anila i zbriti shkallët e shtëpisë bashkë me t'ëmën, me zemër të vrarë. Prindërit e Petritit do ta kuptonin arsyeën e vërtetë të mungesës së krushkut. Për këtë i vinte keq Anilës. Ata njerëz të çiltër e të mirë, i kishin hyrë në zemër, prandaj nuk mund të duronte asnjë fyerje, sado të vogël, për ta. Sa herë shkonte në shtëpi të Petritit, ajo ndiente dashurinë e ngrohtësinë e tyre të pamatur, krejt të natyrshme, pa as më të voglën shtirje. Sa herë dilte nga ajo shtëpi e ngrohtë, mendonte me vete: «Çudi, ç'ndodh këstu me njerinë! Ç'ndryshime të çuditshme has në rrjedhën e jetës! Dashuria e njerëzve të tu, që të kanë lindur, që të kanë sjellë në jetë, ndodh të ngushtohet, të zbehet, të ftohet!... Ndërsa zemra të tjera krejt të largëta, të huaja, të afrohen, të mbajnë ngrohtë, e të mbushin me optimizëm për jetën». Që ditën që i fejuari i saj kishte marrë zotimin për t'u larguar, ajo e ndiente se, gjatë mungesës së tij, kurajon, qetësinë, kujdesin e gëzimin, do t'i gjente pa rezervë atje, në shtëpinë e të fejuarit, te prindërit e tij të thjeshtë e aq të dashur. Kurse në shtëpinë e saj do të gjente hijen e zemëratës së babait.

— Si do tu themi atyre? T'u themi se babai ishte me shërbim, apo se është pak sëmurë? — e pyeti Anilën e ëma.

— Po t'u thuash se është sëmurë, ata vijnë në shtëpi menjëherë. Njerëz të tillë nuk duhen gënjyer, mama. Këtë nuk duhej ta bënte babai në asnjë mënyrë. S'është çudi që ai të mos vijë edhe nesër për ta përcjellë Petritin.

— Ec, dhe mos mendo keq tashti, atë nuk e bën ai, — i tha e ëma, duke u munduar të fshihte shqetësimin e vet.

Të nesërmen në mëngjes, përpara komitetit të

partisë ishte mbledhur një turmë e madhe njerëzish. Niseshin vullnetarët e parë me stazh të gjatë, në veprat e mëdha të pesëvjeçarit. Petriti dhe Anila rrinin me duar të lidhura. Pranë tyre rrinte krekosur xha Tafili, e shoqja, dhe Agllaia, e ëma e Anilës. Spiro Tërpinin nuk kishte ardhur për t'u përshëndetur me dhëndrin. Anila shikonte nga rruga, e shqetësuar. Mungesa e të atit po i rëndonte në shpirt.

«Jo, baba, këtë s'duhet ta bësh», mendonte me vete. Petriti u nda me Anilën, me prindërit, me vjehrrën dhe hipi në autobus.

— Udhë e mbarë, Petrit!... Suksese! Mirë vafsh! Të dëgjofshim zërin e mirë! — dëgjonte ai zërat e shoqëve e të shoqeve të punës që kishin rrethuar autobusin.

— Mirupafshim, Titi! — tha Anila. Në atë çast në sytë e tyre kishte mall, besnikëri e dashuri të pafund.

NE RRENJET E FJALËS QË DHAMË

— Njeriu, që të quhet njeri e të thotë me plot gojën jetoj, duhet të luftojë me jetën, të punojë e të mbjellë në bahçen e madhe pemën e vet. Duhet të lërë një copë të jetës, të mbetet i mirë në kujtesën e njerëzve që lë mbrapa, — më thotë duke ecur Kadri Veliu, kryetari i kooperativës.

Ai flet ngadalë e me ndërprerje, pasi rruga është e përpjetë, e lodhshme. Ngandonjëherë biem në heshtje, dhe secili përtyp mendimet e veta. Pas dy orëve dolëm në Qafën e Malit. U ulëm në bar, poshtë degëve të një lulgëri plak. Era e trëndelinës dhe e rigonit na vërshon në mushkëri, e më duket sikur këto, të pangopura, do të ma shpërthejnë gjoksin e ngushtë. Përposh, në fund të malit, shtrihet fshati i zgjuar, fusha e tij e gjerë dhe më tej deti mbyll horizontin e mjegulluar. Na duhet edhe një orë të mbërrijmë në stanin e parë të dhenve.

— Rrugë e lodhshme, por kjo bukuri të çlodh, — thashë:

— Hëm... kjo rrugë më ka sjellë këtu pas njëzet e ca vjetësh, bile më lidhi përsëri me këtë vend, — ma ktheu Kadriu.

Fjalët e tij i hapën shteg pyetjes sime, por ai ma preu:

— Të ngrihemi tashti, të mos na zërë vapa udhës, pa kemi kohë të bisedojmë.

Derisa mbërritëm në stanin e parë, ai nuk ma hapi bisedën që prisja. Më foli për gjëra të përgjithshme, për të ardhurat nga blegtoria e për jetën e barinjve. Në stanin e parë kryetar ishte një plak. Sinan e quanin. Në dukje, mbahej mjaft mirë, kurse vitet u ngjiteshin të shtatëdhjetave. Kishte një trup të gjatë, duar të ashpra e tërë damarë, të mbuluar nga një lëkurë e argasur në punë dhe e djegur në diell. Ishte plak i muhabetit dhe i rromuzeve. Më vonë mësova se kishte një kujtesë të çuditshme. Na tregonte ndodhi të vjetra, kujtime lufte, kujtime malesh. Ishte njohur në ato brigje me shumë njerëz, të cilëve edhe sot ua mbante mend emrat, me gjithë vitet që kishin rrjedhur.

Pasi u njohëm me jetën e brigadës që drejtonte xha Sinani, u ngritëm për të shkuar në brigadat e tjera. Xha Sinani u ngrit të na përcillte, por ne e kundërshtuam.

— Pse të lodhesh kot, o xha Sinan?

— Ecnì, paçi uratën, e mos ma qani hallin! Këmbët e mia kanë shtatëdhjetë e kusur vjet që ecin nëpër gurë e nëpër maja, janë mësuar. Ato vetëm një herë do të ndalen. Atëherë kur të qëndrojnë për fare.

U nisëm. Xha Sinani përpara, unë pas tij e pas meje Kadriu. Një copë rrugë e bëmë në heshtje. Dëgjohej vetëm zhurma e hapave tona, çaku i shkopit të xha Sinanit nëpër gurë dhe cinxërime e gjinkallave.

— Si përfundoi ajo puna e Selos, more Kadri?
— pyeti papritur xha Sinani.

— E zbritëm në kandidat partie.

— Hëm... më poshtë ta kishit lëshuar.

— Organizata-bazë mendoi t'i jepte dhe një herë dorën.

— Ashtu, or bir, ashtu, por jo zemërgjerë në togun e të gjithëve. Dora i jepet atij që i shket këmba e jo atij që hidhet vetë në buzë. Ti nuk ke të bësh me të, unë e kam dhe nip. Kur u ngrit para dy vjetësh dhe mori zotimin që t'ia falte kooperativës dhjetë qillot e leshit që barinjte i merrnin për t'i bërë gunë, edhe mua më erdhi mirë. Më erdhi mirë, se deshi të hidhte diçka nga e tija në togun e të gjithëve. Por pas zotimit e bëri si ai që thotë: «Mbyllni sytë ju, sa të përtypem unë». Dy vjet rresht i mori vjedhurazi dhjetë qillot e leshit. Jo, Kadri, jo... E kemi thënë që në fillim se si duhet të jetë komunisti.


Këto fjalët e fundit plaku i tha me një ton keqardhës e kërcënues.

— Ke të drejtë, xha Sinan, por... të shikojmë një herë... Çështjen do ta shikojë edhe komiteti i partisë.

— Po, xhanëm, po, — tha xha Sinani duke e hedhur shkopin krahëve.

Heshtje... Ecim. Herë pas here Kadriu del nga rrugica dhe këput trëndelinë e trëndafila të egër. Këtu njeriu ecën i rrethuar nga aroma e tyre, prandaj veprimin e Kadriut nuk e kuptoj. Ç'i duhen lulet?

Kur zbritëm në një gropë të mbuluar nga gjesht-rat, Kadriu u shkëput nga ne dhe mori poshtë fsakave. Përposh, në një gropishte të qëruar, ishte një lapidar i vogël. Xha Sinani më bëri me shenjë të ulesha në hijen e një murrizi, në buzë të rrugës. Ndërsa unë po ndiqja me sy i menduar Kadriun, xha Sinani më preku në sup dhe më tregoi:



— Atje është vrarë një komunist. Kadriu e ka pasur shok të ngushtë, bile ai ia hapi në atë kohë edhe këtij sytë... Ishte një nga ata djem që rrallë i lind nëna. Kishte fjetur kushedi sa herë në stanin tim, me gunën time. Sa herë më kishte folur në këto male për luftën, për lirinë, për këtë jetë që kemi sot!.. Në atë kohë unë e kisha stanin përtej asaj majës. Fshatin e kishin zaptuar italianët. Ai vinte këtu dhe bënte mbledhje me barinj të. Aty, mbi atë ledhin pranë lapidarit, ka qenë një kasolle. Atje ai priste dhe përcillte fshatarët. Sekush bir bushtre spiunoi dhe ia sollti italianët natën. Pa rënë mirë sabahu e rrethuan në kasolle dyzet italianë të armatosur si ata... I folën të dorëzohej... Ai nuk pranoi. U ndez lufta. Ata bam, e ai bam! Ata flisnin të dorëzohej, ai ua priste me pushkë. Pas ndonjë ore, automatiku i tij pushoi. Ata i folën, por nuk morën përgjigje. Me sa dukej ishte vrarë. Pasi pritën një copë herë, ata u nisën drejt kasolles. Kur u afruan mirë, ai doli nga kasollja dhe u hodh mbi ta me dy bomba dore... Aty mbeti i vrarë. U vra me bombat e tij, pasi la aty nëpër gurë shtatë italianë të vdekur. Pasi u larguan italianët, erdhi në stanin tim një bari, që e kishte parë ngjarjen nga ai bregu atje përtej, — xha Sinani tregoi me dorë një kodër të pyllëzuar. — Shkova dhe lajmërova çetën e tij. Atje ndodhej dhe Kadriu. Erdhëm dhe e varrosëm Delinë. Deli e quanin. E varrosëm nën degët e atij lisi. E kam ngritur me këto duar. Këtu e la jetën, i shkreti Deli. E... ç'djalë i dashur që ishte!... Kështu ka qenë lufta, or bir... Kadriu i ka jetuar vetë këto ngjarje. Apo t'i ka treguar?

— Jo. Nuk jemi futur akoma në këto biseda.

— Ee... do të t'i tregojë vetë, besoj. Është rri-

tur në këto vende... Ca kohë desh na harroi, por gje-
ne u kthye prapë në udhët e halleve, — më tha plaku
i qeshur.

Shikimin dashamirës ia kishte lëshuar Kadriut
që po na afrohej nëpër fsaka.

— Epo, ta tokim tashti. Të mbarë e paçi udhën e
u pjekshim mirë! — tha dhe më shtrëngoi fort dorën
me ato duart e rreshkura.

U ndamë me xha Sinanin. Gjinkallat cinxëronin
si të çmendura. Dielli përvëlonte gurët. Lart mbi ko-
kat e lisave të plakur fluturonte një shpend i zi, i cili
herë pas here lëshonte një krakitje të kobshme. Tre-
gimi i xha Sinanit më kishte futur në mendime. Ec-
nim në heshtje. Ma kishte ënda vetëm të mendoja.
Këtë gjë, me sa dukej, e kuptoi edhe Kadriu e nuk
më hapi asnjë bisedë derisa mbërritëm në stanin e
brigadës së dytë.

Në brigadën e dytë ndenjëm për të kaluar vapën.
Ishin pesë barinj. Katër prej tyre flinin në dy mezhda,
në shtretër të bërë me furka druri e të shtruar tra-
shë me fier, kurse tjetri kishte varur shtratin me tela
në hije, në degët e një valanidhi. Tri a katër orë
ndenjëm në mes të barinjve, në botën e tyre plot epi-
sode. Kur më treguan se ç'kishin hequr një natë me
shi e me ujgër, unë i pyeta se pse nuk kërkonin çad-
ra si ato të gjeologëve. Njëri prej tyre më tha me bu-
zën në gaz:

— Jo, a derëzi, se burokratizohemi fare, ia shtroj-
më gjumit dhe i hapim shtegun ujkut.

Në të thyer të ditës, kur dhe era e malit nisi të
freskonte gurët, u ndamë me barinjtë e mirë. Gjatë
gati një ore zbritëm në anën tjetër të malit nëpër një
pyll të dendur mullëzash e ahu. Qëndruam pranë një

shkëmbi të veshur me urdha. Qetësia e thellë e pyllit të impononte mendime vetmie. Kadriu më tha ta ndiqja prapa. Kaluam anës së shkëmbit me kujdes të madh pasi poshtë gjendej një hon i thellë. Në anën tjetër të shkëmbit u futëm në një shpellë. Shpellë e çuditshme! Dukej si një dhomë e hapur në barkun e shkëmbit me duart e njeriut. Freskia që na mbësh-tillte trupin të kujtonte një dhomë frigoriferi. Nga dera e saj e vogël në formë rombi futej pak dritë.

— Ulu mbi atë gur, — më tha Kadriu. Unë po e shikoja kureshtar.

— Të solla këtu për të nisur bisedën që kemi lënë për gjysmë në qafën e malit, foli ai prapë dhe, si hodhi një herë sytë nëpër shpellë, vazhdoi: — E lashë të t'i them këtu, pasi nga kjo shpellë ka dalë kup-timi im mbi jetën... Unë nuk jam nga ky fshat. Shu-më vite më parë babai im erdhi këtu bashkë me mua dhe u fut bari. Iku nga fshati i tij për hasmëri. Mua më futi në shkollën e fshatit, kurse vetë ruante dhentë e një pasaniku të kësaj ane. Unë bëra tre klasë shko-llë dhe fillova jetën e bariut me babanë. Aq ishte shkolla atëherë. Pas tre vjetësh më vdiq nëna. Në mo-shën gjashtëmbëdhjetë vjeç më vdiq dhe babai. Vdiq në mënyrë të tmerrshme. E kafshoi një qen i tërbuar në mal. Unë kisha zbritur në fshat të merrja bukë. Për të mos i lënë dhentë vetëm, ai nuk i kishte vënë rëndësi plagës. E kishte djegur me rigon. Natën e ki-shte gdhirë i sëmurë rëndë. Kur shkova në mëngjes e gjeta gati në gjendje tërbimi. E zbritëm në fshat për ta shpurë në qytet: Më kot. Ishte vonë. Vdiq të tre-tën ditë. Kështu mbeta jetim. E humba fare toruan. Ecja pas dhenve si i shastisur. Po njeriu është i çudit-shëm, ç'nuk kalon! Këtu u ndodha në mes njerëzish të mirë. Ja, ai xha Sinani më hodhi dorën, më mori në

shtëpi dhe s'më ndante nga fëmijët e tij. Punoja, u bëra bari i mirë. Në atë kohë u hap edhe këtu lëvizja për liri. Ja, këtu në këtë shpellë, kam njohur komunistin e parë që më hapi sytë. U lidha me Lëvizjen e pas një viti dola në mal. Para se të ikja, ndenja me xha Sinanin deri në mes të natës. Unë i tregoja për luftën dhe qëllimin e saj. Ai më dëgjoi gjatë, me çibuk në gojë, e, më në fund, më tha:

«Nuk e di si do të bëhen kaq kollaj të gjitha këto që thua, more Kadri. Po, meqë është fjala për udhë të mirë, udha e mbarë të qoftë». Më përcolli deri tej shtëpisë, dhe më tha si me gjysmë zëri: «Ki kujdes të mos vritesh kot, bir i xhaxhait». U puthëm dhe u ndamë. Çeta në të cilën u futa vepronte në këtë zonë. Zbrisnim shpeshherë natën dhe u binim italianëve. Pas ndonjë viti në mal, m'u vra shoku im i ngushtë, ai që më thirri për herë të parë në këtë shpellë. U vra atje lart, te ai lapidari ku ndaluam qëpari. Ndoshta të tregoi xha Sinani për të?

Unë pohova me kokë, dhe ai vazhdoi bisedën:

— E, që të mos zgjatem në historira, eca në rrugët e luftës deri jashtë Atdheut. Pas Çlirimit u caktova me detyra në aksionet e rinisë. Mbarova kurse e shkolle dhe u bëra kuadër. Krijova familje e shtëpi në Tiranë. U bëra edhe me fëmijë. U rrethova, si të thuash, nga të mirat. Unë bariu shpesh shkoja në punë me veturë. Katër vjet para se të vija këtu, më thirrën në byro të komitetit dhe më dhanë një lajm të papritur. Ky fshat më kërkonte për kryetar kooperative, pasi kishte ndërruar nja dy vetë. Nuk erdha. Gjeta arsye e shkaqe. Byroja nuk nguli këmbë. Mbeta si i pazëvendësueshëm, kurse këta fshatarë, në mes të cilëve u rrita, mbetën të fyer. Kisha gati nja katërmbë-

dhjetë vjet, që nuk kisha ardhur këtu. Ato ditë mora një letër nga xha Sinani. Më shkruante këto fjalë:

«I dashur si djalë. Së pari, qofsh mirë. Po ku humbe, more bir, kaq kohë? Si nuk e ktheve një herë kokën prapa, të shkretën? Dëgjo, Kadri. Së shpejti pres të vdes. Kam një merak, përpara se të iki për fare: dua të të shoh edhe një herë. Gjeje kohën dhe eja një ditë, paç uratën! Tashti të dua, Kur të vdes, mos eja fare. Qofsh mirë me gjithë fëmijë».

Mora lejë dhe erdha. Gjatë gjithë rrugës e ndieja veten ngushtë për mungesën e gjatë. Xha Sinanin, për çudi, e gjeta shëndoshë e mirë. Kur i fola për këtë gjë, ai më tha: «Në këtë moshë vdekja aty rri, pas derës, Mbase nuk bëra keq që të thirra. Desha të çmallohesha. Kam një daramet: dua që nesër të ngjitemi në mal bashkë, të çmallohem me vendet e halleve dhe të gëzimeve, pastaj ik e mos eja më as kur të vdes».

Kështu bëra. Nuk ia prisha dot. Të nesërmen erdhëm kësaj rruge që kaluam bashkë. Ishte pothuaj e njëjta kohë. Kur arritëm tek ai lapidari ku është vrrarë Deliu, ndaluan. Atëherë, në vend të lapidarit, ishte një tog me gurë të lyer me gëlqere nga barinjët.

— A të kujtohet ajo ditë, në këtë vend, o Kadri?
— më pyeti xha Sinani.

— Po, — i thashë, i menduar.

— Këtu pranë trupit të Deliut, përpara barinjve, ti dhe fjalën se do të ndiqje gjurmët e tij, do të jepje edhe jetën për lirinë për një jetë më të mirë, të barabartë për të gjithë. «Gjakun tënd do ta kem si pish-tar gjithë jetën». Kështu i the Deliut. Mban mend?

— Po, xha Sinan, — i thashë.

Ai heshti. Unë ndjeva se diçka po më shtrëngonte

gjoksin, po më zinte frymën. Plaku nuk m'i kujtoi pa qëllim fjalët e mia. Nuk dija si ta thyeja atë heshtje që më ndrydhte.

— I duhet bërë një lapidar i mirë Deliut, — thashë.

Plaku ma ktheu, duke më hedhur një shikim të ftohtë: — Kemi dashur t'ia bënim ne barinjte, por pritëm të vije dhe ti.

Goditja e tij ishte e pamëshirshme. Mbeta në hesh-tje. Më dukej sikur do të më shtypnin malet dhe gurët e qivurit të bardhë. Xha Sinani lëshoi një «Ehee!» të gjatë dhe u ngrit.

— Eja të ikim, — më tha.

Prej andej erdhëm në këtë shpellë. Vetë ai e sollu rrugën këtu. Pasi u ulëm si tashti, më pyeti duke mbushur çibukun.

— E mban mend këtë shpellë, o Kadri?

— Më kujtohet pak, xha Sinan.

— Hëm.... — ia bëri dhe vazhdoi:

— Ta kujtoj unë më mirë... Ke hak, kanë shkuar vite... Ja, te ai gur je dergjur ti dhjetë a dymbëdhjetë ditë. Aty të kishim shtrirë. Të kishim shtruar dy pëllëmbë gjethe e fier nën vete. Këtu t'i kemi nxjerrë ne barinjte krimbat nga plaga që kishe marrë nga gjermani. Ti nxorëm me afsinik¹⁾ e lëng rigoni. Këtu e binin barinjte qumështin e dhallën në lëkurë dhie, në sufër, e ti mbështetje buzët në sufër e pije i uritur. Këtu na flisje me aq besim për komunizmin, për arat e të gjithëve. Mban mend?

— Po... m'u kujtuan të gjitha, xha Sinan.

— E ç'vlerë ka së t'u kujtuan këtu? Atje ku je i ke harruar, biri im, të gjitha. I ke harruar fjalët që ke thënë përpara Deliut dhe barinjve. I harrove shpellat ku pije dhallë me sufër, ku u flisje njerëzve të

1) Acid finik

maleve për luftën e lirinë. Kam vendosur të t'i them të gjitha. Ti, po deshe, zemërohu e mos më shiko më me sy. Do të t'i them, se të kam dashur e të dua si djalin tim. Kështu, shoku Kadri, E harrove këtë vend që të mëndi, të njohu me të keqen e të mirën. Ke rënë në rehati atje në Tiranë. Kaluan njëzet e ca vjet e ke ardhur vetëm një herë. Nuk them se andej ke ndernjur këmbëkryq... Ne nuk kemi dëgjuar të liga, por, ama, kur fshati të kërkoi ta ndihmoje, të ktheheshe këtu, ti nuk pranove. Helbete, je mësuar të shikosh lart dhe harrove nga u ngjite. Fshatarët nuk e prisnin këtë. Them fshatarët, se ti nuk i përket vetëm xha Sinanit, por të gjithëve, se të gjithë të kanë ndihmuar e të kanë dëgjuar kur u bëre i luftës e i lirisë. Shumë vetë menduan të të kërkonin lart në Parti, e po të vinte fjala atje, ti do të vije, bile jo si kryetar, por edhe si bari i thjeshtë. Unë u thashë: ma lini mua në dorë këtë punë, ta provoj një herë ndryshe. Unë e kam më në zemër se ju. Dhe ata u treguan zemërgjerë e ma lanë. Ti ke planet e tua në jetë, more bir, por unë do të t'i them fjalët e të tjerëve dhe të miat: i ke lënë, Kadri, të thahen rrënjët e fjalëve që ke dhënë në këto male, në këto shpella.

Këtu plaku heshti e nxori qesen të mbushte çibukun.

Mua sa s'më zuri shpella. Isha ndodhur ngushtë në luftë, përpara detyrave të ndryshme që më ishin besuar. Kisha pasur raste të përgjigjesha edhe para ndonjë personaliteti partie për ndonjë dobësi, por asnjëherë nuk e kisha ndier veten aq të ndrydhur sa aty, në atë shpellën me urdhe, përpara xha Sinanit, që tymoste çibukun dhe rrinte sikur aty në shpellë të kishte ardhur për ndonjë ngushëllim.

— Ngrehu të ikim, — më tha, — se vajti vonë. Po bie dielli në det.

Është e vështirë të besosh se dy vetë mund të udhëtojnë gati një orë në heshtje, sikur për një fjalë të dënoheshin me vdekje. Atë natë xha Sinani bëri përsëri darkë, bile ftoi edhe katër a pesë fshatarë. Biseduam për shumë gjëra. Ata e hidhnin gjithmonë fjalën në kujtime të vjetra. Asnjëri nuk ma kujtoi kërkesën për të ardhur në fshat. Nuk di, i kish porositur xha Sinani, apo ata vetë e gjetën atë formë edukimi.

Të nesërmen, kur u ndava me xha Sinanin, i thashë:

— Do të mendohem mirë, xha Sinan, për të gjitha ato që më the e që mësova këtu.

— Mirë, bir i xhaxhait, si ta shikosh të udhës. Qofsh komunist si atëherë në male e në shpella, — më tha, më shtrëngoi për qafe dhe më puthi.

Gjatë gjithë rrugës peshova çdo gjë. U ngjita shkallëve të shtëpisë me vendimin e prerë të kthehesha këtu, te rrënjët e fjalës që kisha dhënë. Erdha këtu para katër vjetësh. Kërkova të më caktonin bari, po nuk deshën. Fillova si brigadier blegtorie. Pas një viti e gjysmë më zgjodhën përgjegjës sektori e tani po bëhen nja dy vjet që më ngarkuan detyrën e kryetarit. Punët ecin mirë. E pse të mos ecin? Bëje fjalën punë, që njerëzit të të ndjekin e të të kenë në zemër!

NË BUZË TË GREMINËS

Ish-drejtorin tonë ju nuk e njihni, jo se është i vetmi i llojit të tij, po ngaqë mund ta ngatërroni edhe me ndonjë tjetër. Prandaj po ju njoh me të: ka një trup mesatar, fytyrë të gjerë, të rrumbullaktë, të shëndetshme, e flokë gjysmë të rënë.

Unë e njoh atë më mirë nga të gjithë, ngaqë kam qenë shofer i tij. Me mua ai udhëtonte kudo. Pranë meje në makinë bisedonte me eprorë dhe vartës të tij. Kur ndodhte që ndonjë epror i tërhiqte vërejtje, ai bëhej mjaft i arsyeshëm, ndërsa kur e lëvdonin, harrohej fare e nuk kujtohej të maste, pa të priste. Unë e kam parë atë të qeshur, serioz, të mërzitur, bile edhe të dehur në ndonjë dasmë ose darkë. Nuk kishte si të fshihej nga unë. Unë e di se deri ku i arrinte koka, megjithëqë karshi vartësve ai qëndronte me hije të rëndë.

Shumë vetë nuk e besonin shokun Hajdar kur u thoshte se i kishte përcjellë të pesëdhjetat. Ai nuk kursente asnjë formë për ta bërë jetën vaj. Drejtori im kishte dobësi për gostitë, ishte qejfli i madh e mjaft i këndshëm në buzësofër. Natyrisht unë s'mund t'ju flas për gjëra intime të shokut Hajdar. Do t'ju tregoj vetëm një episod të jetës së tij:

Një ditë ishim ulur në bar-bufe «Plepi» në buzë të lumit. Shoku Hajdar kishte përpara dopion e dytë, kurse unë një gotë birra. Kamarieri na i përsëriti pijet pa i thënë.

— Ç'ne këto? — e pyeti shoku Hajdar.

— I kini nga ai shoku te tavolina poshtë plepit, — na tha.

Kthyem kokat andej. Një fshatar i veshur me kadife blu, rreth të pesëdhjetave, na buzëqeshi duke zbuluar ca dhëmbë të mëdhenj, të fuqishëm. Kishte ngritur gotën e rakisë në shenjë përshëndetjeje.

Përshëndetjet e rastit nga ndonjë i panjohur për shokun Hajdar nuk ishin të papritura, megjithëkëtë i dha të kuptonte se nuk po e njihte. Fshatari e ktheu gotën e vet dhe, si mori diçka nga tavolina, erdhi drejt nesh.

— Jam një miku i shokut Xhavit, i ati i Selim Be-shirit, që e kini marrë ju në punë.

— Ëhë... po si je, si ia çoni nga fshati? — pyeti me dashamirësi e duke i shtrënguar dorën shoku Hajdar.

Pastaj fshatari më zgjati dorën edhe mua. Hapi një gazetë dhe la mbi tavolinë dy kofshë të pjekura pule, një kokërr hudhër të madhe dhe një spec djegës.

— Ç'janë këto, ç'bën, or burrë? — i tha drejtori si pa qejf.

— Mos ma prish, të lutem, bile më vjen keq që erdhët vonë. Sot kisha një gëzim dhe e kishim pjekur një nga ata të detit në furrën e klubit.

— Po ç'gëzim ke kështu? Pa ulu, de, ulu, — ia priti drejtori.

— Më falni, se jam me një mik nga Tirana. Ai do

të ngrihet tashti dhe më duhet ta përcjell deri në Fushë-Mëris.

— Po ç'gëzim ke kështu? Të paktën të të urojmë.

— Një herë tjetër do t'jua them, — tha i nxituar dhe, pasi i mori dorën shokut Hajdar, shtoi: — Besoj do na dilni ndonjë natë... Eh, pardje kisha shokun Xhavit, kaluam bukur. Unë nuk jua shpërblej dot nderin që më keni bërë.

— Aaa... më vjen keq... Ç'bëra unë?! E futa në punë djalin tënd. Epo, puna e shtetit është, zanatin e tij punon, se mos i dhashë çelësin e zyrës!

— Sidoqoftë... Do na vini një natë. E kam porositur dhe atë të humburin t'ju thotë nga ana ime, po ai druhet. — Këtu fshatari e kishte fjalën për të birin, që punonte shofer te ne.

— Faleminderit, të shohim njëherë, — tha shoku Hajdar.

Fshatari u largua duke tundur trupin e rëndë. Mua nuk ma dha dorën.

Nga mbasditja e së shtunës drejtori më porositi ta bëja gati makinën. Ndërsa dielli po shkiste avash-avash në perëndim, drejtori zbriti shkallët e zyrës bashkë me Selimin, djalin e fshatarit që na gostiti në bar-bufe. Pas ndonjë gjysmë ore udhëtimi në asfalt, Selimi, i cili ishte ulur pas meje, më tha pranë veshit:

— Ngadalë. Më tej asaj urës do të kthehesh në të majtë.

U futëm në një rrugë të drejtë tërë gropa, që çante përmes parcelat e tokave të kooperativës, bujqësore të Buklinjës. «Gazi» kërcente nëpër gropa. Drejtori mbahej fort në mbështetësen prej meshini. Nganjëherë më bënte shenjë për të ulur shpejtësinë, pas-taj pyeste Selimin për gjëra të zakonshme, dhe ai i

përgjigjej me zell. Pas ndonjë orë lëkundje nëpër atë rrugë të dëmtuar nga traktorët, Selimi më mbështeti dorën në sup dhe më tha të kthehesha djathtas. Tani zëri i tij tingëllonte me ton gati urdhërues. Zaten në shtëpinë e tij po vinte drejtori për darkë! Edhe një copë udhë nëpër lëndinë, dhe u ndalëm pranë një shtëpie dykatëshe, të rrethuar nga një grumbull pemësh frutore.

Selimi zgjati dorën mbi supin tim dhe shkeli butonin e borisë, pa më përfillur mua si zot i asaj pune. Drejtori zbriti nga gazi. Nga një shteg që humbiste në grumbullin e pemëve doli fshatari me të cilin u njohëm para një jave në bufenë «Plepi». Zgjati që tej duart dhe, duke u tundur si patok i rëndë, u gjend përpara drejtorit.

— Oho, mirë se urdhëruat, shoku Hajdar, mirë se erdhët! . . . Sa ma bëtë qejfin. . . Ju lumshin këmbët. . . Urdhëroni, urdhëroni! — dhe tregonte udhën e shtegut me dorë. Mua më harroi fare, qerratai. Vetëm kur drejtori e pyeti se ku mund ta linim makinën, ai u kthye nga unë, më zgjati dorën dhe i tha Selimit:

— Futeni nga ana tjetër, përpara oborrit.

E lamë makinën pranë një kasolleje me mur guri e të mbuluar me kashtë. Te dera e kasolles dy lopë qumështore kruanin njëra-tjetrën. Në oborrin e shtëpisë u tremb nga ne tufa e madhe e pulave të detit. Dy gjela të rëndë bënë «gërduf-gërduf» e ia dhanë nja dy herë këngës, si të donin të merrnin pjesë edhe ata në gëzimin e të zotit. Nuk e di ç'dreq më shtyti të mendoj se cili nga ata po këndonte për herë të fundit. . .

Mbi kalldrëmin e rregullt të oborrit kishin rënë nga pemët e shumëllojshme fletët e para të verdha. . .

U ngjitëm në katin e sipërm me shkallë të jashtme, u futëm në një dhomë të madhe, të shtruar tejmbanë me qilima tërë ngjyra. Në tri anët e mureve ishin vendosur jastëkë të gjatë e të mbushur mirë. Poshtë një oxhaku të lartë një zjarr bubulak lëshonte flakë të kuqërreme. Jashtë nuk kishte nisur akoma të ftohtit, po, me sa dukej, i zoti i shtëpisë donte ta priste sa më ngrohtë shokun Hajdar.

— Po si je, shoku Hajdar? Si i keni nga shtëpia?
— e pyeti sërish i zoti i shtëpisë drejtorin, duke i shtrënguar dorën me dy të tija.

— Të faleminderit, Dyl Beshiri. (Kështu quhej i zoti i shtëpisë) Ju si jeni këtej?

— Shyqyr, s'ka më mirë... Me punët e ndër-marrjes si shkoni? — dhe, pa pritur përgjigje nga drejtori, shtoi: — Besa të fortë jeni me këto përgjegjësitë... Se si ia dilni, ju qofshi!... Një shtëpi kemi përsipër dhe e humbasim nganjëherë. Ju mbani mbi shpinë miliona të shtetit, pale hallet e njerëzve!

— Po ç'të bësh, or Dyl, kështu është kjo punë, u mësuam tanimë, — ia ktheu drejtori, duke e fshehur kënaqësinë që ndiente në raste të tilla. Të përkëdhelurit e sedrës ishte pika më e dobët e drejtorit tim. E të gjithë ata që ia kishin nevojën, i binin gjithmonë fyellit në atë vrimë. «Po ky bablok nga ia njohka zakonin?» mendova me vete.

Në dhomë u fut një nuse e bukur, tërë shëndet. Flokët e zez të dredhur i kishte mbledhur në një shami të hollë, të bardhë. Ajo iu afrua drejtorit dhe i zgjati dorën.

— Është nusja e djalit, e Selimit, — ndërhyri menjëherë Dyl Beshiri.

— Ashtu?... Si je nuse?

— Faleminderit, mirë... Ju si i keni nga shtëpia? — u përgjigj ajo e druajtur.

— Po plakën ku e ke? — pyeti me të qeshur drejtori të zotin e shtëpisë, pa ia lëshuar dorën nuses.

— Aaaa... mos më lëndo plagën, drejtor... Ka nja dhjetë ditë që ka shkuar te vëllezërit dhe më ka nxirë shtëpinë... Nuk më shkon dita pa të... Ha-ha-ha! — qeshi duke u shkundur Dyl Beshiri.

Qeshi dhe drejtori, që tanimë e ndiente veten si në shtëpinë e vet. Pas nuses erdhi një grua e veshur në kafe. Duhej t'i kishte zënë të pesëdhjetat. Ajo ishte e motra e të zotit të shtëpisë. Me sa mësova më vonë nga Selimi, ajo, halla e tij, kishte mbetur e vé nga dy martesë. Si e pafëmijë, kishte ardhur te i vëllai e priste që vitet të rrokulliseshin...

Dy gratë kaluan në dhomën tjetër, nga vinin erëra të këndshme gjellësh, që na ngacmonin gjëndrat e sekrecionit.

* * *

Mbi sofrën e madhe të rrumbullaktë, që u vendos përpara gjunjve tanë, zbritën mezetë, si për një gosti që ndodh pak herë në jetë. Përpara shokut Hajdar zuri vend një gjel pulastreni, i pjekur përbukuri. Përpara secilit nga një pjatë me mish pule, e pranë tyre patate të fërguara, turshi e djathë shtëpie, specë djegës e hudhra kokëmedha.

— Epo, të pimë nga një gotë, — e mori fjalën i zoti i shtëpisë. — Mirë se të pruri e mira, shoku Hajdar, t'u rritë ndera!

— Nder e të mira paç në këtë shtëpi, Dyl Beshiri, po... kot je harxhuar kaq shumë!

— Mos e fol atë fjalë! Ç'harxhim është ky, shoku Hajdar?

Orët kalonin, gotat rrëkëlleheshin e mezetë shtynin njëra-tjetrën. Megjithëse në sofër ishim vetëm katër veta, biseda, shakatë e të qeshurat e mbushnin dhomën e madhe. Kur bëhej çakërçejf, shoku Hajdar kishte humor të këndshëm. Se nga i gjente ca episode nga më të ndryshmet e të shkrinte gazit! Kur ishte në shoqëri të gjerë, ia kishte qejfi të vinte ndonjërin përpara me raki. Mirëpo atë natë Dyl Beshiri nuk kishte ftuar njeri. Kushedi pse, ndoshta ngaqë donte të ishte vetëm me drejtorin, të lidhte sa më thellë miqësinë. . .

— Pi nga pak, shoku Hajdar. . . Hajde, gëzuar, lart e më lart! Unë e kam pasur zakon: kur gjeja punë, rrëmbeja kazmën kudo. Por, ama, dhe kur më dilte përpara kjo e uruar, e thaja. Hà-ha-ha! — u shkund së qeshuri i zoti i shtëpisë.

Një shishe litroshe u rrokullis e boshatisur në qilim e në vend të saj hipi tjetra. Nusja e bukur dhe vejusha e plakur hynin e dilnin nga dhoma me pjata në duar. Në shishen e dytë po ulej niveli, nga sofrja kërcenin koskat në një tepsi të bardhë. Nga bollëku që dukej mbi sofër duhej të kishin kaluar në gijotinë nja dy pula deti e një pulastreni i posaçëm për shokun Hajdar. Ndërsa po afrohej fundi i pulastrenit, përpara drejtorit u afrua një gjoks dyllë i verdhë.

Akrepat e një ore të moçme mbi oxhak shkelën njëri-tjetrin mbi numrin dymbëdhjetë të natës. I zoti i shtëpisë ngriti dy dolli dhe i rrëkëlleu: njërën për drejtorin («Të kishte fat, lart e më lart e t'i bëheshin ferrë për këmbe të mirat e kësaj bote!») dhe tjetrën

për familjen e shokut Hajdar. Drejtori u përgjigj flakë për flakë.

Nga shakatë e të qeshurat, i zoti i shtëpisë kaloi në një këngë. Ishte nga ato këngë që i këndojnë shpesh mbi avullin e trapezave të dasmës. Dyl Beshiri e pati të vështirë në fillim, po kur në dhomë u lëshua zëri i trashë i drejtorit, kënaqësia e të zotit të shtëpisë arriti kulmin. Shoku Hajdar i kishte shumë për zemër këngët, bile i vinte plasje kur zëri i çirrej papritur. I pëlqente shumë kënga «Te selvia e namazgjasë. . .» Me sa dukej trupi i shëndetshëm i Dyl Beshirit mbahej më tepër përpara avullit të rakisë.

Drejtori ishte bërë në qejf. Më lëshoi mua një shpullë shpatullave dhe, duke fshirë qafën e djersitur me një shami të bardhë, tha:

— Ta hajë dreqi, njeriu duhet të zbërthehet, të dëfrejë një çikë. Një herë jeton në këtë botë! Vdekja na merr të gjithëve. . . Mbetëm të mbyllur në atë seriozitetin zyrtar. . . Hajde, ngrije një për Shaqon — (Shaqo quhet plaku im).

— Ta pimë një për shokun Xhavit! — na e priti i zoti i shtëpisë. Drejtori e ktheu për atë. Më erdhi plasje që dollia për plakun tim u kthye për shokun Xhavit, punonjës me përgjegjësi në komitetin ekzekutiv. E pse? Vetëm ngaqë plaku im nuk e ka ndajshimin «shoku».

E pashë se shoku Hajdar po rrokullisej në mjegullën e rakisë nëntëmbëdhjetë gradëshe. U mundova me takt t'i thosha diçka. Të them të drejtën, kisha frikë se mos nxirrte ndonjë konkluzion tjetër më të dyshimtë se ai më sipër. Por ai, si zakonisht, u vrejti dhe më tha: «Ta kam thënë një herë punën e bishtit dhe të sqeparit!»

Hoqi xhaketen.

Kishte ardhur ai çast që nga goja e të zot të shtëpisë përdorej lirisht emri i drejtorit, pa përmendur ndajshkrimin «shok». Ata lëshonin ndonjë shaka aq të guximshme, saqë nusja e bukur e Selimit kthente mënjane sytë e mëdhenj, si ullinj Berati.

Selimi, çakërcejf, rrëmbeu çiftelinë dhe ia mori një kënge trimash. Drejo punë! Më vinte inat që ai këndonte aq mirë, saqë shokun Hajdar e bëri për vete.

— Mor po qenke artist, more qerrata Selim! — i tha shoku Hajdar.

— Aaa... Këtë e kam çakmak, shoku Hajdar, por ma hëngri shpirtin për të marrë atë patentën e nafiës. Është me zamet ai kursi, s'ia kam gjetur dot anën, — i tha afër supit Dyli dinak.

— Mos e vër veten në mundim, he burrë, punë që ndreqet ajo, — i tha drejtori e, pasi më shikoi mua, tha: — Fundja e kemi detyrë t'ju rrisim aftësitë profesionale njerëzve.


Unë po kafshoja buzën e poshtme për të provuar se sa thellë kishte shkuar rakia. Kuptohet se do të flinim aty, e unë nuk kisha ndonjë udhëtim, po dreqi i di të papriturat. Kushedi ç'i hipte në tru shokut Hajdar e më niste natën.

— Or Dyl!

— Urdhëro, drejtor, — iu përgjigj babloku duke fshirë buzët me një shami të madhe të shpalosur.

— Nuk më the, ç'gëzim kishe atë ditë që u takuam në lulishte, që ishe me atë shokun nga Tirana?

— Ëhë... eh... Ai shoku është me punë në Tiranë. Xheç ka në dorë andej. E kam mik, është qejfli i madh gjuetie. Zanati na ka njohur, e tashti më kujton herë pas here. I isha lutur të më rregullonte dja-



lin e vogël në atë shkollën e zanateve. Më kishte mbetur dreqi nëpër këmbë, pale që nuk para mësonte mirë; mezi mbaroi të tetën. Po ma mbylli miku atë hall. Atë ditë që u takova me ju, ai e mori djalin me vete.

— Ashtu? Epo, hajde, gëzuar, suksese të ketë! — tha shoku Hajdar.

— Hejvallah!.. Të marrë një zanat, shejtani, të mos mbetet si unë me bel në dorë...

* * *

E kisha lënë «gazin» jashtë ndërmarrjes dhe po haja mëngjes në mensë. Kur u ktheva dhe hapa portën e makinës, më trembi gërgëllisja e një gjeldeti. «Hou, po ky ç'është?» thashë dhe zgjata kokën pas sediles. Një gjel kokorosh më shikonte jo si i zënë në faj, por sikur donte të më thoshte: «Ç'e hap atë portë pa takt, ore, na trembe!» Ktheva kokën për të parë përreth. Nga porta e ndërmarrjes po vinte drejt meje Selimi, djali i Dyl Beshirit.

— Oboboo... U tremb burri i botës nga gjeli! — thoshte ai duke u zgërdhirë. Pranë portës po shikonin me vëmendje dy-tre shoferë.

— Ç'është ky, pash besën? — e pyeta.

— Çoje deri në shtëpi të drejtorit, se më hëngri veshët plaku, të shkretën. Ka pesëmbëdhjetëvjetorin e djalit të premtën shoku Hajdar, nuk e di ti?

Unë e dija shumë mirë këtë ditë të shënuar, po sesi më kishte dalë nga mendja atë ditë.

Bashkë me Selimin e shpumë gjelin në shtëpi të shokut Hajdar.

Të nesërmen në mëngjes, një grup i madh punëtorësh ishte mbledhur te vendi i tabelës së emulacionit. U afrova dhe unë, kureshtar. Ç'të shoh! Tre shoferët, që një ditë më parë dëgjuan këngën e gjelit në makinën time, kishin ngjitur në tabelë një fletërrufe. E nisnin me këngën e gjelit e futeshin nëpër hatëret që mbante shoku Hajdar.

«Selim Beshiri nuk ka pesë muaj që ka filluar punë në ndërmarrjen tonë, por iu dha makinë e re dhe e drejta për të vazhduar kursin e naftës. Ç'merita ka ky shok, ç'ka bërë? Pse nuk u pyet kolektivi?» pyesnin tre shoferët në fletërrufe. Në fund tre kolegët më hiqnin edhe mua një fshikull. Pse e lija makinën të harbonte në qefe personale?

Fletërrufeja u prit me bujë. Kishte ndodhur edhe herë të tjera të kritikohesh shoku Hajdar, sidomos kur plani nuk realizohej dhe hatërlleqet e tij vazhdonin, por jo me fletërrufe e kaq ashpër, si këtë herë. Sa herë ngrinte kryet kritika e guximshme, përkrahësit e shokut Hajdar viheshin në lëvizje: dikush përgënjeshtronte një fakt, një tjetër e shikonte drejtorin nga «zemërgjerësia» e tij, një tjetër, me shumë marifet, hapte fjalën se drejtori ka punuar për vete, i ka pesë miq, sa për të mos ia shkukur rrënjët. Kështu fashitej flaka e kritikave, por këtë herë u ishte vënë një rreth i hekurt këtyre fjalëve. Atë ditë që u vendos fletërrufeja nga tre shoferët, Selim Beshiri, i biri i mikut të drejtorit, ishte kapur nga kontrolli kooperativist në një shkelje të rëndë: në vend që të shkonte në punë, sipas fletudhëtimit, e kishte ngarkuar makinën me zhavor dhe kishte shkuar në fshat për të shtruar avllinë e shtëpisë së vet.

U krijua një pështjellim i madh. Në mbrëmje

fletërrufeja u hoq. U hap fjala se e hoqën për ta studjuar shokët e drejtorisë. Përgjigje nuk u kthye. Ky gjest ndezi pakënaqësinë e të gjithë punëtorëve. Shqetësimi doli nga muret e ndërmarjes dhe pas pesë ditësh te ne erdhën shokë nga komiteti i partisë. Vazhdoi një mbledhje e gjatë atë ditë, ose më mirë atë natë, pasi me ditë e filluam, por e mbaruam natën vonë.

Rrallë kishte ndodhur mbledhje e atillë. Ishte hera e parë që shoku Hajdar nuk u ul në presidium. Secili atë natë zbërtheu veten, punët dhe drejtorin. E në fund fjalët e të gjithëve u shkruanë në mendimin se shoku Hajdar e kishte mbushur kupën, kishte harruar forcën e atyre që e hipën në «Gazin 69». Prej asaj dite shoku Hajdar nuk hipi më në gaz. Filloi një punë të re, ku do ta vrasë samari. Besoj se tani e ka marrë vesh se jeta s'është vaj, që ai të shkasë si ngjallë. Kjo puna e re do t'i bëjë mirë edhe në një drejtim tjetër: do të tresë ca dhjamët e do të bëhet i shkathët, si djalë i ri, se ishte rënduar ca si shumë.

Edhe unë nuk u ndava lehtë. Shokët ma hoqën të drejtën e profesionit për një vit, me motivacionin e thjeshtë, bile me pak humor: «Ka lënë makinën të harbojë pas shokut Hajdar».

Pra sot po ju flas nga reparti i xhenerikëve, ku mësoj nga jeta për të ecur drejt midis njerëzve.

SHPELLA E GJERMANIT TË SELFOS

skicë

Po binte mbrëmja. Bashkë me kryetarin e kooperativës po ktheheshim nga fusha. Kur dolëm në një kodër përballë fshatit, u ulëm për t'u çlodhur. Shtëpitë e fshatit shkëlqenin mes gjelbërimit të pemëve nga rrezet e fundit të diellit. Në fund të fshatit ishin muret e rrënuara të tri-katër shtëpive; poshtë tyre ishte një arë e mbjellë e pastaj një kodrinë shkëmbore, që zbriste thikë deri poshtë në një përrua të thellë.

— Atje, në atë hundën në buzë të përroit, ku ngrihet ai shkëmbi i thepisur, është bërë një përleshje e ashpër me një skuadër gjermanësh — më tha kryetari i kooperativës. — Ishin nja katërmbëdhjetë veta. Ishin shkëputur nga kompania e tyre dhe, të ndjekur nga partizanët, u futën në fund të fshatit. Fshatarët i pritën me pushkë. Ata dogjën dhe shkatërruan tri-katër shtëpitë e fundit. . . Ja, ato që u duken muret e rrënuara. Mëngjesi po hapte. Ata u gjendën të rrethuar keq. Në tri anët i priste pushka e fshatarëve dhe e partizanëve, kurse në këtë anë, prapa tyre, ishte ajo gremina e shkëmbit.

U ndez një luftë për vdekje. Komandanti i çetës

partizane udhëzonte me zë të lartë. Fshatarët bërtisnin: «Bjeruni qafirëve! O burra t'i zëmë të gjallë!...» Unë isha shtrirë me një pushkë italiane në ca gurë atje, në mes të arës. Ara nuk ishte atëherë. Gjermanët çirreshin e i bërtisnin njëri-tjetrit në atë gjuhën e tyre. Ç'gjuhë të çuditshme kishin! Të folurit e tyre sepse më kujtonte lehjen e një qeni dhensh. Pranë meje ishte shtrirë një fshatar. Selfo e quanin. Është dëshmor tashti. U vra atë ditë. Selfos i kishin djegur shtëpinë. Akoma flakët nuk ishin shuar në shtëpi, kur ai po luftonte me një gjerman. Për çudi të dyve iu mbaruan fishekët. Selfoja u ngrit më këmbë. Edhe gjermani u ngrit. Bëri të tërhiqej, po Selfoja iu gjend pranë. U përfytën. Secili shante në gjuhën e tij. Shtëpia e Selfos lëshonte akoma flakë. Duke u përfytur me njëri-tjetrin, iu afruan shkëmbit. Unë, i trembur, i brita Selfos të ruhej nga gremina. Një tjetër nga fshatarët i tha:

— Mbertheje për fyti qafirin, gremise në Shpellën e Ujkut.

Kërkoja rastin për të qëlluar në trup të gjermanit, por Selfoja ishte shtrirë përtokë me gjithë të. Pa pak Selfoja u ngrit më këmbë e mbi kokë kishte ngritur dyfekun si dajak për ta qëlluar. Gjermani u ngrit dhe i dha trupit prapa me gjithë forcë. Iku pa mend që të shpëtonte kokën, por shkau në greminë e ra përposh, duke lëshuar një britmë të llahtarshme, të çjerrë. I bërtita Selfos të shtrihej, por nuk arriti. Një ushtar gjerman qëlloi dhe e vrau. Kur ra dielli në fshat, lufta kish mbaruar. Shtatë gjermanë ishin vrarë. Gjashtë u dorëzuan. Në mes tyre edhe një oficer. Kishte një trup të gjatë e të dobët. Në fytyrë ishte bërë dyllë i verdhë. Një kushëriri i Selfos iu hodh në

fyt oficerit dhe desh ia nxori shpirtin, por komandanti i partizanëve ia shqiti nga duart dhe i tha:

— Jo kështu, shok! Mos i bëj duart me kërmë... .

Katër pesë veta morën Selfon. Njëri po numëronte gjermanët. I dilnin eksiq.

— Tamam janë, tamam, po njërin e vërviti Selfoja në Shpellën e Ujku, — tha një tjetër.

Kryetari heshti një çast, tundi kokën dhe vazhdoi:

— Interessant! Nja shtatë vjet përpara kësaj ngjarjeje, dy kushërinj të Selfos, barinj, hodhën nga buza e greminës një ujku. Aty në atë shpellën përposh shkëmbit u tret ujku, aty u tret edhe gjermani. Prandaj fshatarët edhe sot, ca i thonë «Shpella e Ujku», ca «Shpella e gjermanit të Selfos».

Kryetari mbaroi së rrëfyeri e më tha të ngriheshim, po unë ndërkaq i kisha hedhur sytë përtej në gardhin e një bahçeje, ku kishin stisur një dordolec qesharak për të trembur sorrat. Në kokë i kishin vënë një helmetë të shpuar, nga ato të ushtrisë së «pattyeshme» të Hitlerit. Nuk di pse, dordoleci më kujtoi Don Kishotin... .





DRITË MBI GJAK

Skicë

Nga ana e lindjes horizonti kishte marrë një ngjyrë të përflakur. Disa re të vogla, që ishin grumbulluar tej, në grykën e malit, dukeshin sikur po grindeshin me njëra-tjetrën, kush e kush ta merrte më parë buzëqeshjen e diellit. Shefkiu mbështeti të dyja duart mbi bishtin e lopatës dhe ra në mendime...

Ishte e treta ditë që Shefki Derini kishte ardhur me shërbim aty nga një postë e kufirit bregdetar. I kishte lënë të dyzetat, por kishte një trup të lidhur,

të fortë e të formuar gjatë një jete intensive. Njëzet e pesë vjet Shefkiu kishte jetuar në kufirin që ndan dy botë. Sa kujtime kishte grumbulluar gjatë këtyre viteve! Sa çaste emocioni, shqetësimi e përgjegjësie kishte provuar ndërgjegjja e tij!... Ai ishte ndeshur me armiq që kishin ardhur nga deti dhe nga toka. I kishte pritur ata kurdoherë me gjoks, dhe kjo pritje tanimë i ishte bërë pasion. Por, siç dukej, në atë çast nuk e kishte mendjen aty, nuk mendonte për këto.

Hodhi sytë përreth, sikur të hetonte diçka, pastaj uli kokën dhe i fiksoi sytë në tokën e zbrujtur para këmbëve të tij. Aty kishte nisur hapjen e një grope. Një curril uji rrëshqiste ngadalë, i heshtur dhe humbiste pak më poshtë në fierin e dendur. Ngriti përsëri kokën dhe hodhi sytë nga një rrap i moçëm. Një kujtim i vjetër i atij vendi ia përzjeu mendimet. Nga zemra iu ngjit një ngacmim dhe i pushtoi gjithë qenien. Për një çast iu duk sikur kishte mbetur vetëm në mes atyre kodrave të heshtura. Kënga e gjinkallave të korrikut i dukej si një avaz vajtimi. «Po, po, këtu... Ja guri i shtufit. Ja edhe rrapit i moçëm. Sa shpejt kaluan vitet!»

Këto mendonte me vete kufitari i vjetër. Ai harroi çdo gjë që e rrethonte. Ashtu i mbështetur në bishtin e lopatës, kishte dëshirë të sillte ndër mend ato kujtime që ia kishte mbulluar mjegulla e viteve, t'i ndiente, të jetonte me to. Por ja që nuk e lanë: ushtarët e tij dhe një grup kooperativistësh po zbrisnin me ngadalë shkurret, duke mbajtur në krah katër shtylla të linjës elektrike.

Shefkiu u shkoi në ndihmë.

— Hë, më të lumtë, shoku komandant! I paske hapur dy gropa! — tha një fshatar e, si e shikoi në sy, shtoi: — Por qenke lodhur veç!

— Jo dhe aq, — iu përgjigj Shefkiu dhe shtoi: —
Hë, a u plotësuan gropat e sipërme me shtylla?

— Po, po, gati janë. Tani duhet të vendosim një
te ajo pema drejt nesh dhe të vazhdojmë më poshtë
me tri të tjerat, — u përgjigj brigadieri i kooperativës.

— Jo, atë shtyllë do ta vendosim këtu. S'ka gjë
se devijojmë pak.

— Po ne e kemi piketuar dje me Aliun (kufitar
Aliu kishte profesionin e gjeometrit) dhe atje i bie
tamam në vijë të drejtë. Po ta ngulim këtu, linja merr
një kthesë të fortë.

— S'ka gjë, shoku brigadier, nuk prish shumë
punë; korenti kalon pa rreziqe edhe në kthesë, — i
tha komandanti si me të lutur e me buzë në gaz. Pas-
taj, si heshti një grimë, vazhdoi:

— Këtu duhet ta vëmë, pikërisht këtu duhet një
shtyllë. Bile do të vëmë edhe një dritë!

Kufitarët dhe kooperativistët u habitën nga fja-
lët e tij. Shefkiu e kuptoi këtë dhe e theu heshtjen:

— Dëgjoni ku e kam hallin. Unë kam qenë një
herë në këto anë, por jo për qejf. Atëherë ish kohë
lufte. Ka qenë qershori i vitit dyzet e katër. Ja, këtu,
një javë rresht u përleshëm me armiqtë. Këta përrenj
u bënë atëherë varri i armikut. Në këto kodra rrodhi
dhe gjak partizanësh. Ja, mu këtu. . . E shikoni këtë
ujë? Ky buron aty, te rrëza e këtij shkëmbi. . . Pikë-
risht pas atij shkëmbi kisha zënë pozicion atëherë me
një partizan, një shokun tim të ngushtë. Shaban e
quanin. Ish trim i tërbuar. Sulej mbi armikun pa u
kujtuar se plumbi e hante. Sa herë e kishim këshillu-
ar që të ruhej, të ishte më i kujdesshëm! Por ja, atë
ditë një plumb e goditi për vdekje. . . Unë s'e kisha
mendjen. Vetëm kur pushoi automatiku i tij, ktheva

kokën dhe e pashë. Shoku im po rrëshqiste pranë shkëmbit. Iu hodha sipër, e rrëmbeva në krahë dhe e shtriva këtu, në këtë vendin e sheshtë. I zbërtheva xhakëtën. Në anën e djathtë të gjoksit, nga dy vrima plumbi, po rridhte gjak... Ç'të bëja? Ai kish shtrënguar nofullat dhe sytë i mbante gjysmë të mbyllur. Nuk më besohej se do të vdiste. Më dukej çudi. Isha rritur me të. Bashkë kishim qenë hyzmeqarë tek bejlerët e Durrësit. Bashkë kishim qeshur e kishim qarë. Bashkë u vumë zjarrin hambarëve të beut dhe dolëm partizanë. Dhe ja, erdhi një çast që ai ndodhej në duart e vdekjes dhe unë nuk kisha se ç't'i bëja! Ai hapi sytë, më vështroi gjatë, si të mos më njihte, pas-taj më foli me zë të mekur:

«Ujë, Shefki!... O burra pak ujë! Oh, sa etje kam!...

Rreth e qark gjëmonin kodrat. Kisha harruar që bëhej luftë. Zbrita në fund të shkëmbit. Aty rrëzë tij gjeta një pëllg të vogël me ujë. Mora pak në pagure dhe i laga paksa buzët, se siç e dini, të plagosurit nuk i jepet ujë. U duk sikur mori jetë. Hapi sytë dhe, kur më pa lotët, që unë nuk i kisha mbajtur dot, u vrenjt e më tha:

— Jo, Shefki, jo! Burrit në luftë... nuk i kanë hije lotët... Shko, vëlla, lufto me shokët. Më vjen keq që nuk e pashë lirinë me sytë e mi...

Dhe lëshoi një psherëtimë të thellë. Pas pak erdhën shokët, e ngritëm dhe e nisëm për në fshatin më të afërt. Vdiq pas dy orësh në spitalin partizan. Kjo është arsyeja që e dua këtu një shtyllë. Ky vend duhet ndriçuar. Drita i takon gjakut të tyre.



ZËRI I KOHËS

skicë

Pas një trokitjeje të fortë, hapet dera dhe futet në klasë një mesoburrë. Në njërën dorë mban librat, kurse tjetrën e ka lëshuar poshtë.

— Më lejoni, shoku mësues?

— Hajde, Pertef, ulu.

Ai vjen dhe ulet pranë meje. Banga kërcet. I fut librat poshtë dhe lëshon duart e rënda mbi bango. Ka ca flokë të dendur, të ashpër e të pluhurosur.

— Më vajti vonë dhe kam ardhur nga galëria me vrap. Pata një plasje minash. Nuk më doli kohë të ndërrohesha, bile as të lahësja mirë dhe erdha në klasë me rrobat e punës, — më thotë, si i zënë ngushtë.


— S'ka gjë... Kështu është kur bën dy punë në një kohë.

— Sidoqoftë, këtu është shkollë, ajo ka rregullat e saj.

Nga balli, nga fytyra e nga ato pak thinja, mendoj se do t'i ketë zënë të dyzetat.

— Si je me mësimet? — e pyes ngadalë, duke përfutuar nga një pushim i shkurtër.

— Aty nga tetat notoj. Kam qenë më mirë, po këto dy muajt e fundit kemi pasur ca telashe me planin e qymyrit... Kam rënë ca në mësimet.



— Është edhe ca me lodhje shkolla në këtë moshë, — i them.

— Epo, ç'të bësh! Më mirë vonë se kurrë, i thonë fjalës. E do koha, byrazer.

Kur mbaroi ora e parë ne të dy nuk dolëm nga klasa. Ndenjëm aty, ndezëm nga një cigare dhe vazhduam bisedën.

— Jam vënë në garë me djalin, — thotë me buzë në gaz.

— Në mësimë kështu?

— Po.

— Sa fëmijë ke?

— Një kam. Një djalë, po kam djalë vec!.. Shtëpinë e kam larg që këtej. Gati gjashtë orë më këmbë. Fshat malor. Shkoj një herë në muaj. Kur ndodh që të mos shkoj në fund të muajit, djali më dërgon menjëherë rezultatin e notave e më kërkon të miat.

— Si ka vajtur gara deri tani? — e shpoj me shaka.

— Dy muajt e parë ma mori ai. Kjo më vuri në lëvizje. Mund të të duket shaka, po di ti që xheç më ngacmoi keq në sedër? Vartësi kërkon shembullin personal nga eprori, që ta quajë atë të merituar e ta respektojë, — shtoi duke më shikuar në sy. — Kështu ndodh pak a shumë edhe me fëmijën ndaj prindit. Dikur unë i flisja rëndë djalit për ndonjë notë të dobët... E tani që iu vura dhe vetë kësaj pune, nuk mund të flas pa shikuar notat e mia, ndryshe do ta bëj si prifti, që thoshte bëj si them unë, por jo si bëj unë... Vërtet, dija varet nga babai i dritës, dua të them nga mësuesi, por, ama, filli i edukatës së fëmijës nis nga babai i jetës, domethënë nga prindi. Kështu mendoj unë dhe kështu është, për nder... Po s'pati prindi dashuri e sedër për punën, as fëmija s'ka se-

dër në mësim. Poo... ku e pata? Ëhë... kështu që
iu vura punës.

— Në ç'klasë e ke djalin?

— Në një klasë jemi, në të shtatën, — përgjigjet
dhe vazhdon bisedën: — Me gjithë punën e lodhshme
iu vura edhe mësimëve. Qëndroja mbi libra deri vo-
në. Në nëntor e dhjetor e fitova garën me djalin. Eh,
të ishte atje, ç'ka vajtur! Unë e ngacmoja, ai nevriko-
sej, gruaja herë më sulmonte mua e herë atë. Do ti
që u nxej sa qau! «Do të shikosh ti, do të shikosh!»
më tha dhe u ngrit e shkoi në dhomën e tij. Ha-ha-
-ha!.. — Pertefi qeshi me gjithë zemër. — Po ç'e do,
në janar dhe shkurt ramë me planin e qymyrit. Unë i
ktheva sytë e mendtë më shumë nga galeritë. U futëm
në garë në mes brigadierëve. Garën ia morëm bri-
gadës së dytë, po në mësim ma mori djali. I kam
mbledhur prapë forcat. Ai vrapon, por edhe unë eci
pas tij, për të mos mbetur prapa. Sidoqoftë, vrulli i
atij dhe përvoja ime do të plotësojnë njëra-tjetrën.
Sido që të dalë gara, fitorja jonë është prapëseprapë...

Fillon ora e dytë e mësimit. Unë u ndava me
minatorin, me këtë njeri të punës, të mësimit, të ak-
sioneve dhe të mbledhjeve dinamike. U ndava me
këtë njeri të kohës sonë, të etur për dije, për mësim,
duke marrë diçka nga shpirti i tij, diçka që do të më
shërbejë edhe mua, edhe ty, edhe atij, të gjithëve...

DËSHIRA E FUNDIT

skicë

Autobusi zbret të tatëpjetën duke rënkuar. Në krahun e djathtë është një rrëpirë, që bie në një përrua të thellë. Kurse në të majtë ngrihet faqja e malit me pisha. Përpara, në xhadenë plot kthesa, që humbet tej në gji të maleve, nuk ka asnjë lëvizje. Në një kthesë të keqe shoferi i bie borisë dy herë. Disa udhëtarë kthejnë kokën mbrapa, kureshtarë, se ç'pëshpërisin në mes tyre.

— Ç'bëhet? — pyes shokun pranë sediles sime, i cili është nga këto anë.

— Nuk e dini? Nuk keni kaluar ndonjëherë kësaj udhe? — ma kthen ai.

— Jo.

— Atje, te ajo kthesa, poshtë asaj pishës së lartë, është varri i një shoferi. Ka qenë vendës. Ja, nga ai fshati atje lart, — më thotë dhe, duke ulur kokën te xhami i autobusit, më tregon me dorë ca shtëpi të rralla, që duken sikur kacavirren lart në shpatullën e një mali. — Ka qenë njeri i mirë. Kam pasur rastin ta njoh. Xhanan njeri ishte, për nder! Edhe si shofer ishte i zoti. Mirëpo, ç'e do, mbeti një ditë atje te kthesa; e ndau nga jeta e nga shokët akulli. Ka bërë një

dimër i keq atë vit. Rruga kishte ngrirë. Makina i shkau aty dhe doli nga rruga. Ai u përpoq të shpëronte makinën, duke e përpjekur te ndonjë pemë aty afër, por nuk mundi. U rrokullis në rrëpirë me gjithë makinë. E gjetën përposh në përrua. E gjetën gjallë, po nuk rrojti. Vdiq, po përpara se të jepte shpirt, kërkoi ta varrosnin atje te kthesa, në buzë të rrugës. «Të dëgjoj boritë e shokëve dhe t'u kujtoj rrezikun e kthesës», pat thënë.




GËZIMI I TIJ I PAFUND

Skicë

Pranë teje në autobus qëndron një njeri me kominoshé tërë naftë. Rri i heshtur, i qetë, pak si i dru-ajtur e shikon plot kureshtje. Dorën e ka mbështetur në hekurin e sediles pranë. Ka duar të forta, të ashpra, të murrme. Poret e lëkurës së duarve duken si pika të zeza. Janë vulosur me vulën e profesionit të tij. Sytë i ka pak të kuq, flokët të ashpër e të pluhurosur. Ai dallohet nga zanatçinjtë e tjerë. Hipën në autobusin e parë dhe zbret në stacionin e fundit. Del nga qyteti, ecën më këmbë një copë rrugë të mirë dhe futet në fushën e gjerë.

Atë e takon edhe në koncert, ndonëse rrallë. Atje është ndryshe. Është veshur mirë, ndjek me kureshtje shfaqjen, gjallërohet menjëherë kur në skenë del ndonjë nga artistët e merituar. Ai nuk ka në vendin e punës kushtet që ke ti në uzinë. Nuk ka banjo e garderobë, e s'ka si t'i ketë. Ai është traktorist, ka traktorin, kabinën e vogël dhe fushën e gjerë. Sa baba-xhan që është! Njihe nga afër dhe do të ndiesh çiltërsinë e tij, zemrën e bardhë, dëshirën për të shkëmbyer mendime me ty. Orë të tëra atje në fushën e gjerë nuk flet me njeri. Xheku bisedon me shokun e tij të pandarë, me traktorin. «Mirëmëngjes, tigër!»



i thotë kur ngjitet mbi zinxhirin e tij. Ia thotë këto fjalë me buzën në gaz e duke qëlluar me shuplakë maskarinon. Ia nis punës pa dalë dielli. Çan përmes fushës së gjelbërt e prapa lë një vazhdë të murrme: tokën e shpalosur. Diku plugjet zënë në një rrënjë.

Motori gulçon. Ai i flet si shok: «Jepi, tigër, edhe një herë!... Hë, më të lumtë! E shkule rrënjën e keqe!...» Fusha e gjelbërt ndryshon ngjyrë. Traktori uturin e çan përpara, deri në fund të parcelës. Kthehet prapë. Sa herë kthehet ai lart e poshtë për orë të tëra! Një re pluhuri e ndjek prapa (ky pluhur ia vret sytë, prandaj i ka të skuqur) e pas pluhurit zogj e gala të gëzuara, që kërkojnë ushqim në tokën e përzier. Kujtohet se ka kaluar dreka. Zbret nga traktori e ulet në hijen e një mani. Hap përpara një trastë doku e nxjerr prej saj një copë sallam, djathë, ndonjë vezë të zier a një kokërr hudhër. Ha me oreks dhe, pasi pi një gjysmë paguri ujë, kumbiset një çikë, po sytë i shkojnë lart në majat e maleve. «Aha, me sa duket, po vjen shiu! O burra, tigër, t'ia nisim! Të mbarojmë edhe këtë parcelë, edhe atë... edhe atë...» Kështu kalon ai nga njëra parcelë në tjetrën, pa vënë re se dita kalon. Kthen kokën prapa e shikon tokën e zezë që përzihet me muzgun e mbrëmjes. Në shpirt ndien atë gëzim që i sjell njeriut puna. «Kemi bërë goxha punë, o tigër, por fushata s'na pret të pushojmë. Duhet të punojmë edhe natën sonte. Si thua?...» Tigri ka uri, do naftë. Niset ai me traktor, tutje nga stallat e kooperativës, ose diku në anë të rrugës automobilistike, ku është vendi i furnizimit. E furnizon traktorin dhe e lë të pushojë pak. Edhe ai është lodhur. I tulitur në sedilen e ngushtë, e zë gjumi.

Ngrihet nga mesnata dhe ia nis sërish punës. Dritat çajnë kryq e tërthor errësirën. Traktori gulçon. Në kabinën e tij rreh zemra e traktoristit, e këtij njeriu fisnik, që mbi lodhjen ndien gëzimin, që në fushën e madhe derdh djersën për bukën, për njerëzit, për At-

dheun. Këto mendon ai atje në fushën e gjerë, në mesnatë, dhe nuk përkulet nga lodhja. Këto mendojnë edhe shokët e shoqet e tij atje në fabrikat e rrobave, të këpucëve, të hekurit, të betonit e kudo. Këto mendon çdo njeri i kohës sonë, që ndien se jeta e tij nuk ka asnjë vlerë pa qenë në funksion të së tërës, të shoqërisë së re, pa u ngjitur me guxim rrugëve të djersës, të thinjave, bile edhe të gjakut. Tek vetëdija për këtë qëllim të madh qëndron madhështia e njerëzve tanë. Në autobus, kur hipën çdo mëngjes, ti gjen edhe gëzimin e punës sate, shikon njerëzit e veshur bukur dhe mërmërit me vete: «Ja, këtë stof, basme, këpucë... e prodhoj unë në repartin tim». Kështu gëzohet dhe ai muratori pranë teje kur dëgjon se ti u fute në shtëpi të re. Po ai shoku me kominoshe me naftë, që dëgjon e shikon kureshtar, a e gjen ai gëzimin e punës edhe aty në autobus? Po, e gjen. Bile shumë të fuqishëm. E gjen tek ti, në shëndetin tënd. Në atë shëndet që i ka rrënjët atje tej, në fushën e gjerë, ku ai djersitet, pluhuroset, formohet...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
1. Dhembja e plagës së vjetër	3
2. Jeta e një heroi	15
3. Komiti Tare Bakiri	27
4. Duke kthyer kokën mbrapa	47
5. Biri i muratorit	58
6. Në rrënjët e ijalës që dhamë	80
7. Në buzë të greminës	92
8. Shpella e gjermanit të Selfos	105
9. Dritë mbi gjak	109
10. Zëri i kohës	113
11. Dëshira e fundit	117
12. Gëzimi i tij i pafund	119

